

Korrik 2013
Numri: 64
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA

Erdhi Ramazani U hapën dyert e Xhenetit



NAMAZI, ELIKSIRI
I TË RIUT MYSLIMAN
OSMAN NURI TOPBASH

PËRMASAT DHE MËSIMET
E BETEJËS SË BEDRIT
NEXHAT IBRAHIMI



7 PENGESAT NDAJ
DEVOTSHMËRISË
HASAN KAMIL JËLLMAZ



FTESË PËR LUMTURIM
DR. AID EL-KARNI



INFAKU
NË RAMAZAN
DR. KERIM BULLADË



IDRIS ARPAT
REFLEKTIMI

Etika

ISSN 2227-3611 07
9 772227 361004

Korrik 2013

VITI: VII
NUMRI: 64

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR & KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahushta

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Mbeti i mbyllur gjithë jetën. I struktur në lëmshet e tua të frikës. Duke numëruar katet e qiejve të çdo iluzioni që lidhet me atë çfarë thjesht ke afër, në dukje. Duke u habitur nëpër labirintet e një mendjeje që nuk të shpie asgjëkund. Mos harro të lutem! Ti je shumë më i madh! Ti je universi në të cilën fshihen misteret... Tek ti përflaken meloditë e ndarjes... Lëre mallin të të marrë ndër duar... Lër...e... zanin të të flasë siç di ai vetë... Mos fol për të tjerët, por foli vetes për veten dhe për qëllimet që nuk i mbërrite... Mos lër egon të të verbojë e të fundmen të ta bëjë të pafundme. Koha është vetëm një iluzion... E megjithatë Zoti betohet në të. Këtu ajo merr vlerën e saj të vërtetë. Nuk do ta besoja ekzistencën e kohës, sikur Zoti të mos betohej në të. Ki kujdes kjo kohë është mëshirë... Është stacion orësh, ditësh, javësh e muajsh... Koha është një shkak për t'u afruar me Zotin, kur Ai të thërret duke të përkëdhelur mëshirshëm me fjalën "Eja...". Ai nuk të ka krijuar kot. Të ka krijuar që ti t'i falesh Atij. E kështu të mbërrish në vetëdijen e ekzistencës së Tij të pakohë...

Në këtë kohë fshihet edhe Ramazani... Me kalimin e kohës rritet kujtesa dhe njeriu vetëdijësohet për origjinën e tij. Ai vendos të agjërojë për të kujtuar botën tjetër, në të cilën njeriu nuk ka nevojë më për të ngrënë. Vendos të agjërojë për të kuptuar se sa i vogël është në koordinatat e kësaj bote. E kështu të kujtojë se si ndihen ata që nuk e kanë jo thjesht një muaj, por gjithë jetën kafshatën e bukës. Kupton kështu vetminë

e tyre, jetën e shtypur që ata bajnë... Ata kanë nevojë për ty jo thjesht për t'i ndihmuar në aspektin ekonomik, por për t'i kuptuar, për t'i marrë në konsideratë. Sa herë i je lutur Zotit për ta?

Erdhi koha t'i hapësh zemrën muajit të shenjtë të Ramazanit. Të flasësh me të. Të përlolesh për gabimet që bën çdo ditë, e të cilat nuk po mund t'i lësh. Erdhi koha të lahesh me abdestin e urisë e ta edukosh egon me ushqimin e përmendjes së Zotit. Të lutem mos flij. Nuk flihet në ditën e madhe të Ramazanit. Nuk flihet duke shfletuar Librin e këtij muaji. Fluturo në të vërtetën e shpirtit tënd e do të vësh re se sa Ramazane fshihen aty. Se sa lot presin të derdhen për dashurinë e Zotit. Hapu ndaj këtij muaji. Ramazani nuk ka kuptim pa ty. Mos e lër këtë muaj jetim. Mos ia lër këtë vlerë paditurive të tua. Bëhu pelegrin i zemrës tënde. Sillu rreth saj si ashikët e Zotit. Kapu fort për të, se pasha Atë që ka jetën në dorë, do të të marrë kuptim qenia jote. Do të bëhesh pishman për kohët që ke humbur larg Atij, i Cili është më afër se damari i qafës ndaj teje...

Ti nuk mund të shohësh dot, pa sexhden ndaj Tij...

Uria e Ramazanit është sexhdja me të cilën mund të hysh në xhenet...

Fito krahë prej tij... Fito qenien tënde të vërtetë...

Fito dashuri...E do të ndihesh i ngopur, çuditërisht prej urisë...

Eja... në festën e Sofrës së Ramazanit ...

Përmbajtja

Ftesë për lumturim
Aid El-Karni

16



8

Infaku në Ramazan
Dr. Kerim Bulladë




Namazi, eliksiri i të riut mysliman
Osman Nuri Topbash

34




28



26

Ë do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit tënd,
plot Madhëri dhe Nderim
Albri Brahusha

- 5 Adhurimi i ndërthurur me jetën
Ahmet Tashgetiren
- 10 Ku është umeti i Muhamedit (a.s.)?
Ahmet Basher
- 12 Përmasat dhe mësimet
e betejës së Bedrit
Nexhat Ibrahim
- 15 Mesazhi i Miraxhit
Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi
- 20 Teoria e Big Bengut
në peshoren e versionit kuranor
të krijimit të universit
Altin Torba
- 22 Abdurrahman ibn Xhebri
Mustafa Erish
- 24 Kur një derë e lumturisë mbyllet,
një tjetër hapet
Ma. Ejup Haziri



42

Personaliteti që ndërton Islami 28

Ali Riza Temel

Hap pas hapi 31

Nuredin Jëlldëz

Një Ajet - Një Hadith 32

Bajramet e dashurisë dhe respektit 40

Xhafer Durmush

Reflektimi 42

Idris Arpat

Vlerësimi i mundësive 44

Xhemal Nar

Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (a.s.) 46

Serkan Këjly

Tefsiri i sure-i Duhasë 56


Zani i s'kaluemes

Konsumimi i peshkut në fëmijëri lufton alergjitë 60

Shëndet

Sony edhe me smartwatch 63

Teknologji



Shtatë pengesat ndaj devotshmërisë
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

50

Ëmbëlsia e besimit
Ferid Piku

52

ADHURIMI i ndërthurur me jetën

Ahmet Tashgetiren

Po përjetojmë Ramazanin. Po e përjetojmë atë të ndërthurur me jetën.

Megjithatë, jeta nuk ndalon së bashku me Ramazanin, por vazhdon të rrjedhë.

Ashtu si namazi, që është një adhurim brenda jetës edhe agjërimi është një adhurim që përjetohet së bashku me jetën. Në fakt, të gjitha adhurimet përjetoohen brenda jetës. Pra, Islami nuk është një fe që jetohet në vetmi, larg jetës dhe vetëm në vende të caktuara, por një fe që e ka ndërthurur adhurimin me jetën ose më saktë, një fe që mëson se si të jetohet me ndjenjën e adhurimit.

Ç'do të thotë kjo?

Për të kuptuar këtë, më parë duhet të shqyrtojmë se ç'është adhurimi.

Adhurim është vetëdija për marrëdhënien midis Krijuesit dhe qenies së krijuar. Pra, vetëdija ndaj robërisë dhe shpagimi i borxhit që lind prej faktit të të qenit rob i Allahut.

Ç'do të thotë kjo?

Kjo do të thotë se çdo grimcë e jetës sime është e ndërlidhur fort me mirësinë dhe bujarinë e Tij. Do të thotë që, para se Ai të urdhëronte "Bëhu!", unë dhe gjithësia ishim një "hiç". Do të thotë që unë duhet ta organizoj jetën time me këtë vetëdije, pra me vetëdijen se kam ardhur prej hiçit me mirësinë dhe bujarinë e Tij. Do të thotë që duhet të jetoj duke pasur kujdes nga Ai, me vetëdijen se Ai nuk do të më lërë të veproj pa kontroll dhe duke marrë për bazë koordinatat e rrugës që Ai ka përcaktuar.

Disa modele sjelljeje që na janë përcaktuar si adhurime, luajnë rolin e stimuluesve, të cilët nuk na lënë të harrojmë këtë marrëdhënie themelore në rrjedhën e jetës së përditshme. P.sh., në sajë të pesë kohëve të namazit, qëndrojmë pesë herë në ditë në audiencë të Allahut dhe themi: "Erdha, o Zoti im i Madhëruar, po i qëndroj besnik marrëveshjes që kemi bërë në botën e shpirtave para se të krijohem. Duart, gjuhën, syrin, veshin, zemrën, mendjen, mënyrën e mendimit dhe botë-kuptimin për jetën i kam të pastra. Nuk e kam njollësuar

zembrën gjatë kësaj kohe. Dhe ato pak njolla që kisha, i kam pastruar dhe ja tani, jam para Teje”.

Midis dy namazeve mos fut gjynahe, si shkelja e ku-fjive që të ka vënë Allahu, por jetoje ditën duke qenë i pastër. Me anë të agjërimit, lëri mënjanë disa nevoja të domosdoshme njerëzore në kohë të caktuara për një muaj rresht, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit tënd. Organizojë veten sipas kënaqësisë së Allahut. Dhe meqenëse këtë e bën për hir të Tij, mos i neglizho as kufijtë e tjerë hyjnorë jashtë ngrënies, pirjes dhe jetës seksuale.

Dije se çështja e agjërimit nuk është thjesht një dëshirë e Allahut që ti të qëndrosh i uritur, sepse Ai nuk ka nevojë për urinë tënde. Ai dëshiron të bëhesh një rob më i mirë. Dhe meqenëse munde t’i frenoje prirjet njerëzore, si ushqimin, pijen dhe jetën e natyrshme seksuale, vetëm për kënaqësinë e Allahut, tashmë mund t’i respektosh edhe më me dëshirë kërkesat e tjera për hir të Tij.

Meqenëse Allahu të ka vënë përpara një model, si “Ni’mel abd (Robi i mirë)”, atëherë si thua, a ta kërkojmë atë në namaz, agjërim, haxh dhe zekat? Nëse ndërton një shtëpi me agjërim, nuk të ka hije t’i vësh shkelmin për disa tundime të epshit.

Agjërimi është si një enë, brenda së cilës do të mbruhesh ti. Zemra jote do të kthehet në një qendër personaliteti, i cili do të mbruhet në dorën e fuqishme të Zotit.

Me anë të zekatit, ndreqi ndjenjat e tua që janë të prira të mburren, duke thënë, “i fitova unë”. Pra, rregullo marrëdhënien tënde me pasurinë. Dije se ato t’i

fali Zoti yt si furnizim. Mbase ke punuar me mish e me shpirt për t’i fituar, por edhe shpirtin Ai ta ka dhënë. Ndaje një pjesë të pasurisë apo mallit, të cilin e do që shumë, si të jetë një pjesë e shpirtit tënd. Madje, ndaj një pjesë të mirë të tij dhe jo atë që, po të ta jepnin ty do të rrudhje fytyrën para sa ta merrje. Ndaje dhe jepe me dashuri dhe respekt, sikur je duke e dhënë në dorë të Allahut ose sikur po i jep borxh Atij dhe në këmbim do të marrësh xhenetin. Jepja të varfrit atë që Allahu e ka lënë në përgjegjësinë tënde.

Me anë të haxhit, shumëzoi me zero të gjitha statutet e tua shoqërore. Qëndro me dy copa pëlhere dhe hapi duart sikur je në atmosferën e mahsherit. Drejtoju Zotit tënd dhe përgjeroju Atij pandërprerë. Përrjeto ndjenjën e dhënies së llogarisë përpara Allahut, pendo-hu tek Ai dhe mundohu të ndjesh ndjenjën e pastërtisë shpirtërore... Mendo për një çast, sikur ike dhe nuk do të kthehesh më. Në atë moment nuk je më, asnjë sekondë dhe asnjë ditë më pas. Dhe ashtu, duke u mbështjellë me qefin, sikur mbështillesh me ihram, do të dalësh në udhëtimin e përjetshëm. Çfarë ka në torbën që ke marrë mbi supe? Virtyte me të cilat do të fitosh kënaqësinë e Allahut apo një grumbull gjynahesh, të cilat do të bëhen shkak i zemërimit hyjnor?

Mos harro marrëdhënien me Zotin tënd.

Mos harro Zotin tënd.

Mos mendo kurrë, qoftë edhe për një çast, se mund të kalosh jashtë fushës së fuqisë së Tij.

Mbaje frymën për disa minuta. Ja, atë ta jep krejt falas Zoti yt. Pa u munduar fare. Të jep një qiell plot frymë, lugina të mbushura me ujë, gjakun që rrjedh në damarët e tu dhe shpirtin që të mban në këmbë.

Ai çdo çast është me ty dhe çdo çast të mbulon me mirësi.

Ai është pranë teje më afër se arteria kryesore në qafën tënde.

Jeto sikur e sheh Atë në çdo moment. Edhe nëse ti nuk e sheh Atë, dije se Ai të sheh ty.

Krijuesi, pavarësisht gjithë këtyre rregullave bazë, e di shumë mirë se njeriu është i dobët dhe shpërbëhet lehtë. Atë e shpërbëjnë marrëdhëniet brenda jetës, siç janë fëmijët dhe familja. Prandaj dhe Allahu na paralajmëron, kur thotë: **“Ata të cilët nuk i pengon shitblerja për të përmendur Allahun dhe të cilët e falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.”** (Nur, 37)

Tregtia dhe shitblerja... Kjo është jeta... Nuk mund të shkëputesh prej tyre, kjo dihet. Por as nuk mund



të zhytesh në to. Të gjitha këto duhet t'i bësh pa e harruar Allahun Teala, duke e përkujtuar Atë dhe duke respektuar të gjitha rregullat që ka vendosur Ai për këto punë. Pra, pikërisht ky është namazi i ndërthurur me jetën. Ky është kujdesi ndaj të varfërve, që të bën të ndash një pjesë prej fitimit nga tregtia dhe shitblerja.

Nëse nuk e jetoni jetën me vetëdijen se jeni së bashku me Allahun, kini frikë prej një dite kur do t'u turbullohen sytë. Por, nëse besoni me gjithë zemër se një ditë do të dilni para Allahut dhe, nëse ndjeni një drithërimë duke e ditur se sa e vështirë do të jetë dhënia e llogarisë, atëherë mos e harroni Allahun dhe robërinë ndaj Tij në asnjë çast të jetës!

Allahu Teala paralajmëron:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)

Pasuria dhe fëmija... Kjo është jeta... Nuk mund të shkëputesh prej tyre. Ato janë gëzimi i zemrës dhe fruti më i ëmbël i jetës. Kjo dihet. Por as nuk mund të zhytesh në to.

Edhe kur dashuria për pasurinë dhe fëmijët të ta mbështjellin zemrën, nuk duhet ta harrosh Allahun. Duhet ta dish se edhe pasuria, edhe fëmija janë prej mirësive të Zotit tënd. Ai t'i jep, Ai t'i merr.

Të gjitha këto na këshillojnë të përvetësojmë vetëdijen e së qenit së bashku me Allahun edhe në jetën tonë jashtë namazit. Gjithashtu, edhe kur nuk jemi agjërueshëm...

Madje, duhet menduar në këtë mënyrë:

O Allah, u zgjova në agim prej gjumit që është si gjysmë vdekjeje. Më dhurove edhe një ditë... Qofsh i falënderuar pafundësisht. Ja ku jam para Teje dhe do të përpiqem që këtë ditë që ma dhurove ta jetoj në përputhje me kënaqësinë Tënde.

Pastaj do të çelë dita, dielli do të ngrihet në kupën e qiellit dhe ti do të mendosh:

- Pak më vonë do hyjë koha e namazit të drekës dhe unë do të dal përpara Zotit tim. Do të marr abdest dhe në një farë kuptimi, ndërkohë që laj duart dhe fytyrën, do të pastrohem edhe prej papastërtive të zemrës. Gjithmonë bëhesh pis dhe pastrohesh, bëhesh pis dhe pastrohesh. Ç'është kjo punë? A nuk mund të tregoj më shumë kujdes që të mos bëhem pis?

Allahu Teala urdhëron:

“...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (el-Ankebut, 45)

Pejgamberi (a.s.), thotë: “Nëse nuk ke turp, bëj ç’të



duash!”. Të turpërohesh... Mbase më parë duhet të turpërohesh prej Krijuesit. Apo jo?

Me Ramazanin, ne dëshirojmë të fitojmë një jetë e cila jetohej në prani të Allahut. Kjo është një provë. Pra, të hymë për një muaj rresht në dietën e devotshmërisë ose, nëse mund të shprehemi, të bëjmë një “kurë” me adhurime. Të ndjejmë pastrimin deri në palcë poshtë një ujëvare mëshire. Të mësohemi me një jetë të re, të organizuar përreth agjërimit.

Resulullahu (a.s.), na këshillon: “*Ta fitojmë xhenetin duke e përjetuar Ramazanin ashtu siç i takon atij*”. Pra, për ne, kjo është sprovë e nxjerrjes së xhenetit prej Ramazanit.

Nëse gjatë shpërbërjeve që përjetojmë ndjejmë flakët e zjarrit në fytyrat tona, ja ku kemi rastin e Ramazanit, i cili i ka hapur krahët e mëshirës për ne dhe për të cilin Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: “*Ai që nuk përfiton prej tij (Ramazanit), do të poshtërohet*”.

Me pluset dhe minuset e tij, Ramazani është një provë e madhe.

Dëshiroj prej Allahut dhe i përgjerohem Atij të na japë forcën për ta fituar këtë provë.

Iftaret do të na heqin urinë ditore të trupit tonë. Ndërsa agjërimi le të jetë ushqimi i zemrës sonë dhe të na heqë urinë e shpirtit, duke na e ngopur atë me përkujtimin hyjnor.

Le ta dëgjojnë veshët tanë zërin që thotë:

“E meritove të jesh rob i Im, prandaj hyr në mesin e robërve të Mi. Hyr në xhenetin Tim.”

Infaku në Ramazan

Dr. Kerim Bulladë

Tani po përjetojmë lumturinë e arritjes së muajit Ramazan në të cilin është zbritur Kurani Fisnik, që është burim udhëzimi për të gjithë njerëzit¹ dhe mëshirë e myzhde² për të gjithë besimtarët.

Sa mirësi e madhe është ardhja e muajit Ramazan, të cilin Allahu Teala ua ka bërë risk robërve të Tij në një mjedis, në të cilin janë shtuar streset e depresionet dhe janë ndryshkur zemrat për shkak të mëkateve që janë bërë mënyrë jetese.

Nuk është aspak e lehtë ta përkufizosh dhe ta shpjegosh begatinë e muajit Ramazan me agjërimin që mbahet, me Kuranin që lexohet, me zekatin që jepet, me infakun, dhikrin dhe tesbihatin që bëhet, me pendimet që shpien në kthim e ndryshim, me iftaret që forcojnë vëllazërinë dhe me salatet, selamet e aminët që jehojnë në qiell. Sepse begatia dhe bereqeti i këtij muaji të madhërishtë mund të perceptohet vetëm duke e përjetuar dhe duke hyrë në këtë atmosferë.

Fakti se Kurani Fisnik, që është recetë shpëtimi për të gjithë njerëzinë në çdo aspekt, ka filluar të zbresë në këtë muaj, mjafton për të shprehur vlerën e tij. Ai që i jep kuptim këtij muaji, është vetë Kurani Fisnik. Kjo përsosmëri është edhe shkaku, që muaji i Ramazanit quhet muaji i Kuranit Fisnik.

Çdo lloj adhurimi dhe bindjeje ndaj Allahut Teala në muajin e Ramazanit, krahas obligimit të mbajtjes së

agjërimin, mbart rëndësi shumë të madhe në drejtim të fitimit të sevapeve dhe shpërblimit. Në këtë material të shkurtër do përpiqemi të shtjellojmë çështjen e infakut në muajin e Ramazanit.

Infak do të thotë nxjerrje e pasurisë dhe harxhim i saj. Në aspektin fetar, infaku ka pjesët e tij si obligim, vaxhib dhe mendub. Infaku përfshin zekatin, sadakatë e tjera, dhuratat, ndihmat që u bëhen të varfërve, mirësitë e ndryshme, ndihma ndaj familjes dhe të gjitha ibadetet që bëhen me pasuri. Në një ajet fisnik thuhet:

“Të pyesin se çfarë të japin (në rrugë të Allahut) si lëmoshë. Thuaj: ‘Çfarëdo mirësie që të bëni, le t’u takojë prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve. Çfarëdo të mire që të bëni, Allahu e di atë.”³

Infaku përfshin edhe gjërat shpirtërore, si dijen, mësimin etj. Krahas kësaj, në krye të të gjitha këtyre qëndron zekati, i cili është një nga shtyllat e Islamit.⁴

Infaku nuk ka kohë të caktuar. Ai mund të bëhet në çdo kohë dhe vend ku shfaqet nevoja. Me anë të tij, nevojtarë mund t’u plotësohen nevojat e tyre dhe të shpëtohen. Në ajete të ndryshme të Kuranit Fisnik, thuhet se besimtarët bëjnë infak (japin) në rrugë të Allahut dhe

3. Surja el-Bekare, 215.

4. Elmallëllë, Muhammed Hamdi Jazër, *Hak Dini Kur’an Dili, Stamboll*, 1971, I, 192.

1. Surja el-Bekare, 185.

2. Surja Jusuf, 111; surja en-Nahl, 102; surja en-Neml, 77; surja Lukman, 3.

se atë e japin në vendet në të cilat Ai ka urdhëruar:

“Ata i besojnë të fshehtës, e falin namazin dhe bëjnë infak (japin) në rrugë të Allahut prej atyre që u kemi dhënë.”⁵

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që u dridhen zemrat kur përmendet Allahu, u shtohet besimi kur u lexohen shpalljet e Tij dhe i besojnë e i mbështeten vetëm Zotit. Ata e falin namazin dhe bëjnë infak (japin në rrugë të Allahut) prej asaj me të cilën i kemi furnizuar.”⁶

Ndërsa për ata që e bëjnë infak pasurinë e tyre natën dhe ditën, thuhet: **“Shpërblimi i atyre që e bëjnë infak pasurinë e tyre natën e ditën, fshehurazi e haptazi, është te Allahu. Për ata nuk ka as frikë dhe as pikëllim.”⁷**

Siç u pa edhe më sipër, infaku nuk ka afat. Kurdo që të shfaqet nevoja, menjëherë veprohet dhe pa humbur kohë ndihmohen nevojtarët natën e ditën, fshehurazi dhe haptazi. Sepse nevojat mund të lindin befasisht dhe mund të bëhet fjalë për njerëz që vazhdimisht kanë nevojë për ndihmë.

Historikisht, është vënë re se zekati, lëmoshat vullnetare dhe ndihmat, më shumë janë dedikuar dhe realizuar në muajin e Ramazanit. Shkaku i kësaj mund të jetë shpresa për të marrë më shumë shpërblime nga Allahu Teala, ngaqë ibadetet dhe zbatimet e urdhëresave që bëhen në këtë muaj kanë më shumë sevape.

Për të dhënë zekatin e pasurisë, floririt dhe gjërat e tjera për të cilat zekati është obligim, mbi to duhet të kalojë një vit kohë. Kjo pjesë kohe dikujt mund t'i rastisë në muajin Ramazan dhe dikujt mund t'i rastisë në një muaj tjetër. Çështja për të cilën duhet të kemi kujdes në lidhje me këtë temë është që, zekati të jepet në kohë dhe pa u vonuar. Sipas Islamit, nuk ka ndonjë kohë të veçantë për ndarjen e zekatit në muajin e Ramazanit. Një gjë e tillë nuk është urdhëruar dhe nuk është sugjeruar nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem.

Shkaku i dytë që zekati dhe infaku aplikohen më shumë në muajin e Ramazanit, mund të shpjegohet kështu:

5. Sureja el-Bakara, 2/3.

6. Sureja el-Enfal, 8/2-3.

7. Sureja el-Bakara, 2/274.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, në Ramazanin e çdo viti ia lexonte engjëllit të shpalljes, Xhebrailit, alejhi's-salam, ajetet e Kuranit që i kishin zbritur deri atë kohë. Madje, në Ramazanin e vitit kur ndërroi jetë, kjo gjë ndodhi dy herë.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-salam, përgjatë kësaj kohe ishte bujar si erërat shpërndarëse dhe bënte infak çfarëdo që të kishte. Ibn Abbasi (r.a.), tregon në lidhje me këtë çështje:

“I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ishte njeriu më bujar. Ndërsa në muajin e Ramazanit bujaria e tij arrinte kulmin. Xhebraili, alejhi's-salam, çdo vit takohej me Profetin (a.s.), në Ramazan dhe kjo zgjaste deri në fundin e këtij muaji. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-salam, ia lexonte Kuranin atij. Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, takohej me Xhebrailin, alejhi's-salam, në çështjen e mirësisë, ishte më bujar se erërat shpërndarëse.”⁸

Besimtarët janë më bujarët, garojnë me njëri-tjetrin dhe janë më entuziastët në dhënien e infakut përgjatë muajit të Ramazanit.

Kjo ndodh për shkak të bujarisë që i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka shfaqur në këtë muaj të bekuar. Sepse, përpjekja e besimtarëve sipas mundësisë së tyre për të marrë kënaqësi të thella nga muaji i Ramazanit, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi është falje, kurse fundi çlirim nga zjarri i xehnemit, është e natyrshme dhe detyrë e tyre. Askush nuk ka të drejtë ta hetojë, hulumtojë apo ta kritikojë këtë. Por ne duhet të shohim edhe anën tjetër të çështjes.

Për nevojtarët duhet të kujtohemi edhe jashtë Ramazanit, duhet t'u plotësohen atyre nevojat dhe duhet të vazhdohen aktivitetet e infakut. Sepse nevojat shfaqen vazhdimisht. Njeriu vazhdimisht mund të ketë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Përderisa njeriu të jetojë, infaku do të vazhdojë dhe zekati, dhuratat e sadakatë do të jepen. Nuk duhet harruar kurrë se është i pasuri ai që ka më shumë nevojë të japë se sa ka nevojatari të marrë, plotësimi i nevojave të nevojtarit është porta më e sigurt e xhenetit. Kështu ne themi, se çdo i pasur është nevojtar i çdo nevojatari...

8. Buhari, Bed'ul'-Vahj, 5, Suam, 7; Muslim, Fedail, 48; Tirmidhi, Xhihad, 15; Nesai, Sijam, 2; Ibn Maxhe, Xhihad, 9.





Ku është umeti i Muhamedit (a.s.)?

Ahmet Basher

Pothuajse para dyzet vjetëve, në shtëpinë tonë erdhi për herë të parë magnetofoni. Dhe në kasetën tonë të parë ishte incizimi i ligjëratës së një hoxhe të nderuar. Në fillim, për arsye se nuk kishim kasete të tjera, dëgjonim vazhdimisht të njëjtën kasetë. Për rrjedhojë, ligjëratat e hoxhës u gdhend në mendjen tonë. Ajo që ndikoi më shumë tek unë prej fjalëve të tij, ishte transmetimi i një thënieje të Jahja bin Muadhrit:

“O njerëz!.. Po shoh se shtëpitë tuaja po u ngjajnë shtëpitë të Perandorit të Romës, mahnitja juaj pas luksit, ngjan me sjelljen e Kistrës, vrapimi juaj pas pasurisë i ngjan botëkuptimit të Karunit, dëshira juaj për të sunduar, i ngjan dëshirës për sundim të faraonit, egoja juaj, egos së Ebu Xhehlit, murrja juaj, murrjes së Ebrehesë dhe jeta juaj, jetës së të mjerëve. Për hir të Allahut, më thoni ku është umeti i Muhamedit?..”

Jahja bin Muadhi i ka thënë këto fjalë në një ligjëratë të mbajtur afërsisht para dymbëdhjetë shekujsh. Vallë, po të na kishte parë sot, çfarë do të thoshte? Sikur ta ftonim në shtëpitë tona, a do të na urdhëronte? Kur ky njeri i bekuar vizitoi njëherë shtëpinë e vajzës së dashur të Pejgamberit tonë (a.s.), Fatimes (r.a.), sipas një transmetimi, nuk hyri në shtëpi, për shkak se kishte parë një mbulesë të zbukuar (me figura kafshësh). Kurse Fatimja (r.a.), e hoqi menjëherë. Me këtë veprim ai na ka kujtuar edhe njëherë sunetin e Pejgamberit tonë (a.s.).

Elhamdulillah! Niveli i jetesës sonë po rritet dita-ditës. Po fitojmë më shumë dhe po shpenzojmë më shumë. Mirëpo, në vend që të shpëtojmë lehtësisht prej përgjegjësisë ndaj pasurisë, duke e përdorur atë në rrugë të Allahut,

duke fituar sevape me plotësimin e nevojave të të varfërve, duke u gëzuar me gëzimin e tyre dhe duke marrë duatë e tyre, për fat të keq ne zgjedhim më të vështirën, atë, llogaria e së cilës do të jetë më e ashpër, luksin dhe shpërdorimin.

Çdo ditë që kalon, njerëzit dëshirojnë më tepër. Shtëpi më luksoze e më të gjera, vila dubleks e tripleks. Sa kuptimplotë janë këto fjalë që i nderuari Osman Nuri Topbash i tha gjatë vizitës së një të sëmuri në Kytahja: *“Elhamdulillah! Ja, kjo është shtëpia që doja të shihja. Kështu ishte kur e vizitua para njëzet e pesë vjetësh, kështu është edhe tani.”* Haxhi Abdullahun, të cilin e vizitoi hoxha ynë i nderuar Osman Nuri Topbash, e kishim vizituar edhe ne disa herë. Shtëpia e tij ishte përdhese, e thjeshtë, e pastër dhe e rregullt. Sa herë që e vizitonim, na nxirrte menjëherë çaj të bërë rishtazi dhe një qerasje të thjeshtë. Tani le të mendojmë pak shtëpitë tona. Sa orendi të shtëpisë i kemi që prej njëzet e pesë vjetësh? Çfarë orendish dhe sa herë i kemi ndërruar gjatë kësaj kohe?

Ata që kanë të ardhura të mira dhe familje të madhe, patjetër që kanë të drejtë të jetojnë në shtëpi të mëdha dhe të rehatshme. Por e çuditshme është se kur i pyet disa njerëz për gjendjen e tyre, qahen e ankohen prej fukarallëkut, borxheve etj. Mirëpo në fakt, jetojnë në shtëpi luksoze të pajisura me orendi luksoze. Dhe për të përballuar këto shpenzime, jetojnë vazhdimisht me borxhe. A s’është më e drejtë që gjithkush të jetojë në përputhje me të ardhurat e tij, pra siç thonë edhe të parët tanë, “ta zgjasësh këmbën sa ke jorganin”?

Vendet e punës, dyqanet e vitrinat vazhdimisht zbu-

kurohen me dekore luksoze, ndërsa sendet brenda tyre ndërrohen ende pa u vjetëruar. Edhe në çështjen e makinave, gjendja është e njëjtë. Sapo të dalë ndonjë makinë e re luksoze, i gjen menjëherë klientët. Pra, ka shumë njerëz që e ndërrojnë shpesh makinën e tyre.

Tashmë kemi kohë që kemi harruar të arnojmë rrobat e grisura. Madje, nëse çorapet kanë qoftë edhe një vrimë shumë të vogël, që pothuajse nuk duket, hidhen direkt e në plehra. Veçanërisht nëpër dasma... vetëm për një natë dhe për disa orë ceremoni, shpenzohen shuma të mëdha parash për të blerë veshje të veçantë.

I ndjeri Musa Topbash (Allahu e mëshiroftë!), në lidhje me veshjen ka thënë: *"Ne kemi dy veshje: njërën e veshim çdo ditë, ndërsa tjetrën në raste të veçanta."* Të mos harrojmë se këto fjalë i ka thënë një njeri, i cili ishte pronari i disa fabrikave të tekstitit.

Mania për konsumimin e gjërave të luksit po shtohet dita-ditës edhe në fushën e ushqimit. Nëpër vetëshërbimet e hoteleve dhe lokaleve luksoze marrim ushqim aq sa nuk mund ta hamë dhe për fat të keq, një pjesë e hedhim në plehra. Çdo ditë shpiken ushqime, ëmbëlsira, pasta e pije të reja dhe veçanërisht gjatë vizitave si mysafirë, nxirren përherë e më shumë lloje qerasjesh. Pas konsumimit të këtyre të mirave, bëhet dua ja e ushqimit duke lexuar ajetin 31 të sures el-Araf, në të cilin thuhet: **"...Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."** Pastaj, për të lehtësuar tretjen e ushqimit, nuk mjafton vetëm një kafe, por kërkohet edhe nga një ujë mineral me limon. Në fillim hamë ushqime të bollshme me shumë kalori, pastaj shkojmë te dietologu ose nëpër sallonet sportive për t'u dobësuar.

A e kemi një luks të tillë kur ndërkohë, një miliard njerëz në botë vuajnë nga uria dhe çdo 5 sekonda vdes një fëmijë, ndërsa 1.9 miliard njerëz të tjerë kurohen nga obeziteti për shkak të ngrënies së tepërt?

Nëse marrim shembull Turqinë, si një vend me përqindje të madhe myslimanësh, shohim se prej 82 milion bukësh të prodhuara, 5 milion hidhen në plehra. Dhe vlera monetare ditore e atyre bukëve të hedhura në plehra kap shifrën 1,5 milion euro, ndërsa shifra vjetore shkon rreth 550 milion euro. Pra, si duhet ta quajmë këtë luks me shifra kaq të mëdha?

Përsëri në Turqi, tregtia e ushqimeve për kafshët shtëpiake, si macet dhe qentë, kap shifrën 68 milion dollarë. Dhe kur mendon se shumica e këtyre produkteve vijnë nga importi, a s'është pak si tepër luksoze për këtë vend?

Perëndimi, për të nxitur konsumatorët të shpenzojnë sa më shumë në gjëra luksi, ka shpikur lloj-lloj festash, si festa e nënës, festa e babait, festa e të dashuruarve etj., për të cilat prodhohen produkte të veçanta dhe të cilave u bëhen reklama bombastike nëpër mediat e shkruara dhe ato vizive.

Shkëmbimi i dhuratave është gjë e bukur dhe mbi të gjitha është suneti i Pejgamberit (a.s.). Mirëpo, nuk janë të veçanta vetëm për këto ditë. Të gjithë ata duhet të

shkëmbejnë dhurata me njëri-tjetrin, por në mënyrën e duhur dhe aq sa kanë mundësi.

Shpenzimet e tepërta që bëjmë për gjërat e luksit, do të ishte shumë më mirë t'ua dhuronim të varfërve dhe nevojtarëve që gjenden në çdo vend të botës myslimane dhe jo vetëm. Në këtë mënyrë, në botë nuk do të ngelte asnjë mysliman i varfër e nevojtar dhe marrëdhëniet vëllazërore do të forcoheshin më shumë. Në të njëjtën mënyrë, nëse mendojmë që këtë ndihmë materiale ta bëjmë edhe ndaj të varfërve të tjerë jomyslimanë, do të bëheshim shkak që shumë prej tyre ta shihnin islamin e vërtetë.

Vallë, nëse udhëtojmë familjarisht si për umre dhe shkojmë të vizitojmë vëllazërit tanë në vendet e Afrikës e të jetojmë me ta për një javë, a do të ndikonte kjo në zemrat tona të ngurtësuar që janë mësuar me luks?

Për të na zgjuar nga pakujdesia e këtij luksi para se të mbarojë ëndrra e kësaj bote të ëmbël dhe për të na kujtuar se në Ditën e Kiametit do të japim llogari për çdo gjë që kemi, Allahu Teala urdhëron: **"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë"** (e kësaj bote!) (Tekathur, 8.)

Ndërsa Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), duke na këshilluar që për çdo çështje të ndjekim rrugën e mesme, thotë: *"Të sillesh dhe të veprosh me gjakftohësi e maturi, është një prej 25 pjesëve të pejgamberisë."* (Muvatta, Şaar, 17; Ebû Davud, Edeb, 2)

Sa herë që shoh luksin dhe shpërdorimin përreth nesh dhe sa herë që mësoj për luksin dhe shpërdorimin që përjetohet në të gjithë botën, më tingëllojnë në vesh fjalët e Jahja bin Muadhrit (r.a.): *"Ku është umeti i Muhamedit?"* Po! Ku janë ata që marrin shembull Pejgamberin (a.s.)? A nuk duhet ta marrim shembull jetën e tij të thjeshtë, të pastër, bujare dhe modeste?

Pejgamberi (a.s.), i cili me mrekullitë e tij ushqe një ushtri me një kec, ia shoi etjen të gjithë ushtrisë me ujin që rridhte prej gishtave të tij të bekuar, nuk vuajti më kot nga uria dhe etja. Nuk hoqi më kot kur shtrihej nëpër hasra të thata që i linin shenja në trup. Nëse donte, mund të përdorte mundësitë më të mira të kohës. Por jo, Pejgamberi (a.s.), u bë shembull për ne që të mos e lidhim zemrën tonë pas kësaj bote. Madje, pak para se të ndërronte jetë, u shpërndau të varfërve paratë e fundit që i kishin ngelur dhe nuk u la trashëgimi as bashkëshorteve dhe as vajzës së tij të dashur.

Varfëria e tij nuk ishte vërtet prej skamjes, përkundrazi, ajo rridhte prej bujarisë së tij të pashoqe që dhuroi njëqind deve përnjëherë dhe u ndante gjithçka kishte të varfërve dhe nevojtarëve. Ai nuk kishte as pension, as sigurime e as librezë shëndetësie. Mbi të gjitha, marrja prej zekatit dhe sadakasë ishte e ndaluar për familjen e tij.

Allahu Teala na e bëftë të mundur që në sproven e kësaj bote të përkohshme, të jetojmë duke marrë shembull Resulullahun (a.s.) dhe të gjithë të dashurit e Tij, duke e përfunduar jetën tonë në atë mënyrë që Ai të jetë i kënaqur me ne. Amin!

Përmasat dhe mësimet E BETEJËS SË BEDRIT

Nexhat Ibrahimli

HYRJE

Kur Pejgamberi (a.s.), dhe shokët e tij u shpërngulën nga Meka në Medinë, filluan të përshtateshin në mjedisin e ri. Pas shtatë muajsh qëndrimi në shtëpinë e Ebu Ejjubit, Muhamedi (a.s.), u shpërngul në shtëpinë e tij dhe xhaminë përskaj saj në Medinë, të cilat u ndërtuan enkas për këtë qëllim.

Shoqëria e re, që ishte në formim e sipër dhe në rrethana të jashtëzakonshme, po kalonte nëpër faza të ndërlikuara shoqërore: marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve dhe pjesëtarëve të fiseve të ndryshme, myslimanëve ndërmjet veti; sepse disa besimtarë edhe pse ishin bërë myslimanë, mbartnin me vete koncepte dhe shprehje të kohës së injorancës. Përkundër këtyre tensioneve dhe acarimeve të vazhdueshme, arsimimi dhe edukimi shpirtëror megjithatë vazhdonte.

Kjo gjendje e ngritjes drejt së mirës dhe shtrirjes së myslimanëve në të katër anët e botës nxiti mllef dhe frikë në mesin e idhujtarëve në Mekë, sepse ata e përjetuan këtë si përçmim dhe njëkohësisht si kërcënim për veten dhe për të gjithë Gadishullin Arabik. Kjo ishte gjendja emocionale e kurejshëve. Ata ndiheshin të cenuar edhe politikisht, edhe fetarisht, edhe ekonomikisht, si pasojë e ndërtimit dhe forcimit të myslimanëve çdo ditë e më shumë edhe si individë, edhe si bashkësi.

ZËNKAT E MYSLIMANËVE APO LUFTA MES SË MIRËS DHE SË KEQES

Jo të gjithë myslimanët, për arsye të ndryshme, arritën të shpërngulen në Medinë. Kjo në një aspekt i irritoi idhujtarët kurejshë dhe njëkohësisht u dha rast të hakmerren për suksesin e myslimanëve atje. Hakmarrja u përshkallëzua në atë masë, sa që pasuria e muhaxhirëve, e mbetur në Mekë, u grabit krejt nga idhujtarët. Kjo gjendje i detyroi myslimanët të mendonin dhe me veprime paralajmëruese t'i kërcënonin karvanet mekase, që kalonin afër Medinës, duke u dhënë të kuptonin se nuk do të kalonin pa pasoja. Në këtë mënyrë, Pejga-

mberi (a.s.), organizoi disa ekspedita të vogla me qëllim mbledhjen e të dhënave për lëvizjet dhe aktivitetet e kurejshve, pastaj për synimet dhe aleancat e tyre të mundshme etj. Një nga këto ekspedita u shndërrua në konflikt të hapur, edhe pse këtë Muhamedi (a.s.), nuk e dëshironte aspak. Idhujtarët kurejshë i irritoi sidomos aleanca e suksesshme e myslimanëve me disa fise arabe në pjesën veriore të vendit.¹

FILLIMI I SHPALLJES, IKJE NGA MITURIA

Gjatë periudhës së fillimit të shpalljes, Pejgamberit (a.s.), iu shpallën ajete të natyrave të ndryshme, sepse nëse gjatë trembëdhjetë viteve të para myslimanët ishin ftuar të bëheshin të durueshëm dhe t'u përgjigjeshin pasivisht provokimeve dhe dhunës idhujtare, gjatë kësaj kohe shpallja kishte një natyrë tjetër. Myslmanëve tashmë iu lejua vetëmbrojtja, si masë adekuate për mbijetesë:

“Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi dhe, në të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm, që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga vatrat e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: “Zoti ynë është Allahu.” (Haxh, 39-40)

Më vonë, shoku i parë i Muhamedit (a.s.), Ebu Bekri (r.a.), do të thoshte se ky ajet paralajmëroi ndryshimin e gjendjes, pra, konfliktin dhe luftën, si masa për të mbijetuar. Tash e tutje, nga myslimanët nuk kërkohet pasiviteti dhe mosreagimi, por mbrojtja dhe qëndrimi aktiv ndaj zhvillimeve të reja. Reagimi mysliman ishte dykahësh: shpirtëror e intelektual (kundër epsheve) dhe fizik (lufta).

“Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkaktoheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm.” (Haxh, 40)

1. Muhammed Hamidullah, Muhamedi (a.s.), I, Jeta, Logos-A, Shkup, 2011, fq. 181 e tutje.

Zhvillimet më të reja dhe nevojat e myslimanëve imponuan koncepte dhe meditime të reja, sikurse vendosja e barazpeshës politike, ushtarake, ekonomike e tregtare në rajon. Nëpërmjet xhihadit dhe luftës tentohej të arrihej paqja e mirëfilltë kundrejt forcave që gjakderdhjen e kishin mënyrë jetese. Nëpërmjet xhihadit tentohej të gjendej qetësia, kurse nëpërmjet luftës të arrihej rruga e domosdoshme e përkohshme drejt paqes dhe mirëqenies.

NDRYSHIMI I KIBLES APO E ARDHMJA E BOTËS

Ndryshimi i kibles kishte ndodhur rreth dy vite pas arritjes në Medinë. Orientimi (kibla) i myslimanëve gjatë namazit deri atëherë ishte drejt Jeruzalemit, por me urdhrin e ri u bë Meka, përkatësisht Qabja:

“Ne të pamë ty (Muhamed) që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty. Prandaj, ktheje fytyrën tënde nga Xhamia e Shenjtë (Qabja)! Dhe kudo që të gjendeni, kthejeni fytyrën tuaj nga ajo anë! Pa dyshim, ata që u është dhënë Libri (Teurati), e dinë se drejtimi nga Qabeja është e vërteta prej Zotit të tyre. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj punëve që ata bëjnë.” (Bekare, 144)

Ajeti i mësipërm vendosi rregulla të reja në raportet mes besimtarëve myslimanë dhe atyre hebrej dhe të krishterë. Myslimanët u riorientuan drejt Qabes, e cila përbënte lidhjen e vjetër fetare dhe historike, atë me Ibrahimin (a.s.), dhe Ismailin (a.s.), që paraqiste shtëpinë e parë të teuhidit (monoteizmit) islam në histori. Kjo ndodhi i gëzoi myslimanët, por i dëshpëroi, madje i hidhëroi pa masë hebrejtë dhe të tjerët.²

Qysh me vendosjen e myslimanëve në Medinë hebrejtë, përkundër nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëjetesë, shtruan dallimet e tyre në mënyra të ndryshme. Madje, disa prej tyre filluan edhe aktivitetin e fshehtë kundër myslimanëve, duke bashkëpunuar me kurejshët.

Ndryshimi i kibles dërgoi shenja jo të këndshme edhe për banorët e Mekës, të cilët këtë ndryshim e kuptuan si kërcënim real e të drejtpërdrejtë. Për më tepër, ata filluan të mendonin të mobilizoheshin për mënjanimin

e këtij kërcënimi, jo vetëm të gjendjes momentale, por edhe të privilegjeve historike që kurejshët i kishin arritur në të kaluarën.³

KARVANI, PRETEKS PËR VENDOSJEN E RENDIT

Ebu Sufjani me një karvan të madh mallrash kthehej nga Siria për në Mekë. Myslimanët mësuan për këtë lajm, prandaj Muhamedi (a.s.), vendosi t’ua priste rrugën, me qëllim që së paku pjesërisht, t’i kthenin mallrat e myslimanëve që kurejshët ua kishin uzurpuar në Mekë. Kishte edhe një faktor tjetër: myslimanët duhej të imponoheshin si forcë e re rajonale kundrejt kurejshëve në Mekë.

Myslimanët me mbi 300 ushtarë, ensarë dhe muhaxhirë, me një armatim personal të pakët dhe të dobët, synuan ta sulmonin karvanin, edhe pse ende nuk ishin të përgatitur ushtarakisht. Mirëpo, edhe pse planifikimet



e myslimanëve ishin sekrete, kurejshët dhe Ebu Sufjani morën vesh për planet e tyre. Ebu Sufjani menjëherë i njoftoi mekasit për rrezikun e mundshëm dhe për ndihmën që ata kishin nevojë. Mirëpo, ai ndërkohë ndërroi kahun e ecjes së karvanit, për t’u shmangur kërcënimit të myslimanëve. Me këtë veprim, ai arriti t’i shmangej rrezikut nga myslimanët, por lajmi i shmangies së konfliktit nuk i kënaqi kurejshët, kështu që ata, me këmbënguljen e Ebu Xhehlit dhe fanatikëve të tjerë,

vendosën t’i luftonin myslimanët. Kurejshët qenë nisur me një ushtri prej mbi një mijë ushtarësh të armatosur mirë. Kështu, planet e myslimanëve ndryshuan. Nuk bëhej fjalë më për një ekspeditë të vogël, por për një luftë “për jetë a vdekje”.⁴

KËSHILLIMI, IKJE NGA NËNSHTRIMI I VERBËR

Para alternativës të ndiqte karvanin, të kthehej në Medinë apo të rrezikonte e të përballej me kurjeshët, Muhamedi (a.s.), vendosi të këshillohej me miqtë e tij të ngushtë. Ebu Bekri (r.a.), dhe Omeri (r.a.), treguan gatishmëri për të luftuar, kurse Mikdad ibn Amri theksoi fuqishëm: “Ec para, ti dhe Krijuesi yt, dhe lufto dhe ne do të luftojmë me ty, nga e djathta dhe e majta, para

3. N. Ibrahim, Jeruzalemi mysliman shembull i bashkëjetesës së feve qiellore, Revista ETIKA, Shkodër, nr. 62/2013, fq. 21.

4. Muhammed R. Kal’ahxhi, Ličnost posljednjeg Allahovog Poslanika, El-Kalem, 1427/2006, Sarajevë, fq. 219 e tutje.

2. Shawqi Abu Khalil, Atlas on the Prophet’s Biography – Places, Nations, Landmarks, Darussalam, Riyadh, 2003, fq. 108-109.

dhe pas teje.⁵ Po këtë përgjigje konfirmuese mori edhe nga ensarët. Sa'd ibn Muadhi, në emër të tyre tha: "Bëj ç'të duash, ne jemi me ty. Pasha atë që të dërgoi me të vërtetën, nëse nga ne kërkon të ecim nëpër det dhe këtë e bën edhe ti, ne do të të ndjekim. Askush nga ne nuk do të mbetej pas."⁶ I trimëruar nga vendimi i të dyja palëve, Muhamedi (a.s.), vendosi të ecte para dhe të përballej me mekasit, duke mos u trembur nga dredhitë dhe kërcënimet e tyre.

Muhamedi (a.s.), duke u këshilluar me miqtë e tij instaloi institucionin e këshillimit, inicoi gjykimin kritik, mundësoi përshfaqjen e prirjeve të tyre në prani të tij. Zakonisht, mendimin e tij e shprehte vetëm në fund të diskutimit të gjallë e të pasur nga ana e shokëve të tij. Madje, ai e nxiste mendimin kritik, duke shtruar pyetje: "Nuk është i fuqishëm ai i cili e mund armikun!" Shokët menduan dhe pastaj e pyetën: "Kush është i fuqishëm, pra"? Pejgamberi (a.s.), u përgjigj: "I fuqishëm është ai, i cili e kontrollon veten kur është i zemëruar!"⁷

Këshillat dhe mendimet e miqve përfilleshin në masë të madhe edhe për çështjet më serioze, siç është strategjia e luftës. Shembulli i Bedrit është rast tipik: Habbab ibn El-Mundhiri (r.a.), duke parë strategjinë e Muhamedit (a.s.), në Bedër, pyeti: "Ky vend ku jemi ndalur, a të është shpallur nga Zoti dhe nuk mund të lëvizim para apo pas apo ky është mendimi dhe strategjia jote?"⁸ Në përgjigjen e Muhamedit (a.s.), se ky është mendim i tij dhe jo shpallje, Habbabi sugjeroi plan tjetër, të cilin Muhamedi (a.s.), e aprovoi dhe plani doli fitues.

Shokët e Muhamedit (a.s.), ishin në nivel të kënaqshëm të përgjegjësisë. Ata bënë dallimin mes Shpalljes dhe mendimit njerëzor, qoftë ai edhe i Muhamedit (a.s.). E kishin kuptuar se mendimet njerëzore të Muhamedit (a.s.), janë të diskutueshme, kurse autoriteti i tij nuk ishte i pakufizuar, siç ndodh me mbretërit e liderët e shumë botërorë në të gjitha fazat e historisë njerëzore.⁹

BETEJA NË BEDËR, FILLIMI I HISTORISË SË MIRËFILLTË

Lufta po afrohej, kurse Muhamedi (a.s.), nëpërmjet Omerit (r.a.), u përpoq t'i bindte kundërshtarët t'i shmangeshin konfliktit. Edhe disa kurejshë e patën këtë bindje, mirëpo fanatikët e tyre nuk lëshuan pe, ndërsa ofertën e myslimanëve për paqe e morën si shenjë dobësie. Ata menduan se erdhi çasti kur përfundimisht myslimanët do të zhdukeshin nga skena

5. Ibn Hisham, *Es-siretu-n-nebewijje, pa vend dhe vit botimi*, 3, 161.

6. Po aty, fq. 3:162.

7. Transmeton: Buhariu dhe Myslimi.

8. Ibn Hisham, *Es-Siretu'n-nebewijje*, 3, 167.

9. Muhammed R. Kal'ahxhi, po aty, fq. 205 e tutje.

historike.

Duke e parë se nuk kishte zbrapsje, Muhamedi (a.s.), mori vendimin për kundërvënie ndaj kundërshtarëve, të cilët kishin ardhur nga Meka në afërsi të Medinës. Gjithashtu, ai i trimëroi shokët e tij për fitore, duke u paralajmëruar: "Pasha Atë, në dorë të të cilit është shpirti i Muhamedit, kushdo që vdes sot, duke luftuar me shpresë në shpërblim, duke përparuar e jo duke u zbrapsur, Allahu mënjëherë do ta fusë në xhenet!"¹⁰

Beteja ndodhi në ditën e 17 të Ramazanit, në vitin e 2-të Hixhri (624 G.). Me këtë rast theksoi lehtësitë që ata duhet të gëzojnë në rastet kur kanë vështirësi: "Lehtësoni e mos vështirësoni. Përgëzoni e mos kërcënoni!"¹¹

Pas tre dyluftimeve, në të cilat Hamzai (r.a.), dhe Aliu (r.a.), fituan, kurse Ubejdullah ibn Harisi vdiq, filloi lufta trup me trup, por vendosmëria e myslimanëve mposhti një numër trefish më të madh prej kundërshtarëve. Myslimanët fituan, kurse lajmi për fitoren e tyre shpejt u shtri në tërë gadishullin arabik. Humbjet e myslimanëve ishin 14 luftëtarë, kurse të kundërshtarëve 70 të vrarë dhe 70 robër lufte, ndër të cilët edhe Abbasi, xhaxhai i Muhamedit (a.s.).¹²

Kurejshët idhujtarë, në fillim krenarë dhe mburracevë, u kthyen në Mekë të poshtëruar e kokulur por tërë mllef e pezëm që së shpejti do të hakmerreshin ndaj myslimanëve për këtë humbje poshtëruese dhe të papritur.

Ato që jetojnë gjithnjë janë mësimet që rrjedhin pas Bedrit: luftimi fisnik kundër rivalëve, njerëzillëku gjatë luftës ndaj kundërshtarëve, trajtimi i robërve të luftës si asnjëherë më parë dhe dalja e myslimanëve jashtë kornizave lokale, e bënë fenë islame fe të botës, fe kozmopolite.

PËRFUNDIM

Edhe pse Beteja e Bedrit historikisht dhe kohësisht ka ndodhur qysh moti, ajo nuk ka pushuar të bëhet frymëzim edhe për brezat e sotëm të myslimanëve të botës. Për fat të keq, ky frymëzim ka ngecur vetëm në rrafshin emocional dhe individual. Fusha shoqërore, politike, ushtarake, ekonomike, arsimore e të tjera i janë lënë kujtesës historike, ceremonialeve e përvjetorëve, që është një porosi e qartë, se dashje pa dashje, kemi rrëshqitur nga mësimet themelore të Betejës së Bedrit. Është koha e fundit për ndryshim qëndrimesh, duke e bërë Bedrin burim të frymëzimit bashkëkohor.

10. Po aty, 3: 175.

11. Shih hadithet për lehtësim e jo vështirësim, të cilët i transmetojnë Ibn Mundhiri dhe Buhariu e Myslimi.

12. Martin Lings, Muhamedi (a.s.), Logos-A, Shkup, 2011, fq. 171 e tutje.

MESAZHI I MIRAXHIT

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

Udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit nuk ndodhi rastësisht prej Mekës nëpërmes Kudsit Sherifit. Rëndësia e këtij udhëtimi është e madhe sepse është rrugë e ngjarjeve të rëndësishme dhe pikëtakimi i shumë pejgamberëve të Allahut. Ky fakt mundëson që Islami të jetë feja që bashkon dhe plotëson në vete të gjitha shpalljet e pejgamberëve të mëparshëm. Këto ishin gjurmë historike që iu treguan Muhamedit (a.s.), i cili diti t'i lexonte dhe në bazë të këtyre përvojave mori hov për hapjen e vizionit islam në të gjithë botën. Përvoja historike është faktor me rëndësi i urtësisë jetësore. Këtë e thekson vetë Allahu i Madhërishtëm në disa vende në Kuran, ku i fton njerëzit të udhëtojnë nëpër botë dhe të shohin si ishte përfundimi i atyre brezave që jetuan para nesh, ngase ligji i jetës është i pandryshuar:

“Ti kursesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet.”
(Ahzab, 62)

Por mjerisht, ymeti sot nuk di t'i lexojë gjurmët e historisë, të cilat shihen për çdo ditë. Për këtë arsye, sionistët sot nuk e kanë vështirë t'i kundërvihen gjithë ymetit dhe pikërisht nga muret e Kudsit të Shenjtë. Ndaj, është e qartë se leksionin nuk e kemi mësuar. Ndërsa Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka paraparë këto kriza dhe ka tërhequr vërejtjen. Duhet kuptuar që hapësira dhe koha nuk janë në favorin tonë, pikërisht se jemi myslimanë. Edhe hapësira edhe koha janë aleatë të atij që i kupton. Mbledhja e gjithë pejgamberëve dhe pejgamberit tonë Muhamedit (s.a.v.s.), në një vend, është tregues i unitetit njerëzor, vula e të cilit është pejgamberi i fundit, Muhamedi (a.s.). Miraxhi gjithashtu bëri ndarjen dhe seleksionimin në mes besimtarëve të sinqertë dhe hipokritëve. Miraxhi tregoi mëshirën e Allahut të Madhërishtëm ndaj njerëzve, por edhe tërë fisnikërinë e Pejgamberit (s.a.v.s.). Ky pejgamber (s.a.v.s.), i dha përparësi ymetit mbi veten. Kur i Lartësuar i pyeti çfarë dëshironte prej Tij, Pejgamberi (s.a.v.s.), asgjë nuk kërkoi për vete. Nuk kërkoi shpërblim që do ta kënaqte shpirtin e tij. Përparësi i dha ymetit, duke na mësuar njëherësh edhe ne që me sakrificë dhe punë për mirëqenien e të gjithëve vërtetohet madhështia morale e

njeriut. Ai i tha Allahut të madhërishtëm:

“Nuk do të jem i kënaqur, përderisa një njeri nga ymeti im të jetë në zjarr.”

NAMAZI ËSHTË MIRAXHI I BESIMTARIT

Një gjë tejet e rëndësishme, që duhet theksuar kur flitet për Miraxhin, është fakti se Pejgamberi (a.s.), nga ky udhëtim madhështor i kthehet ymetit me urdhrin e faljes së pesë kohëve të namazit. Sa i fuqishëm është ky urdhër, dëshmon fakti se iu shpall Pejgamberit (a.s.), kur ishte në vendin më të lartë, ndërsa urdhrat e tjerë, si agjërimi, zekati, haxhi, etj., zbritën përmes Xhebrailit (a.s.), në tokë. Namazi pra, është obligimi i urdhëruar në sferat më të larta, për këtë duhet të ruhet shumë. Namazi është dhuratë e artë që Pejgamberi (s.a.v.s.), na e solli nga vendi më fisnik. Kjo dhuratë na mundëson takimin pesë herë në ditë me Zotin e botëve. A ka diçka më të bukur se kjo? Hyrja në namaz do të thotë hyrje në audiencën Hyjnore. Në momentin kur robi e thotë tekbinin fillestar “Allahu ekber”, i Lartësuar i kthehet nga ai dhe e shikon. Në këtë mënyrë, secili individualisht mund të ketë miraxhin e tij personal. Duke u falur prej njeriut namaz në tjetrin, myslimani për çdo ditë në kohë të caktuar shkëmben përshëndetjet me Zotin, në të njëjtën mënyrë siç bëri edhe Pejgamberi (s.a.v.s.), në Miraxh. Vepra më e vlefshme, thotë Pejgamberi (s.a.v.s.) është: ***“Namazi në kohën e tij”***. Gjithashtu në hadithet e saktë transmetohet që Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *“Namazi është çelësi i Xhenetit!”*; *“Namazi është drita e besimtarit!”*; *“Namazi është ilaçi i besimtarit!”*. Namazi është qëllimi i ekzistencës. Për këtë arsye është krijuar njeriu: ***“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”*** (Dharijat, 56) Është interesant që edhe fjalët e fundit që Pejgamberi (a.s.), ia drejtoi ymetit ishin: *“Namazi o ymet, namazi. Dhe frikësojuni Allahut në çështjen e atyre që i keni nën urdhrat tuaj.”* O Zoti ynë, premtimi Yt që ia dha Pejgamberit (s.a.v.s.), në Miraxh është i fuqishëm. Na bëj pasues të sinqertë të ymetit të tij dhe na mundëso ndërmjetësimin e tij në Ditën e Gjykimit!



Flasë për lumturim

Dr. Aid El-Karni

1. Buzëqeshja: buzëqeshja magjepsëse është garancia e miqësisë dhe karta e identitetit. Lëshoje atë në fytyrën e vëllait tënd në çastin më të parë, pa u luhatur, sepse të buzëqeshurit ndaj vëllait tënd, duke e parë në fytyrë konsiderohet sadaka. Me të ti arrin të blesh miliona zemra dhe njerëzit nuk e harrojnë atë qeshje vezulluese sa të jesh gjallë, pasi në të gjendet shpresa, besimi, dhembshuria, dashuria dhe optimizmi.

2. Fjala e mirë: fol qetësisht, me butësi dhe brishtësi. Zgjidh fjalët e marrëveshjes dhe paqes, lëvdoje shokun tënd dhe lutu për të, ruaje veten nga fjalët kryelarta, dominuese, tallëse dhe përçmuese, pasi ato janë rruga e rrëzimit dhe rrënim. Me to e kapitullon reputacionin tënd, e shkatërron stadin tënd dhe shndërrosh në burim urrejtjeje, zemërimi dhe sharjeje.

3. Modestia: jeta është e shkurtër dhe të gjithë ne do t'i rikthehemi tokës, teksa origjina jonë është nga i njëjti baba dhe e njëjta nënë, dhuntitë tona nuk na bëjnë të kemi epërsi, pasi vetëm Allahu është Ai që na e dha këtë epërsi, kuptoje veten dhe tregohu modest, ulë kokën para Zotit të lavdisë dhe plotfuqisë. Ti o njeri, je prej dheu, ecën mbi dhé e varrosesh në të. Mos u shquaj ndër njerëz, se kanë për të të përçmuar dhe urreyer. Jepu atyre shans të gëzohen për arritjet e tyre, dhurojua pranimin tënd, modestinë tënde, që të jesh tek ata më i dashur se fëmijët e tyre.

4. Përmbaju altruizmit: fiksikët u japin prioritet të

tjerëve kundrejt vetes së tyre. Ushqimi yt në barkun e tjetërkujt është më i shijshëm se në barkun tënd, rroba jote në trupin e tjetrit është më e bukur se në trupin tënd. Mos domino mbi sendet, shpenzoje çehren, pozitën, ushqimin, mallin dhe kohën tënde për njerëzit, në rrugë të Allahut e kështu do të jesh më i lumturi.

5. Dëgjoje me kureshtje bashkëbiseduesin: bëja veshin pipëz atij që po të flet, përqendrohu tek ai dhe dëgjoje me vëmendje nëse të flet, mos u merr me gjë tjetër ndërkohë që tjetri të flet, dhuroja atij vështrimin dhe dëgjimin tënd, derisa të ta thotë krejt atë që ka për të të thënë. Vetëm duke e dëgjuar me vëmendje do ta robërosh shpirtin e tij dhe do të marrësh konsideratën e tij. Ti ke një gjuhë të vetme dhe dy veshë, pra dëgjo shumëfishin e asaj që flet, lëri shokut tënd shans të flasë rreth vetes së tij, lëre atë ta shkarkojë energjinë dhe ngarkesën e fjalës.

6. Duhet të falësh: fali njerëzit, varrosi gabimet e tyre, harroji të këqijat e tyre dhe kaloje në heshtje sharjen e tyre, që zemra jote të kullohet dhe të fitosh mijëra zemra, të arrish amnistinë e Allahut dhe faljen e Tij. As mos e ço ndërmend hakmarrjen dhe mos bëj monolog me veten për kompensim. Jeta është shumë e shkurtër dhe Allahu e do faljen. Nëse ti i fal robërit e Tij, edhe Ai të fal ty.

7. Komuniko me atë që është shkëputur nga ti: është gjë e bukur të komunikosh me dikë që është i

lidhur me ty, por më e bukura dhe më e mrekullueshme është të komunikosh me atë që është shkëputur prej teje, pasi kësaj ti verifikon dëlirësinë e shpirtit tënd, pastërtinë e brendisë tënde dhe ji i meritueshëm për mirësitë që Allahu ka zbritur mbi ty. Provo të komunikosh dhe të lidhesh me atë që sillet thatë me ty dhe do ta gjesh atë një shok tëndin. Urrejtja e tij do të shndërrohet në dashuri rrjedhëse dhe kompliment të parfumuar; e ti ke për t'i vjelë frytet.

8. Jepi atij që të privon: ndjenjat, dhuratat dhe donacionet lidhur me njerëzit, mos i trajto me standardin e shitblerjes, as me kandin e fitimit dhe humbjes, por trajtoji me fisnikëri dhe mirësi. Atij që të privon nga diçka, ti nga ana jote jepi, atij që tregohet koprrac me ty, ti nga ana jote bëji favor; që të arrish shpërblimin, përfitimin, komplimentin e bukur, kompensimin në zbulimin e shpirtit, shëndetin e trupit dhe ndalimin e të keqes së armiqve.

9. Fale atë që të ka bërë padrejtësi: amnis-toje dhe fale atë që sillet padrejtësisht me ty. T'ia marrësh armën e vet nga dora, t'ia thyesh shkopin, t'ia kthesh shpatën në mill, ta bësh të bëhet pishman e të ndihet fajtor, ta bësh të të kërkojë ta pëlqesh, ta kërkojë me ngulim pajtimin me ty. Kur ti e fal atë që të ka hyrë në hak, kjo përbën për ty një fitore të qartë dhe triumf të skajshëm. Urime, nëse tregohesh falës dhe tolerant.

10. Largoju përgojimit: përgojimi është cofëtinë e dekompozuar, moral i ulët, cilësi e pështirë. Ruaje gjuhën tënde prej saj, pastroje gojën tënde nga rënia në ndret e njerëzve, mos i ha mishrat e njerëzve, pasi ato janë të helmatisura, mos i përmend njerëzit veçse për mirë, mos gërmo për të metat e tyre, mos u gëzo nga shkarjet e tyre, mos i publiko gabimet e tyre, që të jetosh në paqe dhe siguri.

11. Mos mbaj dinamit në xhepa: boshatisu nga urrejtja dhe armiqësia, laje zemrën tënde me drejtësi, që të ëndesh në xhennetin paraprak të qetësisë dhe prehjes, të jetosh në pajtim me veten dhe njerëzit. Mos e bëj zemrën tënde rrënojë ku strehohen brenda akrepa dhe gjarpërinj, por bëje atë parcelë lulësh, frutash, zogjsh dhe lumenjsh.

12. Shtriji urat e komunikimit që ta shpëtosh anijen tënde prej fundosjes: mbill në zemra pemët e dashurisë, sepse kjo është në favorin tënd. Bëje shprehi të shoqërohesh me njerëzit dhe t'u fitosh simpatinë, bëj kujdes të mos humbësh ndokënd prej njerëzve, nëse e

ke të mundur ta fitosh atë.

13. Kujdes se mos të fanit shejtani që ti je njeriu më i mirë: hiq dorë një herë e mirë nga nyja e iluzionit, që të bën të mendosh mbi meritat e tua personale dhe të sodit dhuntitë e tua, për të rënë kësaj pre e fantazisë se ti je uniku i epokës tënde dhe më i miri i bashkëkohësve të tu, gjë e cila është tërësisht një mashtrim dhe manipulim, prej psonisjeve të shejtanit. Në botë ka mijëra dijetarë, fisnikë, të urtë, gjeni dhe yje, që janë më të mirë se unë dhe se ti, me qindra herë. Reduktoje vetëkënaqësinë, ulë kokën, kija drojën Zotit tënd dhe tregohu modest me bijtë e sojit tënd human... Në qofsh dijetar, dije se në kombin tënd ka dijetarë edhe më fisnikë e më të merituar dhe në qofsh shkrimtar, dije se rreth e rrotull teje gjenden shkrimtarë edhe më të shquar e më të urtë se ti... Kësaj, pranoje realitetin dhe përtype vetveten.

14. Njihni dhuntitë e njerëzve, që ata t'i njohin të tuat: prej gjërave më të vështira për shpirtin humanë, është mohimi i dhuntisë dhe intelektit si dhe lënia në hije nga ana e tyre, e meritave të të tjerëve. Nëse dëshiron që njerëzit të ta njohin dhuntinë dhe intelektin tënd, njihua atyre dhuntitë dhe falënderoju me zemër e vepra; zotërimi i të tëra dhuntive nuk është një ekskluzivitet vetëm i yti, porse realiteti qëndron se njerëzit bartin dhunti që nuk janë prezente te ti. Kështu, nëse ti je poet, tjetri është lektor, nëse ti je sipërmarrës, tjetër është mjek, ministër, inxhinier apo pilot... Si po tenton ta monopolizosh dhuntinë e gjerë të Allahut, teksa në mesin e njerëzve gjendet dikush që ka aftësi intelektuale mbi ty dhe epërsi ndaj teje në çdo dhunti?

15. Pas një farë kohe nuk do të jesh më në këtë botë: mendo sesi do ta lëshosh këtë jetë së shpejti, ndaj angazhohu të kesh raporte sa më të denja me njerëzit, që pas vdekjes të përmendesh për mirë dhe ata të bëjnë lutje për ty. Nga kjo botë nuk ke për të marrë asgjë tjetër veç punës tënde. Ti erdhe përkohësisht në këtë dynja dhe ke për të ikur nga ajo ashtu siç ikën të tjerët para teje, që t'u jepet mundësia të tjerëve që vinë pas teje. Tregohu dinjitoz me njerëzit, pasi ti s'je veçse në një udhëtim të shkurtër.

16. Lëre kompleksin e fobisë prej intrigës dhe pusisë që njerëzit po të kurdiskan ty: njerëzit s'e kanë mendjen as tek unë dhe as tek ti. Ata kanë hallet, shqetësimet dhe brengat e tyre. Jeta është e vështirë dhe



po e angazhon njeriun tërësisht me veten, pa dashur t'ia dijë për botën mbarë. Mos hamendëso se të tjerët po rrinë pa gjumë duke kurditur të keqen tënde apo se ata janë të shqetësuar me irritimin tënd. Pastroje mendjen nga këto bindje, që të bëjnë viktimë e hamendësisë se ti qenke preja e gjykatësit, privatit, kolegut, tregtarit dhe mbarë shoqërisë. Jetoje qetësinë dhe mbështetu tek Allahu. Asgjë nuk ka për të të goditur, veçse me lejen e Tij.

17. Askush nuk mund të marrë gjë nga rizku (furnizimi) yt: furnizuesi është Allahu Një i Vetëm. Ai ua ka ndarë furnizimin robërve, askush nuk do të marrë nga furnizimi dhe as nga dhuntia e tjetrit. Mos ki smirë askënd për atë që Allahu i ka dhënë dhe mos ki dert për mirësitë e tua, pasi askush nuk mund të arrijë tek to. Të gjitha depozitat i disponon Allahu, andaj gjithë sa dëshiron kërkoja Zotit tënd, pasi njerëzit nuk kanë në dorë as dëm, as dobi, as vdekje, as jetë dhe as ringjallje. Braktise egoizmin, babëzinë dhe zemërngushtësinë. Begatia është e shumtë dhe askush nuk mund ta privojë tjetrin prej saj.

18. Jeta është bashkëpunim, ndaj mos i anullo rolet e të tjerëve: disa njerëz mendojnë se jeta varet prej tyre, gjë që ua ekzagjeron në mendje dhuntitë e tyre intelektuale, teksa e vërteta është se jeta do të vazhdojë edhe pa ta, krejt siç ishte çështja edhe para ekzistencës së tyre. Jeta nuk është peng i sojit të dijetarëve, gjykatësve, tregtarëve, pedagogëve dhe mjekëve, por realiteti qëndron se ajo ngrihet mbi energjitë, kontributin dhe dhuntitë që vijnë nga të gjitha sojet, kategoritë dhe ngjyrimet. Nëse Allahu të ka dhënë një dhunti, dije se përkundrejt saj ka dhunti të panumërta në këtë univers, dhe dhuntia jote midis tyre s'është veçse një thërmijë. Ti i tëri s'je veçse një pikë e vockël në oqean. Nëse don të jetosh, të duhet ta njohësh kapacitetin tënd dhe të mos e përçmosh atë të të tjerëve.

19. Kur të takon të gjendesh në dyndje njerëzish dhe trafik, sillu me delikatesë: ty si, çdo njeriu, të takon të kalosh nëpër situata dyndjesh në aeroport, spital, panair ndërkombëtar apo arenë e ambiente të tjera. Në këto rrethana lypset të reagosh butësisht, që të fitosh respektin e të gjithëve. Lëshojua vendin të tjerëve që të bëjnë përpara. Kjo dyndje do zgjasë vetëm pak momente nga jeta jote e pastaj problemi mbaron dhe ti del i freskët dhe i gëzuar. Merri në konsideratë situatat e njerëzve. Ndër to gjendet i thyeri në moshë,

dijetari, i sëmuri, fëmija... Trajtësoje ndër ta delikatesën dhe modestinë tënde. Jepu atyre prioritet, që prej tyre të marrësh lutje, lavdërim, kënaqësi dhe dashuri.

20. Merru me mëkatet e tua dhe jo me ato të njerëzve: problemi i shumëkujt prej nesh është se ne merremi me fajet dhe gabimet e të tjerëve dhe harrojmë tonat, duke na u dukur vetja si të ishim engjëj të dëlirë apo profetë të pagabueshëm e paskëtaj na hip mendja mbi flokë e u krekosemi robërve të Allahut... A thua se koha e mbetur në këtë dynja na premtan të inspektojmë dosjet e njerëzve dhe të zbulojmë shkarjet e tyre. Ekspozoja e çmendurisë më të madhe, është kur zhytesh në fajet e të tjerëve, teksa vetë je i kredhur në një det fajesh dhe mëkatesh. Nëse merrsh me të metat e tua, një gjë e tillë s'të lë kohë të merrsh me të metat e njerëzve. Madje kësisoj, i mëshiron ata, të dhimbsen, pajtohesh me ta, e braktis arrogancën, mahnitjen dhe kotësinë.

21. Zbrit te mendësitë e njerëzve të thjeshtë dhe shqetësimet e masës:

jo të gjithë njerëzit janë dijetarë, filozofë dhe gjeni, porse realiteti është se shumica e njerëzve i përkasin masës së gjerrë, ndaj sillu me ta me modesti dhe thjeshtësi. Mos u ekspozoj atyre aftësitë dhe muskujt e tu. Folu me dialektin e tyre dhe sipas kapacitetit të tyre, në don t'u fitosh zemrat atyre. Bëhu pjesë e festave dhe gëzimeve të tyre dhe mos e tepro të flasësh me ta me fjalë të thella, sepse kështu shndërrohesh për ta në një person të rëndomtë, që ata s'e honepsin. Sillu thjesht, lehtësisht, qasju mentalitetit dhe gjuhës së tyre, lëre ekspozenë e dhuntive të tua, pasi e tillë gjë ka për të të kushtuar vetëm urrejtje dhe ftohje.

22. Respektoji emrat dhe mos i anashkalo titujt e nderit:

thirri shokut tënd me emrin e tij më të bukur, pasi kjo është thirrja që i tingëllon atij më bukur në vesh, por mos i neglizho titujt e tij të nderit që i ka fituar me mund në jetë, si për shembull, artikulumin shejkh (profesor), i nderuar, hazret, shkelqësi, doktor, inxhinier, etj. Ç'tjetër do përfitosh nga anullimi i këtyre titujve, veç armiqësisë dhe paraqitjes tënde me rrobën e smirëziut dhe mohuesit? Ua dhe ti atyre këta tituj nderi apo i arritën ata me përpjekjet dhe djersët e tyre? E pse pra do që t'i anashkalosh ata? Nderoj njerëzit, që të nderohesh prej tyre dhe respektoji, që të respektohesh.

23. Njerëzit do të të trajtojnë ashtu siç i trajton:



siç silllesh, do të sillen me ty. Atë që jep edhe do të marrësh. Moralet janë si treg: paguaj shtrenjtë dhe ke për të marrë mall të shtrenjtë, paguaj lirë dhe ke për të marrë mall të lirë. Nëse i përshëndet njerëzit, ata të përshëndesin e, nëse silllesh ftohtë me ta edhe ata do të sillen ftohtë me ty. Si kërkon të vlerësohesh dhe mbështetesh nga të tjerët, teksa ti vetë abuzon me të drejtat e tyre? Nëse nderon njerëzit, ke nderuar vetveten, nëse i përbuz ata, vetveten ke përbuzur, pra zgjidh për veten tënde atë që do, shpërblimi është në bazë të veprës së bërë.

24. Lëri armikut një linjë tërheqjeje: nëse konfliktohesh me dikë, lër vend për marrëveshje. Ti nuk di se deri ku mund të arrijnë pasojat. Të mundësosh një pajtim, do të thotë të mos e shtosh numrin e rivalëve. Njëmijë shokë janë pak, teksa një armik i vetëm është shumë. Bërja e çdokujt armik ta shqetëson mendjen dhe të turbullon kujtesën, dëm ky i mjaftueshëm. Prej çdo personi dalin gabime dhe ato do mund të eliminohen, nëse tregohesh i matur dhe i përmbajtur, nëse e kuron rivalitetin që në nise, para se të trashet.

25. Mos sfido askënd: mos fto në sfidë asnjë prej njerëzve. Bile, nëse të përmendet ndonjë gabim që ti ke bërë, folësit nxirri në pah se çështja është e pranueshme, se midis teje dhe tij sundojnë lidhje dhe raporte superiore, që nuk lejojnë që situata të përkeqësohet. Bëj kujdes të mos i hakërrehesh dikujt se do t'i bësh keq, pasi kjo bart kuptimin se ti je një burim frike dhe stresi, gjë që do t'i bëjë njerëzit të ta kenë frikën dhe do të të shndërrojë në një agresor, që përbën kërcënim për njerëzit. Thirr në paqe, dashuri, shoqëri dhe harmoni.

26. Shndërroji armiqtë e tu në shokë: urtësia dhe humanizmi angazhojnë që armikun ta bësh shok, duke gjetur gjuhën e përbashkët dhe duke i shtrirë urat drejt tij, teksa shndërrimi i shokut në armik është padyshim kulmi dhe skaji i budallallëkut. Reago me mend dhe përgjegjësi. Dërgoji mesazhe pozitive rivalit tënd dhe aspiro që ai të të kthehet në shok, kështu shpëton nga gjëmat e tij dhe fle i qetë. Me butësinë tënde përthithe mllefën e rivalit tënd, për të qenë ti vetë i fituari dhe i lumturi.

27. Ekspozoju diellit dhe lahu me dritën e tij: dielli është mirësi madhështore për gjallesat. Mos e privo vetveten nga rrezet e tij, ekspozoju atij dhe laje trupin tënd me dritën e tij; pasi ai i vret parazitët e trupit, e pajis trupin dhe gjakun me energji, e lulëzon shpirtin,

sidomos në kohën pak pas agimit. Hapja në këtë kohë dritës së diellit dyert dhe dritaret. Lëre atë të hyjë në dhoma, të rrënojë mikrobet dhe rinovojë jetën.


28. Asnjeri nuk është i kulluar, prandaj pranoji njerëzit ashtu siç janë: pranoji ata, fali, tregohu i duruar me ta dhe mos vendos kushte të rënda për t'i qasur njerëzit apo për t'i bërë shokë, pasi, nëse të tilla kushte do i zbrisje në realitetin tënd, do e gjeje veten të padenjë. Allahu është Krijuesi, Furnizuesi. Ai qëndron mbi robërit e Tij, të cilët u detyrohen dhuntive të Tij. Ai u bën lëshime dhe i fal ata. Nuk je ti krijuesi dhe furnizuesi i njerëzve, që t'i marrësh ata në llogari për të mëdha e të vogla, prandaj pajtohu me dobësinë e tyre njerëzore dhe bëj lëshime, që t'i fitosh të gjithë ata.

29. Sënduku familjar i bamirësisë: në shtëpinë tënde bëj një sënduk të vogël me çelës, që të hapet çdo muaj dhe në të çdo anëtar i familjes të vendosë për çdo ditë qoftë edhe disa qindarka. T'i vendosë ato me dorën e tij, që ta shijojë ëmbëlsinë e dhënies së lëmoshës. Pastaj në fund të muajit, shumë që u mbledh shpenzoje për nevojtarët, të varfrit dhe jetimët. Çdo muaj ky sënduk të jetë sënduk i mëshirës dhe bereqetit, largues i fatkeqësive dhe sëmundjeve, që kurrsesi nuk e zvogëlon kapitalin tënd, por përkundrazi, e shton atë.

30. Mos e vështro me ëndje fatkeqin: gjithkush nga ne do sprovohet në jetë me ndonjë fatkeqësi. Pse pra duhet të gëzohemi me fatkeqësitë e të tjerëve? Kush prej nesh ka garanci se nuk do të sprovohet? Të gjithë ne jemi të dobët, nën Vullnetin e Allahut, ndaj falënderoje Allahun për shëndetin, lutu për të mirën e të gjithëve dhe mos u gëzo me fatkeqësitë e të tjerëve. Bota rrotullohet dhe nxjerr në pah se ai që gëzohet me fatkeqësinë e tjetrit është i marrë, i pashpirt dhe i pamëshirshëm, teksa ajo që duhet është të solidarizohesh me personat në fatkeqësi, të qëndrosh në krah të atij që vuan dhe të ndjesh dhimbje për robërit e Allahut.

31. Shkruaj një program ditor: bëj për çdo ditë, në varësi të punës tënde, një plan të studiuar, ku të dedikosh kohë për adhurimin, leximin, namazin, vizitën, kryerjen e angazhimeve. Përmbaju këtij programi, përveçse në raste domosdoshmërie dhe kështu ke për të parë se do ta kalosh ditën tënde i lumtur, i qetë dhe i prehur. Do të shpëtosh nga destabilizimi dhe rrëmuja, angazhohu me disiplinë, që të jetosh i qetë.

Përktheu: Altin Torba



Teoria e B

në peshoren e versionit kur

Teoria e Big Bengut thotë, se qiejt dhe toka ishin të ngjitura në një masiv të vetëm (në masivin fillestar, që ata e quajtën "Thërmija Unike"), para së cilës nuk ekzistonte asgjë, as koha dhe as hapësira. Sa i përket madhësisë, kjo thërmijë ishte thuajse të paqena (ishte e madhësisë afërsisht zero), kurse sa i përket masës, ajo ishte e madhe pafundësisht, por ishte e ngjeshur brenda vëllimit të vet me një dendësi dhe temperaturë tepër të lartë. Si pasojë e kësaj ngjeshjeje dhe temperature, erdhi shpërthimi i kësaj mase, prej së cilës u krijuan thërmijat elementare, toka jonë dhe mbarë trupat qiellorë, të cilët që nga koha e shpërthimit janë gjithnjë në zgjerim (largim) nga njëri-tjetri.

Në fakt, kjo teori në thelb bie në kundërshtim me versionin kuranor; porse ajo në përmbajtje na sjell shumë të vërteta, të cilat i ka përmendur Kurani Fisnik.

Së pari: përplasjet e kësaj teorie me versionin kuranor të krijimit të universit

E para gjë, që duhet ditur është se kjo teori, krijimin e universit ia atribuon natyrës apo rastësisë, duke e neglizhuar tërësisht Krijuesin e vërtetë të gjithësisë, Allahun e Madhëruar. Pra në këtë teori spikat më së shumti ateizmi i kamufluar si shkencizëm.

E dyta: Në këtë teori përdoret fjala shpërthim, teksa në tekstin kuranor, Allahu i Madhëruar, kur ka treguar se si filloi krijimi i qiejve dhe i tokës, ka përdorur fjalën "i shkëputëm" (Enbija, 30), që aludon se krijimi i tyre është veprimi i Krijuesit të Aftë, i Cili i solli në ekzistencë qiejt dhe tokën, falë diturisë, aftësisë, përpikmërisë dhe përsosshmërisë së Tij...

Dihet fare mirë se nga shpërthimi nuk vjen rendi dhe

rregulli; për më tepër, rendi dhe rregulli i mahnitshëm që shohim të sundojë në këtë univers; por prej shpërthimit vjen prishja e rendit, prandaj Allahu i Madhëruar nuk e ka përmendur dhe as ka aluduar tek fjala shpërthim, kur ka bërë fjalë për krijimin e qiejve dhe të tokës...

E treta: teoricienët e teorisë së Big Bengut përdorin për origjinën e teorisë së tyre fjalën "Singularity- Thërmija Unike", me të cilën duan të tregojnë se universi u krijua nga diçka që ishte thuajse asgjë, ndryshe nga thënia kuranore se qiejt dhe toka erdhën duke u shkëputur nga një lëndë ku "ishin të ngjitura" (i takonin së njëjtës tërësie) (Enbija, 30), ku inspironet se origjina e materies së qiejve dhe tokës është një lëndë e konsiderueshme dhe jo asgjëja...

E katërta është se kjo teori mohon që, para se të ndodhte "shpërthimi i madh" të ketë ekzistuar koha, hapësira, lënda dhe energjia, gjë që do të thotë se ajo mohon ekzistencën e mbretërisë së madhe të Allahut të Lartësuar, përtej qiejve dhe tokës.

Teksa shpallja hyjnore islame na tregon se para krijimit të qiejve dhe të tokës me pesëdhjetëmijë vjet, ka ekzistuar krijesa e Allahut, e quajtur "Kalem-Penda"; para Kalem-it ka ekzistuar Froni Hyjnor, ku është lartësuar dhe qëndron Allahu i Madhëruar dhe ka ekzistuar gjithashtu edhe Ujësia mbi të cilin ka qenë ky Fron; Po kështu, para krijimit të qiellit dhe të tokës ka ekzistuar lënda fillestare, ku gjendeshin të ngjitur qiejt dhe toka dhe nga ku ato më pas u shkëputën dhe erdhën në këtë trajtë që janë sot...

Së dyti: disa të dhëna të kësaj teorie që përputhen me versionin kuranor të krijimit të universit

ig Bengut

anor të krijimit të universit

E para: qiejt dhe toka ishin të ngjitura dhe pastaj u ndanë nëpërmjet shkëputjes, sikurse thotë Allahu i Madhëruar:

“A nuk e shohin jobsimtarët se qiejt dhe toka ishin të ngjitura (i takonin një tërësie) dhe ne i shkëputëm” (Enbija, 30)

E dyta: qielli është në zgjerim të vazhdueshëm, sikurse thotë Allahu i Madhëruar:

“Qiellin e kemi ndërtuar me një potencial dhe Ne jemi zgjerues të tij” (Dharijat, 47)

E treta: gjendja e tymnajës kozmike që e sundoi qiellin pas shkëputjes së qiellit dhe tokës nga lënda ku ishin të ngjitur, sikurse thotë Allahu i Madhëruar:

“Pastaj iu kthye qiellit, i cili ishte tymnajë...” (Fusilet, 11)

Ende kjo gjendje tymnaje mbush thellësitë e qiellit në formën e një terri të plotë, që pengon shikimin e skajeve të universit.

E katërta: qielli është një konstrukt i përsosur, në të cilin nuk ka boshllëqe dhe as plasaritje, sikurse thotë Allahu i Madhëruar:

“A nuk vështrojnë tek qielli përsipër tyre sesi e ndërtuam dhe e stolisëm atë, duke mos pasur kurrfarë plasaritjeje!” (Kaf, 6)

Dikush mendon se hapësirat gjigande kozmike janë boshllëqe, porse shkencë moderne ka vërtetuar se qielli nuk ka asnjë boshllëk, por ajo që ne na duket terr është në fakt “Dark matter - lëndë e errët”, e cila ka rolin vendimtar në ruajtjen e gravitetit të yjeve dhe galaktikave dhe mos'hallakatjen e tyre. Lënda e errët

ka një shtrirje 20 herë më të madhe se lënda që mund të shikohet. Përbërja e “lëndës së errët” nuk dihet edhe sot e kësaj dite.

Gjithashtu, shkencëtarët bashkëkohorë kanë zbuluar kohët e fundit se në univers kemi të bëjmë me një fuqi gjigande, e cila e shtyn universin të zgjerohet në vazhdimësi, pavarësisht gravitetit (forcës tërheqëse) që ushtrojnë materia e dukshme dhe materia e errët. Ata e quajtën këtë forcë shtytëse “energja e errët”, e cila përbën 70% të universit, teksa materia që mund të shihet bashkë me materien e errët përbëjnë vetëm 30% të universit; gjë mbi të cilën Allahu i Madhëruar thotë:

“Betohem në atë që e vështroni dhe atë që nuk e vështroni.” (Haka, 38-39)

Së fundi, shkencë bashkëkohore po bën fjalë për rrëzimim e teorisë së shpërthimit të madh dhe daljen në dritë të një teorie të re, e cila pranon se para krijimit të qiejve dhe tokës, ka ekzistuar në hapësirë dhe në kohë materia nga ku qiejt dhe toka erdhën...

Gjithsesi, shkencësi i mbetet shumë për të bërë që të arrijë të zbulojë se cila është struktura e kësaj lënde, që ka ekzistuar në hapësirë dhe në kohë dhe nga e cila u krijuan qiejt dhe toka; nëse thërmijat elementare që ne njohim kanë qenë pjesë e asaj lënde në trajtën e tyre të tanishme apo ato ishin produkt i zhvillimeve që ndodhën në këtë lëndë fillestare nga ku u krijuan qiejt dhe toka; nëse uji që gjendet në tokë ka qenë pjesë e asaj lënde apo ai u krijua pas krijimit të tokës; dhe shumë e shumë pyetje të tjera të mbetura pa përgjigje...

Allahu e di më së miri...

Abdurrahman ibn Xhebri

Mustafa Erish

Abdurrahman ibn Xhebri, (r.a.), ishte prej sahabëve që i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i pat dhënë detyra të veçanta.

Ai ishte njëri prej heronjve që iu dha detyra e ekzekutimit të poetit të njohur çifut, Ka'b ibn Eshrefit, i cili ofendonte myslimanët dhe në veçanti të Dërguarin e Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam.

Si rrallë kush sahabi në fjalë dinte lexim e këndim, që para ardhjes së Islamit.

Abdurrahman ibn Xhebri (r.a.), u lind dhe u rrit në Medine. U përkiste Beni Harithëve prej fisit Evs. Para ardhjes së Islamit, mbante emrin Abdu'l-Uzza. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ia ndërroi në Abdurrahman. (Usdu'l-Gabe, III, 428.)

Në të vërtetë ai ishte prej sahabëve që përmendej më shumë me llagapin se sa me emrin e tij. Llagapi i tij është Ebu Abs.

Pasi Abdurrahman ibn Xhebri, (r.a.), pranoi Islamit, u përpoq shumë që edhe fisi i tij të bëhej mysliman. Atyre u tha se mendimet që kishin, ishin të gabuara. Ua shpjegoi se adhurimi i verbër i idhujve, nuk ka ndonjë dobi dhe u përpoq me çdo mënyrë t'u tregonte atyre paaftësinë e idhujve.

Për këtë arsye, bashkëpunoi me shokun e tij më të ngushtë Ebu Burden, (r.a.). I theu idhujt natën, i hodhi në vende të papastra dhe e tronditi besimin e popullit ndaj tyre.

Beni Harithët e panë se sa të dobët dhe të paaftë ishin idhujt që u besonin. Ata u bënë vetë dëshmitarë të faktit

se idhujt nuk ishin të aftë qoftë edhe ta mbronin veten nga çdo lloj dëmi.

Ata kuptuan se rruga që ndiqnin ishte e gabuar. Pastaj ngadalë filluan të bëheshin myslimanë një nga një. (Isabe, VII, 222.)

Ebu Abs Abdurrahman ibn Xhebri (r.a.), nuk u largua asnjëherë nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, në mënyrë që të përfitonte sa më shumë prej tij. Për një kohë, qëndroi në xhami bashkë me as'habu's-suffe.

Ai ishte prej heronjve më sypatrembur. Mori pjesë në të gjitha betejat, si Bedri, Uhudi, Hendeku etj. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, pasi pa trimërinë e guximin e tij, i dha detyrë të veçantë bashkë me Muhamed ibn Mesleme, (r.a.), dhe e futi në grupin prej katër vetash, i cili kishte si detyrë të eliminonte Ka'b ibn Eshrefin.

Ka'b ibn Eshrefi ishte poeti i çifutëve Beni Kurejdha. Ai shkruante poezi plot ofendime për të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe për myslimanët. I ndihmonte politeistët kundër myslimanëve. Qau për politeistët e vrarë në luftën e Bedrit dhe shkroi poezi për ta. Pastaj shkoi në Mekë dhe i organizoi politeistët kundër myslimanëve duke i nxitur.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, u mërzit shumë kur dëgjoji për ofendimet dhe fjalët e këqija që Ka'b ibn Eshrefi kishte shkruar për të. U mërzit aq shumë, sa që i tha Hasan ibn Thabitit:

"Çfarë i kemi bërë ne këtij çifuti? Shiko se çfarë po na bën, o Hasan!" (Vakidi, Megazi, I, 187)

Allahu Teala dha leje për vrasjen e këtij çifuti, i cili e lëndonte shumë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem. Deri atë kohë, akoma nuk ishte shpallur sureja et-Teube. (Istiab, II, 827)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, tek po qëndronte me sahabët, e shprehu përsëri shqetësimin e Tij dhe pyeti: *"Kush do të më shpëtojë mua nga gjuha e Ka'bit?"* Muhamed ibn Mesleme u ngrit menjëherë nga vendi dhe tha: *"Unë, o i Dërguari i Allahut!"*

Pasi Muhamed ibn Seleme, (r.a.), e mori këtë detyrë, mendoi dhe bëri plane për ditë të tëra, sepse çifuti Ka'b ibn Eshref jetonte brenda një kalaje të sigurt. Nuk ishte shumë e lehtë për të depërtuar deri te ai. Formoi një grup prej katër vetash. Bashkë me ta hyri në kala dhe e vranë Ka'b ibn Eshrefin. (Muslim, Xhihad, 119.)

Ebu Abs Abdurrahman ibn Xhebri, (r.a.), ishte i varfër. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i kishte urdhëruar sahabët të përgatiteshin për luftën e Hajberit. Ebu Absi filloi të mendohej thellë. Si do të dilte në xhihad? Sigurimi i të ardhurave të familjes ishte detyrë e tij. Familjen e kishte në gjendje të vështirë. Shkoi te i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i tregoi për gjendjen dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk kam ushqim, nuk kam rroba dhe asgjë prej gjëje që t’ia lë familjes, në mënyrë që të dal në luftë.”

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i dha atij një rrobë. Ebu Absi menjëherë shkoi në treg. Rrobën e shiti për tetë dirhemë. Me gjysmën e tyre bleu një rrobë tjetër. Dy dirhemë ia la familjes si para, ndërsa me pjesën tjetër bleu ushqim. Pastaj i hipi kalit dhe iu bashkua ushtrisë.

Në errësirën e natës, kishte kaluar para ushtrisë.

Të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, i kishte rënë në sy. Menjëherë kishte pyetur sahabët që kishte pranë:

“Kush është ky që ecën përpara?”

I thanë: “Është Ebu Abs ibn Xhebri.” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salatu ve’s-selam, u tha: “Shkoni dhe ndalojeni!”

Vazhdimin e ngjarjes e tregon vetë Ebu Absi, (r.a.):

“Kur më arritën nga mbrapa dhe më ndaluan, u frikësova dhe thashë me vete: Mos vallë kam bërë ndonjë gabim pa e ditur? A thua ka zbritur ndonjë ajet për mua? Menjëherë i hodha një sy jetës sime. Pas pak erdhi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe më pyeti:

“Përse ecën para dhe nuk ecën bashkë me ne?”

Unë iu përgjigja:

“O i Dërguari i Allahut! Kali im është i shpejtë. Kështu që s’po mundem ta ndaloj.”

Ai, salallahu alejhi ve selem, më pyeti përsëri:

“Ku e ke rrobën që të dhashë?”

Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! E shita për tetë dirhemë. Me katër dirhemë bleva këtë rrobë, ndërsa me dy dirhemë të tjerë bleva ushqim për rrugën. Dy dirhemët që ngelën ia lashë familjes.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, buzëqeshi dhe e shprehu kështu kënaqësinë e Tij:

“O Ebu Abs! Për Zotin, unë e di gjendjen tënde dhe të

familjes tënde. Jeni të varfër dhe keni nevojë. Por betohem pasha Allahun në dorën e të cilit është jeta ime se, nëse e ruan këtë gjendje dhe jeton duke u mjaftuar me pak, do të të shtohet ushqimi dhe do të ketë begati ajo që ke lënë te familja.”

Pastaj Pejgamberi (a.s.), vazhdoi: “Do t’ju shtohen dirhemët dhe shërbëtorët, por kjo nuk është e mirë për ju.”

Ebu Absi tha: “Çdo gjë ndodhi ashtu siç pati thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem.” (Vakidi, Magazi, II, 635-636)

Shtëpia e Ebu Absit, (r.a.), ishte shumë larg xhamisë. Megjithatë, ai i falte namazet me xhemat në Xhaminë e Profetit (a.s.). Në fund të jetës së tij, sytë iu verbuan dhe u plak shumë.

Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e pa se ai kishte shumë vështirësi për të ardhur dhe për t’u larguar nga xhamia, i dhuroi një shkop dhe i tha: “Gjeje rrugën me këtë.” (Isabe, VII, 222)

Hadithet e Ebu Absit, (r.a.), janë transmetuar në librat e Buhariut, Tirmidhiut dhe Nesaiut. Një hadith i transmetuar në “Rijadû’s-Salihin” është kështu:

Sipas transmetimit të Ebu Abs Abdurrahman ibn Xhebri, (r.a.), i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Zjarri i xhehenemit nuk e prek një rob, të cilit i janë pluhurosur këmbët në rrugë të Allahut.” (Buhari, Xhihad, 16. Veçanërisht shih. Tirmidhi, Fedailu’l-Xhihad, 7; Nesai, Xhihad, 9)

Përparimi në çdo rrugë që hyhet me dëshirën për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala, ka një shpërblim të madh tek Ai.

Kjo rrugë mund të jetë një rrugë për të mësuar dije, për të falur namaz me xhemat, për të vizituar të sëmuret apo për të varrosur xhenazen. Kjo është e vërtetuar me tekste autentike se secila prej këtyre ka sevap të madh. Por kur në arabisht thuhet “ecje në rrugë të Allahut”, pa ndonjë gjë që e shpjegon, kuptohet si shkuarje në xhihad.

Pluhurosja e këmbëve është një mënyrë shpjegimi figurative, që shpreh ecjen në një rrugë dhe lodhjen për hir të një pune. Sigurisht se udhëtimi për në xhihad për të përhapur fenë e Allahut dhe për lartësimin e fjalës së Tij, është më i rëndësishmi.

Ebu Abs Abdurrahman ibn Xhebri, radijallahu anhu, ndërroi jetë në moshën shtatëdhjetëvjeçare, në vitin 34 H. (634 G.) dhe u varros në varrezat Baki. Namazin e xhenazes së tij e fali Kalifi Umer ibn el-Hattabi, radijallahu anhu.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu na mundësoftë të gjithëve të marrim mësim dhe të përfitojmë sa më shumë nga jeta e këtij sahabi të nderuar! Amin!

KUR NJË DERË E LUMTURISË MBYLLET, NJË TJETËR HAPET

Ma. Ejup Haziri

Çdo njeri e jeton jetën, por jo të gjithë e kuptojnë dhe e përshkruajnë atë drejt. Disa e përshkruajnë atë si një kënaqësi të paharrueshme dhe lumturi të pafundme, ndërsa të tjerët si një pikëllim të madh dhe trishtim të pafund.

Megjithatë, jeta është i vetmi libër, fletët e të cilit s'mund të kthehen mbrapa. Secila fletë e librit që mbyllet, mbyll një ditë të jetës e çdo fletë e re hap një ditë të re. Çdo gjë që ka kaluar, ka shkuar. Në asnjë mënyrë e kaluara nuk mund të kthehet, megjithëse një pjesë e madhe e njerëzve i kanë mendjet e tyre tek e kaluara, edhe pse s'mund të bëjnë më asnjë ndryshim.

Është e natyrshme që njerëzit në jetë të kenë qëllime e synime, mirëpo shpeshherë ajo që pritet nuk vjen e ajo që s'pritet edhe ndodh. Ajo që ëndërrohet, shpesh edhe nuk realizohet e ajo që nuk imagjinohet, mund të bëhet fare lehtë realitet.

Kjo nuk nënkupton që të hiqet dorë nga synimet, përkundrazi, u duhet bërë ballë sfidave dhe vështirësive dhe nuk duhet dorëzuar para tyre. Sigurisht se jeta sjell edhe problemet dhe vështirësitë e veta, të cilat janë të përbalueshme, sado të dhimbshme të jenë. Çdo vuajtje dhe dëshpërim, sado e gjatë qoftë, një ditë merr fund. Çdo gjë që ka ardhur, shkon dhe çdo dëshpërim me kalimin e kohës, shuhet. Nuk ka vuajtje që nuk mbaron, nuk ka trishtim që nuk largohet, nuk ka brengë që nuk shuhet dhe nuk ka pikëllim që nuk evitohet. Këto janë sfidat e jetës, pa të cilat nuk do ta kuptonim drejt lumturinë, kënaqësinë, gëzimin dhe harenë.

Jo çdo herë lotët shprehin dhimbje dhe buzëqeshja jo

gjithnjë shpreh lumturi, ndonjëherë lotët shprehin lumturi dhe buzëqeshja dhimbje. Sigurisht se pas lumturisë së disave fshihet një botë e trazuar dhe pas pikëllimit të ndokujt fshihet një lumturi e madhe.

Secila ditë sjell një sfidë të re, hap një shteg, krijon një mundësi të re, mbulon një boshllëk dhe njerëzit hyjnë në një labirint të ri, që shpeshherë është edhe i ndërlikuar. Jeta, jo rrallëherë na vë në një shesh përleshjeje, ku shpeshherë daljet duken të mbyllura. Terry Rich Hartley në librin e tij *"Tyrants of self-concept: ruling the rulers"*, ka thënë: *"Pëlqeje apo jo, ne të gjithë jemi gladiatorë. Shkojmë për të fjetur dhe zgjohemi në një arenë shoqërore prej së cilës nuk ka ikje. Kërkesat dhe sfidat na konfrontojnë ne, muret na kufizojnë dhe masa e spektatorëve na përqesh, thumbon apo na brohoret. Secila ditë sjell betejë të re, pa marrë parasysh në e duam apo jo."*

Arenat e jetës nuk janë të lehta, por të përbalueshme. Janë të vështira, por jo të pakalueshme. Janë me plot sfida, por me rrugëdalje. Jeta nuk përbëhet vetëm nga dita, por atë e shoqëron edhe nata, andaj, përveç gëzimit, jeta ka edhe dëshpërimin, përveç pushimit ka edhe lodhjen e përveç vështirësisë ka edhe lehtësimin.

Sa shumë njerëz kanë shtëpi, por janë të papunë e sa të tjerë punojnë për t'u strehuar! Sa të martuar janë ndarë nga bashkëshortet e sa beqarë dëshirojnë të martohen! Sa shumë njerëz vuajnë që të bashkohen e sa të tjerë pendohen pse janë bashkuar! Sa shumë janë mërzhitur nga puna e sa të tjerë dëshirojnë të punëso-

hen! Sa shumë e hedhin ushqimin në kosh e sa të tjerë vuajnë për kafshatën e gojës! Disa kanë të gjitha ushqimet, por janë anoreksikë, e disa të tjerë kanë oreks, por u mungon ushqimi. Disa janë të frikësuar edhe në shtëpi e disa të tjerë në beteja nuk njohin frikën. Disa në pallate nuk i zë gjumi nga problemet e disa në tenda të thjeshta e bëjnë gjumin rahat.

Abbas el-Akkad, kishte plotësisht të drejtë, kur tha:

*I vogli ka qejf të bëhet i madh
e plaku dëshiron të bëhet i vogël.
I papuni kërkon punë
e ai që punon ankohet prej punës.
Disa të pasur janë në lodhje
e disa nga lodhja janë varfëruar.
Njeriu ngushtohet nga disfata
e nuk pushon së triumfuari.
A janë hutuar nga caktimet
apo janë ata në sikletin e fatit?*

Sprovat e jetës janë të shumta dhe nga më të ndryshmet. Nganjëherë ato janë të njëpasnjëshme dhe, ende pa dalë mirë nga njëra, futesh në tjetrën. Sprovat, sado të dhimbshme që janë, të kalisin dhe të forcojnë në misionin e jetës tënde.

Ata që e lexojnë biografinë e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.), do të vërejnë se jeta e tij është e mbushur me sprova të shumta dhe të larmishme, madje që nga koha e lindjes së tij. Lindi pa e parë kurrë të atin. Fazën e foshnjërisë e kaloi larg familjes. Ende pa e plotësuar dekadën e parë, humbi nënën dhe gjyshin e tij. Do të rritej në një mjedis pa baba, pa nënë, pa vëlla e pa motër. Sa më shumë që rritej, aq më tepër do ta mbulonin sprovat e jetës. Megjithë fisnikërinë, bujarinë dhe mirësitë e tij, ai do të keqtrajtohej, sulmohej dhe do të ndiqej nga ata që dikur e quanin besnik. Do t'i bëheshin kurthe për eliminim fizik dhe do t'i shpallnin luftëra të shumta e të ndryshme, mirëpo ai do t'i tejkalohej të gjitha ato sprova dhe do t'u bënte ballë gjithë atyre sfidave, që në fund të ngadhënjente dhe t'i falte armiqtë e tij. Misioni i tij na tregon se çdo vuajtje kalon, çdo pikëllim mbaron dhe pas çdo vështirësie, do të ketë lehtësim.

Sanin Musa në librin e tij "Zbukuroje jetën tënde", e ka përshkruar shumë bukur jetën me sprova. Ai thotë: "E tërë jeta është e krijuar prej sprovave, të cilat i pasojnë lehtësimet ose prej rehatisë, të cilën e pasojnë vështirësitë. Për këtë shkak, duro gjatë sprovës, sepse pas saj patjetër vjen lehtësimi, ndërsa në rehati përgatitu për sprovën, e cila me siguri të pret. Nëse e kupton dhe e merr vesh këtë, jeta jote do të jetë më e lumtur dhe më e mirë."

Sprovat, mërzitë dhe pikëllimet tejkalohej me durim dhe këmbëngulje. Prej tyre nxirren leksione nga më

të ndryshmet, që të kalisin për jetën. Por, ato siç vijnë edhe shkojnë, ashtu siç fillojnë edhe mbarojnë. Duhet ditur se asnjë sprovë nuk është e përhershme dhe asnjë pikëllim nuk zgjat përgjithmonë. Ajo që të ka goditur, nuk ka mundur të të anashkalojë, kurse ajo që nuk të ka goditur nuk ka mundur të të ndodhë. Fati nuk të pyet ty për ta shkruar rrugën e vet, ai do të rrjedhë si është shkruar, kurse ti do ta vazhdosh rrugën e jetës prej aty ku ka mbetur.

Kohët e vështira dhe telashet e shumta janë pjesë e pandashme e jetës. Edhe po të jesh në sarajet madhështore, i shoqëruar me roje të shumta, brengat, vuajtjet, pikëllimet dhe telashet do të jenë afër teje. Ato nuk mund t'i largosh me forcën dhe pushtetin tënd. Ato janë shoqëruesit e tu gjatë jetës, të cilat shfaqen herë pas here pa të pyetur ty dhe pa marrë leje nga ti. Nga ti kërkohet vendosmëri që t'i përballosh të gjithë ato, ndaj ngajji lisit që nuk i përkulet fare stuhisë së vrullshme e as që frikësohet nga furtuna e madhe, apo kodrës së palëkundur, e cila nuk e njuh fare erën e tërbuar.

Pikëllimi e vuajtja lëshojnë dhembje të thellë në zemër, lëndojnë rëndë shpirtin e brengosur dhe fytyrën e bëjnë të zymtë. Ato i ngajnë zjarrit që djeg përreth vetes çdo gjë, e në fund djeg edhe veten. Shpirtrat e ngrysur që nuk shohin ditë të mira, i shndërrojnë ditët në tragjedi duke i zmadhuar problemet dhe vështirësitë. Njerëz të tillë jetojnë të pashpresë, ngase shpresën e kanë venitur, mundësitë s'i realizuan dhe para vetes nuk vendosën synime dhe vizione. Ata jetojnë me pikëllimin e kaluar, me brengën e së djeshmes dhe me vuajtjen e dikurshme.

Njerëzit e mëdhenj i zvogëlojnë pikëllimet dhe dëshpërimet e kaluara, sado të mëdha qofshin ato. Shpresën asnjëherë nuk e largojnë nga mendja dhe zemra e tyre. Vetes u kanë caktuar vizione e synime, që mendojnë se do t'i realizojnë dhe për këtë përpiqen, hap pas hapi. Këta njerëz jetojnë me perceptimin se dëshpërimi dhe pikëllimi një ditë do të shuhet dhe ata do të jetojnë të lumtur, ashtu si shumë para tyre jetuan një pjesë të jetës të dëshpëruar dhe të përvuajtur, por më pas u buzëqeshi lumturia dhe gëzimi.

Sa bukur është shprehur Helen Keller: "Kur një derë e lumturisë mbyllet, një tjetër hapet, por shpesh ne shikojmë aq gjatë në derën e mbyllur, sa që nuk e shohim se ajo ka qenë e hapur për ne."

Sido që të jesh dhe çfarëdo problemi të kesh, duhet të kesh një besim të palëkundur, një bindje të thellë dhe një perceptim real se koha e përfundimit të problemit veç po afrohet dhe brenda jush është një agim që pret të zbardhë një ditë!

"...Vallë, a nuk është afër agimi i ditës?" (Hud, 81)

E DO TË MBETET VETËM FYTYRA (QENIA) E ZOTIT TËND, PLOT MADHËRI DHE NDERIM

(Rahman, 27)

Albri Brahusha

Shenjat e Zotit në univers dhe në tokë janë të pafundme. Çdo gjë është gjurmë e krijimit të Tij dhe mbart në vetvete formën që Ai i dha, sekretin (caktimin) dhe udhëzimin. Ai është Pronari dhe Krijuesi, i Cili lë gjithkund vulat e punës së Tij në pronën e Tij. Njeriut i është dhënë intelekti që prej pasojës gjithnjë të arsyetojë shkakun. Kështu kur në mëngjes shohim tokën e lagur kuptojmë se kjo është shenjë e rënies së shiut gjatë natës.

Krijimi dhe vendosja e njeriut mëkëmbës në tokën e Zotit, erdhi prej faktit se njeriu ishte i vetmi, i cili mori përsipër përkujtimin, pra mëkëmbësia iu dha atij si pasojë se mori përsipër detyrimin e njohjes dhe adhurimit të Pronarit, Krijuesit të gjithçkaje, Allahut. Por harresa e kaplon njeriun që u krjua prej baltës, interesi e bën atë lakmitar, kurse egoja arrogant. Njeriu nis e pretendon pronësinë mbi diçka që në fakt thjesht e ka në përdorim dhe për më tepër me kushtin e përkujtimit.

Nga ky pretendim i mbrapshtë, nis edhe aventura morale e njeriut dhe degradimi i tij, nga ku kjo botë për të bëhet burim vuajtjesh e mjerimesh, skamjeje dhe luftërash, një fushëbetejë pretendentësh për të mbledhur pasurinë, prej këtu nisin gënjeshtria pa fund, iluzione, teori, komplete e intriga, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër veçse tentojnë të mbulojnë një të vërtetë të thjeshtë: Natyshmërinë e pastër njerëzore, thjeshtësinë e njeriut si krijesë dhe Madhëstësinë e Krijuesit.


Një herë një i njohuri im më bëri një pyetje krejt naive por shumë thelbësore: A ka në Kuran ndonjë pjesë ku flitet për keqkuptimin? Pyetja më bëri të qesh me të madhe, sa pyetësi mendoi se po qeshja se mos pyetja e tij ishte e pavend. Në fakt po qeshja, se nëse Kurani flet më shumë për ndonjë çështje, kjo është pikërisht keqkuptimi njerëzor. Ky libër na rikujton përkujtimin dhe shpall të Vërtetën. Injoranca është në thelb thjesht një keqkuptim, i cili me kalimin e kohës është kthyer në zakon e më pas është bërë ligj, derisa në fund keqkuptimi kthehet figurativisht, por edhe realisht në një kuçedër që kërkon të zaptojë dhe të denatyrojë gjithçka i del përpara.

Kurani iu shpall Profetit Muhamed (a.s.), pikërisht si udhëzues për bashkësinë e tij dhe kur Zoti vendos diçka e kryen atë punë edhe me një njeri të vetëm, e pastaj mbledh rreth tij të gjithë ata me të cilët është i kënaqur, derisa instalon Islamin dhe ashtu siç ka premtuar e përsos dhuratën e Tij ndaj njerëzimit, me zbritjen e plotë të Kuranit dhe sqarimin e tij brez pas brezi. Kështu, kuçedra e keqkuptimit nis e dridhet, dobësohet, edhe pse organizohet sërish, pjell kuçedra të tjera e nganjëherë duket se e ka mundur të Vërtetën, por jo. Sepse interesat dhe egot, prej keqkuptimit sa më shumë rriten, aq me të paafta janë të qëndrojnë në këmbët e veta, pikërisht se janë artificiale e pa udhëzim.

“E do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.” (Rahman, 27)

E pavërteta është e destinuar të zhduket, sepse gjithçka që nuk është e lidhur me burimin është e vdekur. Pyetja që shtrohet është: Pse atëherë bota është e mbushur me kaq shumë keqkuptime? Kjo ndodh sepse këto i mban gjallë njeriu, ai u jep atyre energji nga vetja e tij, janë perdet që e pengojnë të shohin të vërtetën,





por Allahu është Rrahman, Ai e mëshiron krijesën e Tij, megjithëse njeriu nuk i bindet, Ai e furnizon, megjithëse njeriu e tepron, Ai e fal, megjithëse njeriu i shkon pas të pavërtetës, Ai e toleron.

Por njeriu ka nevojë për burimin e fuqisë, Zotin e tij. Kështu e projektoi Allahu dhe realizoi krijimin e Tij me një ligj të fortë: domosdoshmëria për burimin e mban lidhur krijesën me Krijuesin. Vargu i mësipërm i sures Rrahman, nuk bën fjalë vetëm për Ditën e Fundit, kur vetëm Allahu do të mbetet i Vetmi, dhe do të bëjë pyetjen: I kujt është pushteti tani? E Vetë do të përgjigjet: I Allahut.

Ndërsa ky varg na flet përditë, se ky pushtet gjithnjë është i Tij, se bashkë me Zotin do të mbetet edhe gjithçka që është lidhur fort pas Tij, pra gjithçka që e përkujton dhe është e lidhur me të, do të vazhdojë, e gjithçka tjetër do të zhduket. Pra do të zhduket e pavërteta dhe do të mbetet vetëm e Vërteta, e Zotit Tonë, plot Madhëri e Nderim.

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Peshoren.”
(Rrahman, 7)

Ligji i ekuilibrit është në funksion të harmonisë së krijimit, sapo ky ekuilibër prishet te njeriu, vetë toka nis të flasë, universi buçet duke i bërë përkujtim Allahut edhe më shumë, pikërisht atëherë kur njeriu e ka harruar Atë.

Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme.
(Rrahman, 29)

Atëherë njeriu tmerrohet, iluzionet rrëzohen përdhe nga forca e së vërtetës, dhe njeriu kthehet nga Zoti i Tij, për të mbijetuar, tashmë e kupton se nuk ka rrugë tjetër. atij i duhet t'i nënshtrohet Zotit, jo thjesht fizikisht, por t'i nënshtrohet urdhrave të Tij, t'i largohet të ndaluarave dhe t'i afrohet me modesti të lejuarave.

Librat, ku Allahu përmendet vazhdojnë të jenë të freskët si ditën kur u shkruan, ndërsa librat meskinë që e çojnë njeriun drejt shturjes dhe egos tashmë kanë krejt pak vend në vëmendjen e njeriut. Dhe nga një i keqkuptuar, njeriu kërkon mëshirën e dijes së vërtetë, mbi veten dhe krijimin, mbi kufijtë e tij. Ngadalë gjithçka e kotë nis e zhduket dhe bukuritë e Zotit dalin në pah, shihen qartë gjurmët, profetët, miqtë e çështjes së Tij.

Kurani është Libri që zëvendësoi shpatën, ky është libri që hap dhe trondit zemrat me lejen e Zotit, ky është paralajmëruesi i qartë, që nisi të zbresë në muajin e bekuar të Ramazanit, në shpellën Hira prej engjëllit Xhebrail (a.s.), dhe hyri e zuri vend në zemrën e Profetit më të dashur të njerëzimit, Muhamedit (a.s.). Me një Libër, ky njeri model, çlirroi botën nga injoranca, iu dha Kurani, libri që ka një vend të nderuar te Allahu i Madhërishëm, iu dha dija prej Zotëruesit të Dijes.

Pas kësaj vërshoi dija, vërshuan shkencat, vërshoi furnizimi dhe mirësitë e Zotit. Breza të tërë dijetarësh në të gjitha fushat zbuluan falë Mëshirës Hyjnore, matematikën, fizikën, kiminë, psikologjinë, metafizikën, ligjet, mjekësinë, financat, tregtinë, arkitekturën, etikën, njerzillëkun e humbur dhe rigjallëruan gjithë botën me sjelljen e tyre modeste e me shërbimet e tyre ndaj njerëzimit, duke mos kërkuar asnjë patentë për këtë, duke jetuar thjesht e duke hapur dijen.

A mundet kush që dijet e Zotit t'i shesë si të vetat e t'i mbajë ato peng, për t'u pasuruar padrejtësisht me to? Mundet për një farë kohe, por pasojat për këtë do të jenë katastrofale, dhe dënimi i Zotit është i ashpër, asgjësim i plotë, sepse kjo lloj mënyre asgjëson veten në ligjin e Peshores së Zotit. Dhe tashmë, megjithëse në fundin e vet, kuçedra e keqkuptimit mundohet të sajojë komplete, intriga e kurthe, por kurthet e Zotit janë më të mëdha, janë të sakta dhe të pagabueshme, e pashmangshmërisht do të shpëtojë gjithçka që lidhet me Të, në këtë botë e në tjetrën dhe gjithçka që i kthen shpinën do të zhduket, **E do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.**
(Rrahman, 27)

Personaliteti që ndërton Islami

All Riza Temel

Tërësia e organizuar e vetive të mira të njeriut përbën atë që quhet personalitet. Individu që privohet nga këto veti të mira, nuk mund të ndërtojë një personalitet dhe karakter të shëndoshë. Njerëz të tillë nuk mund të jenë të qëndrueshëm, ata shkërmoqen menjëherë përballë një rreziku të vogël apo interesi të parëndësishëm. Njerëz të tillë kanë çmim, por nuk kanë vlerë. Këta janë njerëz që jetojnë momentin. Një shoqëri e shëndoshë dhe e fortë nuk mund të ndërtohet me njerëz me personalitet të dobët apo fare pa personalitet, sepse këta janë material i prishur dhe i kalbur për të ndërtuar një ngrehinë të fortë.

Besimi luan një rol të madh në ndërtimin e një personaliteti të fortë dhe shembullor, sepse imani është burimi më i madh i fuqisë. **“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”** (Al’Imran, 139)


Shoqëria e shëndoshë dhe qytetërimi i fuqishëm islam janë ndërtuar nga individë besimtarë me karakter dhe personalitet të fortë. Për myslimanin me personalitet të bazuar në besim, kauza dhe parimet janë gjithmonë në plan të parë, sepse jeta merr kuptim kur ka parime dhe kauzë. Nëse njeriu nuk zotëron

gjëra më të vlefshme se jeta, atëherë ajo është e pavlerë. Sepse jeta sidoqoftë, një ditë do të pushojë së qeni. I gjithë sekreti është kapja mbas një jete që nuk mbaron me vdekjen dhe përvetësimi i vlerave të qëndrueshme për ndërtimin e asaj jete. Një jetë e tillë është e mundur vetëm përmes besimit dhe Islamit. Midis shumë shembujve të sahabëve, të cilët përmes një besimi të fortë ndërtuan një personalitet të shëndoshë, dëshiroj të ndaj me lexuesin qëndrimin shembullor të një gruaje fisnike. Heroina jonë është Ummu Sulejme (r.a.). Kur Ummu Sulejme pranoi Islamin së bashku me fisin e saj, bashkëshorti i mërzhitur u largua për në Sham, ku edhe vdiq si jobesimtar. Enes ibn Maliku është i biri i kësaj gruaje fisnike. Ummu Sulejme e solli të birin te Pejgamberi (a.s.) dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Ky është djali im, të cilin e kam sjellë për të të shërbyer ty, prandaj lutu për të”. Pejgamberi (a.s.), u lut: “O Zot! Shtoja pasurinë dhe pasardhësit këtij djali!” Lutja filloi të bënte ndikimin e vet. Ummu Sulejmes, e cila ishte e ve, i erdhi një propozim për martesë nga Ebu Talha (r.a.), i cili nuk ishte nderuar ende me besimin Islam. Përballë këtij propozimi, Ummu Sulejme mbajti një qëndrim që i kishte hije personalitetit të saj prej myslimaneje. “O Ebu Talha! A nuk e di ti që druri i idhullit, të cilën ti adhuron rritet nga toka? A nuk të vjen turp që adhuron diçka të tillë? Në fakt unë dëshiroj të martohem me ty, sepse një njeri si ti nuk mund të refuzohet, por ti je pagan, kurse unë jam myslimane. Për mua nuk



është e lejueshme të martohem me një pagan. Por nëse ti përqafoh Islam, unë këtë do ta konsideroj si prikë nga ana jote."

Pasi u mendua, Ebu Talha erdhi dhe pranoi Islam. Atëherë Ummu Selejme thirri Enesin për të lidhur martesën e saj me Ebu Talhanë. Deri atëherë nuk ishte dëgjuar prikë më e mirë se prika e Ummu Sulejmes. Prika e saj ishte Islami i bashkëshortit. Këtu dëshirojmë të theksojmë nxjerrjen në pah të Islamit dhe jo të pasurisë dhe bukurisë, siç bëhet rëndom në zgjedhjen e bashkëshortit. Refuzimi i një personi të pasur dhe të bukur vetëm për shkak të besimit, shpreh rëndësinë e madhe që kanë tek ai person parimet e besimit. Kjo grua fisnike, që preferoi besimin para çdo gjëje tjetër, fitoi respekt të veçantë të Pejgamberi (a.s.). Pejgamberi (a.s.), në lidhje me të thotë: "Në ëndërr pashë sikur hyra në Xhenet dhe aty dëgjova zhurmën e një hapi. Kur pyeta për këtë zhurmë hapash, më thanë: Kjo është zhurma e hapave të Ummu Sulejmes." (Myslim, Nr, 6278) Pejgamberi sillej gjithë mëshirshëm me Ummu Sulejmen, sepse vëllai i saj kishte rënë dëshmor në tragjedinë e Birru Maunes. Ummu Sulejme, i biri, vëllai, motra dhe bashkëshorti i saj shfaqën modelin më të bukur të familjes myslimane. Fjalët nuk mjaftojnë për të përshkruar heroizmin e treguar në luftë



dhe shërbimet që i ka bërë fesë kjo grua e nderuar. Dëshirojmë të japim një tjetër tablo sensacionale të dorëzimit dhe nënshtrimit të plotë të saj ndaj Krijuesit të gjithësisë.

Nga martesja e Ummu Sulejmes me Ebu Talhanë lindi një djalë. Ky djalë ndërroi jetë kur Ebu Talha nuk ndodhej në shtëpi. Përballë kësaj fatkeqësie, Ummu Sulejma u tha të pranishmëve: "Mos i tregoni Ebu Talhas për vdekjen e djalit, derisa ta lajmëroj unë." Kur Ebu Talha erdhi në shtëpi, Ummu Sulejme i përgatiti darkën. Pasi hëngri darkë bashkëshorti, Ummu Sulejme iu shfaq atij e zbukuruar si asnjëherë tjetër më parë. Dhe pasi kryen marrëdhënie, Ummu Sulejme i tha bashkëshortit:

"O Ebu Talha, a ke parë ndonjëherë që dikush t'i lërë dikujt një amanet dhe, pasi kërkon kthimin e amanetit, t'i refuzohet?" Ai tha "jo." "Atëherë, Allahu e mori djalin që ta pati lënë amanet. Prandaj bëj durim dhe prit shpërblimin prej Tij." Ebu Talha, i mërzitur, i

tha: "Përse e bërë gjithë këtë pa më treguar për vdekjen e djalit?" Në mëngjes Ebu Talha shkoi te Pejgamberi (a.s.) dhe i tregoi për ngjarjen. Pejgamberi (a.s.), u lut për ta: "Allahu jua bëftë të begatë atë natë!". Ummu Sulejme mbeti shtatzënë dhe nga kjo shtatzani lindi një djalë. Enesi (r.a.), e mori foshnjën dhe e dërgoi te Pejgamberi (a.s.). Profeti (a.s.), mori një hurmë e përtypi dhe e leu foshnjën me të. (Myslim, 6280)

Me këtë shembull deshëm të

tregojmë forcën, durimin dhe qëndresën që buron nga besimi. Shpalosja e një tabloje të tillë është e mundur vetëm përmes forcës së besimit. Vlerësimi i vdekjes si një amanet që duhet kthyer dhe mënyra e ngushëllimit që i shprehu burrit, janë tregues të një gruaje myslimane ideale. Është një shembull ideal i forcës dhe durimit, të treguar nga një grua model përballë një gjendjeje, ku edhe burrat më të fortë nuk do të mund të përmbaheshin. Sipas disa transmetimeve, Ebu Talha e pyeti bashkëshorten për gjendjen e djalit. Ummu Sulejme nuk i tha që kishte vdekur, por se ishte më qetë se asnjëherë tjetër. Me këtë donte të theksonte se duke dhenë shpirt, kishte shpëtuar nga dhimbjet e trupit. Dhe në këtë mënyrë, nuk kishte gënjyer as bashkëshortin. Të njëjtin qëndrim e shikojmë edhe tek vëllai, i cili kur shtiza e depërtoi tej përtej tha: "Betohem në Zotin e Qabes se tani shpëtova." Kjo shpreh kulmin e besimit dhe Islamit. Njerëzit në përgjithësi në raste të tilla, në vend të fjalës "shpëtova" thonë "mbarova." Pra, shpëtimi i vërtetë është vetëm besimi, besimi në jetën e amëshuar. Pejgamberi (a.s.), edukoi një shoqëri model dhe shembull për gjithë njerëzimin. Personalitetet monumentale, si Ebu Bekri, Omeri, Uthmani, Aliu, Bilali, Ammari, Selmani, Enesi, Fatimja, Ummu Sulejma, Ummu Harami, janë udhërrëfyese dhe burim drite në kauzën tonë të përbashkët për triumfin e Islamit. Ata janë kriter vlerësimi i nivelit të besimit, durimit dhe sakrificës sonë. Shndërrimi i kësaj bote të zhvilluar materialisht, por të rrënuar shpirtërisht në një botë të besimit dhe ekuilibrit të vlerave shpirtërore dhe materiale, është i mundur vetëm duke marrë si shembull këta personalitete monumentale. Një kauzë e pretenduar islame nuk mund të jetë me formë qiellore dhe përmbajtje tokësore.

Një kauzë me formë qiellore dhe përmbajtje tokësore nuk mundet të jetë asnjëherë një kauzë islame, ajo thjesht është një kauzë fallso. Dhe armiku më i madh i së vërtetës është falsiteti, sepse sjell problemin e mosdallimit të së vërtetës nga gënjeshtria. Ky është edhe problemi më i madh i myslimanëve bashkëkohorë. Zbrazja nga vlerat shpirtërore dhe përdorja e tyre për interesa mesquine dhe të ças-

tit, është krimi dhe tradhtia më e madhe që mund t'i bëhet kësaj kauze. Pasi të zgjidhin problemet e brendshme, myslimanët duhet të regjistrohen edhe një herë në shkollën e Kuranit, duhet të riorganizohen dhe rinovojnë marrëveshjen e adhurimit. Vetëm në këtë mënyrë myslimanët mund të bëhen shembull dhe model për gjithë njerëzimin. Mysliman është personi, që për kauzën dhe parimet islame sakrifikon, heq dorë nga interesat vetjake, sepse për të fitimi më i madh është dashuria e Allahut dhe lumturia e amëshuar. Sa bukur e ka shprehur Rumi: *"Allahu na bleu duke na shpëtuar përgjithmonë nga pazarllëku, sepse e njëjta gjë nuk shitet dy herë."*

Njeriu është krijesa më e nderuar e Allahut dhe për këtë arsye ai nuk mund të vlerësohet me një çmim material, sepse ai është më i shtrenjtë se çdo gjë në këtë botë. Akush nuk mund të guxojë të blejë një

njeri kaq të shtrenjtë. Si mundet një njeri kaq i shtrenjtë të shejë veten në këmbim të diçkaje të pavlerë? Njerëzit që i kanë mposhtur dëshirat dhe pastruar egon janë gjithmonë në përpjekje për arritjen e përsosmërisë shpirtërore. Siç shprehet poeti, moto e tyre ka qenë: "Petkun modest dhe teshat e vjetra nuk pranoj t'i ndërroj më flamurin e mbretërve dhe sulltanëve. Nuk pranoj të braktis varfërinë në këmbim të fronit të Sulejmanit (a.s.), thesarin që kam gjetur në xhihad nuk e ndërroj me luksin dhe komoditetin e mbretërve." Në periudhën kur India ishte koloni e Anglisë, një përfaqësues i pushtetit viziton Shejhun e nderuar Murad Abadi dhe i ofron atij një pagë mujore. Propozimin e anglezit Shejhu e refuzoi, duke i thënë: "Ç'më duhet pasuria juaj? Falënderoj Allahun që kam një shtrat pa dyshek, një ibrik dhe një shtambë. Disa miq sjellin misër dhe me të bëjmë bukë. Dhe kjo na del e na tepron." Është besimi i shëndoshë dhe mbështetja e fortë tek Allahu ajo që e bën njeriun të pamposhtur përballë materiale. Kurse ajo që e skllavëron njeriun, është dashuria e tepruar ndaj saj. Njerëzit që përballë dashurisë së kasaj bote mbajnë lart dashurinë për botën tjetër, janë të lartësuar. Nëse nuk do të ekzistonin njerëz të tillë, umeti do të ishte gllabëruar me kohë nga dallgët e materializmit.





Hap pas hapi

Nuredin Jëlldëz

Hap pas hapi vjen fundi i një udhëtimit të gjatë. Gur-gur bëhet kala dhe pikë-pikë bëhet liqen.

Zhvillimi i njeriut deri sa rritet plotësisht ndodh me hapa aq të ngadalshëm, saqë nuk vihet re. Ligjet e kësaj bote nuk lejojnë që njeriu të lindë i madh. Pamundësia për t'u bërë i madh pa qenë i vogël, është prej ligjeve të vendosura nga Krijuesi i gjithësisë. I njëjti ligj vlen si për njeriun, ashtu edhe për pemën...

Prandaj, kush dëshiron të nisë një udhëtim dhe ta përfundojë me sukses atë, duhet të ndjekë këtë ligj. Përfundimi i udhëtimit bëhet i pamundur, nëse nuk krijohet një ekulibër midis hapave dhe rrugës. Një pemë e rritur brenda natës ndjell frikë në zemrat e njerëzve, uji që nuk rrjedh ngadalë shkakton përmytje. Nëse një fëmijë brenda një nate do të rritej sa për dhjetë vjet, prindërit menjëherë do ta dërgonin në spital. Rritja dhe zhvillimi është i bukur, kur ndodh natyrshëm dhe hap pas hapi.

Ky ligj është i vlefshëm edhe për jetën fetare dhe shpirtërore të besimtarit. Përsosmëria shpirtërore nuk duhet pritur të ndodhë brenda një nate. Edhe besimi edhe blasfemia zhvillohen hap pas hapi. Çdo frymëmarrje të afron ose drejt besimit, ose drejt blasfemisë. Rritja që shikojmë, që dëgjojmë apo që flasim është arritur vetëm pas një akumulimi të ngadaltë të pjesëve përbërëse. Besimi rritet dhe zhvillohet si gjuha e fëmijës së vogël, që mëson çdo ditë nga një fjalë të re, deri sa arrin të flasë rrjedhshëm. I njëjti proces ndodh edhe me ndërtimin e identitetit.

Çdo hap që hidhet, është po aq i rëndësishëm sa vetë rruga. Çdo vepër e mirë apo e keqe, sado e vogël qoftë, ka rëndësinë e vet. Përderisa një fjalë mund ta shpjerë njeriun në xhenet ose në xhehenem, atëherë në fjalorin e besimtarit nuk duhet të ekzistojë fjala "e parëndësishme." Në veprimet matematike çdo numër është i rëndësishëm për nxjerrjen e përfundimit.

Prandaj, asnjë fjalë që nxjerrim nga goja apo dëgjojmë

me veshë nuk duhet ta konsiderojmë si të parëndësishme. Ashtu si formohen fjalët nga shkronjat dhe fjalitë nga fjalët edhe tërësia e sjelljeve, punëve dhe arritjeve tona ka ardhur si rezultat i shumë veprimeve të vogla, ndoshta në dukje të parëndësishme, por që në të vërtetë janë shumë të rëndësishme për funksionimin si duhet të së tërës.

Kjo duhet pasur parasysh nga të gjithë prindërit dhe mësuesit në edukimin e fëmijëve. Pritshmëritë e prindërve ndaj fëmijëve duhet të jenë realiste. Njeriu e arrin pjekurinë fizike dhe shpirtërore ngadalë. Nuk mund të presim mrekulli për një kohë të shkurtër. Çdo gjë duhet të kalojë përmes një procesi të caktuar, për të arritur pjekurinë e duhur.

Ai që di të durojë, di edhe të ecë. Të durosh, në asnjë mënyrë nuk do të thotë të presësh, por të njohësh mirë situatën dhe ligjet në fuqi dhe të përdorësh mundësitë tuaja brenda ligjeve.

Gjendja jonë do të rregullohet kur vendin e pritjes ta zërë puna, vendin e zhurmës, sinqeriteti dhe sasisë, cilësia. Atëherë do të kuptojmë arsyen e ekzistencës sonë dhe detyrat që priten prej nesh.

Ne nuk duhet të përfshihemi nga emocionet e çastit. Vendimet dhe veprimet e nxituara gjithmonë kanë sjellje pasoja të dëmshme. Detyra jonë është pjekuria në çdo veprim dhe sjellje, sepse ligjet e Allahut janë të atilla që përmirësimi i gjendjes nuk mund të arrihet në një ditë apo në një natë. Ashtu si rritja biologjike e njeriut është e shpërndarë në vite edhe suksesi individual dhe shoqëror kërkon një kohë të caktuar.

Çdo gjë fillon me një hap. Bimët, kafshët dhe njerëzit jetojnë sipas ligjeve të vendosura nga Krijuesi. U deshën 23 vjet që në hutben e lamtumirës të mblidheshin 10 mijë veta.

Kjo është bota, në tokë ecet, në ujë notohet dhe në ajër fluturohet.



Një Ajet

*"Kur ju përshëndet dikush me respekt,
kthejani me një përshëndetje më të mirë
ose në të njëjtën mënyrë!
Pa dyshim, që Allahu llogarit çdo gjë."*

(Nisa, 86)

Kur takohen, njerëzit përshëndeten duke i shprehur njëri-tjetrit ndjenja miqësie, nderimi dhe mirësjelljeje. Përshëndetja ekziston në të gjitha fetë dhe kulturat e botës, por në kulturën islame ajo nuk është thjesht një shprehje e bërë traditë; ajo në një farë mënyre është një lloj lutjeje dhe ibadeti, që duhet kryer me vetëdije të plotë dhe jo thjesht për zakon. Në kulturën islame përshëndetja simbolizon një kuptim që i jepet jetës. Nëse selami nuk sjell paqe dhe dashamirësi, ai shndërrohet në një përshëndetje të ftohtë, larg qëllimit të caktuar.

Në të vërtetë, "Selami" është një botëkuptim dhe një filozofi jete. Një nga emrat e bukur të Allahut është "Selam". Prandaj, në fund të çdo namazi lutemi: "O Zot! Ti je paqja dhe prej Teje buron paqja". Sepse Allahu është burimi i çdo lloj paqeje. Në këtë mënyrë, Ai u jep robërve të Tij qetësi dhe siguri. Kurani i fton besimtarët të jenë paqedashës dhe mirëdashës, sepse siç thotë Profeti (a.s.): "Myslman i vërtetë është ai, prej dorës dhe gojës së të cilit njerëzit e ndjejnë veten të sigurt." (Muslim, Iman, 65). Kështu, bashkësia e besimtarëve bëhet garant i paqes dhe qetësisë në botë, siç e thekson ajeti: "**O Besimtarë! Hyni të gjithë në paqe dhe siguri. (në Islam).**" (Bekare, 208)

Kthimi i një selami më të mirë personit që përshëndet, nuk nënkupton thjesht zgjatjen në fjalë, por hapjen e zemrës dhe nxitimin drejt personit që përshëndet i pari.

Selami për besimtarët shpreh një parullë për këtë botë dhe botën tjetër, ai shërben si një formulë praktike për të arritur paqen. Prandaj porositen besimtarët t'u japin selam të njohurve dhe të panjohurve (Buhari, Iman, 6) Kjo porosi është një rregull e artë në krijimin e komunikimit midis njerëzve. Pejgamberi (a.s.), në një rast u

tha shokëve të tij: "A t'ju tregoj një punë që, nëse e bëni, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin mes jush." (Muslim, Iman, 93)

Pejgamberi (a.s.), jep një formulë të thjeshtë, por shumë efektive për arritjen e bashkimit dhe unitetit të shoqërisë. Në këtë mënyrë, ai (a.s.), na shfaqet edhe një herë si një edukator i pasqor në aftësinë për të ndërnuar një shoqëri të lumtur dhe të qetë.

Selami që na ka mësuar Pejgamberi (a.s.), është parulla jonë e përbashkët. Përmes saj ne krijojmë lidhje dhe komunikim me të gjithë njerëzit, pavarësisht gjuhëve të ndryshme që flasim. Kjo vërehet më së shumti në haxh, në kongresin vjetor të myslimanëve, ku përmes selamit njerëzve të kombësive të ndryshme u jepet mesazhi i vëllazërisë dhe miqësisë së ndërsjellte.

Në përgjithësi, kur takohen dy njerëz, njëri pret selamin dhe reagimin e tjetrit. Duke pritur selamin e parë prej tjetrit krijohet një mungesë komunikimi. Prandaj, Pejgamberi (a.s.), thotë: "Më i dashur tek Allahu është ai që jep selam i pari." (Ebu Davud, Edeb, 132-133)

Dhënia e selamit është sunet, kurse marrja është farz. Përse ky dallim, vallë? Sepse dhënia e selamit është një virtyt dhe, në rast se nuk kthehet, krijohen lëndime, qejfmbetje dhe pakënaqësi. Për të mos u dhënë shkas këtyre, marrja e selamit është më e rëndësishme se dhënia e tij. Në dhënien e selamit nuk duhen bërë dallime midis njerëzve për arsye pozitive dhe statusi shoqëror. Pejgamberi (a.s.), u jepte selam të gjithëve pa dallim. Selami do të jetë edhe përshëndetja e banorëve të Xhenetit. "**Përshëndetja e tyre, kur ta takojnë Atë është "Paqe." Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar.**" (Ahzab, 44)

"Nuk ka vlerë të Allahu braktisja e ngrënies dhe pirjes pa braktisur gënjeshtren dhe të vepruarit me të."

(Buhari, Saum, 8)

Në hadith theksohet fakti se agjërimi nuk është thjesht privim i vetes nga ngrënia dhe pirja. Për një agjërim të vërtetë duhet të qëndrojmë larg fjalëve dhe punëve boshe. Ndërprerja e ushqimit dhe e marrëdhënieve seksuale gjatë agjëritit janë kushtet minimale që duhen për plotësimin e tij. Hadithi i lartpërmendur dhe shumë hadithe të tjerë, na kujtojnë se për kryerjen e adhurimit të agjëritit duhen plotësuar edhe kushte të tjera.

Përmes adhurimit, krahas bindjes dhe dashurisë ndaj Allahut, feja islame synon edhe ngritjen morale të njeriut. Madje, mund të themi se synimi i të gjithë adhurimeve është përmirësimi moral. Një nga synimet kryesore të namazit është pikërisht ky. **"Vërtet që namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..."** (Ankebut, 45) Në të njëjtën vijë është edhe hadithi: **"Agjërimi është mburojë. Prandaj, kush agjëron, të mos flasë fjalë të këqija dhe të mos sillet keq me të tjerët."** (Ebu Daud, Sijam, 25) Ajeti kuranor: **"O besimtarë! Ju është obliguar agjërimi, ashtu si u ishte obliguar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat."** (Bekare, 183), shpreh si urtësi të obligimit të agjëritit ruajtjen nga të këqijat.

Nga pikëpamja e pastrimit shpirtëror, agjërimi konsiderohet si zekati i trupit. Në njëfarë mënyre, ai është si një gjimnastikë shpirtërore që e ushtron njeriun të qëndrojë larg kënaqësive tokësore. Përmes disiplinimit të dëshirave, njeriu kupton që trupi nuk është çdo gjë, por për një jetë të ekuilibruar dhe aktive, krahas nevojave biologjike duhen përbushur edhe një sërë nevojash shpirt-

ërore. Një person, që e privon veten nga gjërat e lejuara, nuk e ka aspak të vështirë ta privojë veten nga gjërat e ndaluara. Agjëruesi, duke e privuar veten për një kohë të caktuar nga nevojat trupore, kupton se duhet ta privojë nefsin vazhdimisht nga veset, si thashethemet, gënjeshttra dhe fjalët fyese.

Nga njëra anë, agjëruesi kupton vlerën e mirësive që zotëron, kurse nga ana tjetër kupton më mirë gjendjen e nevojtarëve dhe në këtë mënyrë bëhet më i vetëdijshëm për rolin dhe detyrimet që ka ndaj shoqërisë. Përmes agjëritit fiton kënaqësinë e përfitimit të virtyteve të tilla, si ndihma reciproke, sakrifica dhe bamirësia. Pejgamberi (a.s.), për t'i nxitur besimtarët në vlerësimin e këtij muaji të shenjtë, thotë: **"Në këtë muaj hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyert e Xhehnemit, kurse shejtanët lidhen me pranga."**

Ramazani është një muaj i begatë, ku hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyert e Xhehnemit. Nga kjo pikëpamje, është një rast i jashtëzakonshëm që duhet shfrytëzuar nga çdo besimtar. Ramazani i jep mundësi çdokujt ta rifillojë çdo gjë. Prandaj Pejgamberi (a.s.), thotë: **"Atij që agjëron duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen të gjitha mëkatet e kaluara."** (Buhariu, Iman, 27)

Pra, qëllimi dhe urtësia e agjëritit nuk është thjesht privimi i vetes nga ngrënia dhe pirja, por është një përpjekje për të përmirësuar veten dhe kuptuar më mirë begatitë dhe gjendjet e të tjerëve. Nëse agjërimi ynë nuk i arrin këto synime, atëherë ai shndërrohet në program diete.





NAMAZI

ELIKSIRI I TË RIUT MYSLIMAN

Të gjithë krijesat në gjithësi: Dielli, Hëna, yjet, shkurret, barërat, pemët etj., janë gjithnjë në gjendjen e përkujtimit të Allahut të Madhëruar. Shpendët që fluturojnë tufa-tufa në qiell, malet e shkëmbinjtë i bëjnë ibadet Allahut përmes një tesbihati, të cilin ne nuk e njohim. Bimët bëjnë ibadet në këmbë (kijam); kafshët e bëjnë gjysmëpërkulur (ruku); kurse krijesat jofrymore e bëjnë ibadetin të puqura me tokën, pra në sexhde. Edhe gjendja e krijesave të qiejve është e tillë. Një pjesë e engjëjve bëjnë *tesbih* dhe *tehlil* në kijam, një pjesë në ruku dhe pjesa tjetër në sexhde.

Kurse namazi, që për besimtarët është ofruar si një miraxh, i përfshin të gjithë ibadetet. Ndaj dhe një besimtar që fal namazin duke kryer të gjithë ibadetet që bëjnë të gjitha krijesat që gjenden në qiej e në tokë, arrin të përfitojë shpërblime të pafundme dhe manifestime të thella shpirtërore.

Zoti i Madhëruar, e bëri njeriun më të përshtatshmin fizikisht në mesin i gjallesave, për t'i bërë sexhde Atij. Ndaj dhe mes namazit dhe njeriut ekziston një lidhje mjaft e fortë.

Namazi është koha e takimit me Allahun. Namazi i është dhuruar ymetit si një miraxh i vogël. Sipas urdhrit: **"Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"**, begatia e të dalurit në audiencë të Zotit arrihet përmes namazit.

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Namazi është drita e syve të mi." (Nisai, Isharetun-

1. El-Alak, 19.

Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199)

Namazi është shtyllë e fesë dhe dëshmuesi i Islamit. Me namazin nuk krahasohet asnjë ibadet.

Nga fisi Uzre patën ardhur tre vetë të Pejgamberi (a.s.), dhe qenë bërë myslimanë. I Dërguari i Allahut i pyeti:

- Kush do t'i mbajë si mysafirë këta?

Talha pati thënë:

- Unë, o Resulullah!

Kur po banonin tek Hazreti Talha, Resulullahu (a.s.), dërgoi një njësi ushtarake për ekspeditë. Njëri nga ata të tre u bë pjesë e kësaj njësie dhe ra shehid në luftë. I Dërguari i Allahut (a.s.), pas një periudhe kohore dërgoi një tjetër grup ushtarak për ekspeditë. Në të dytin ra shehid i dyti nga ata të tre. I treti, pas një periudhë kohe, ndërroi jetë në shtrat.

Talha (r.a.), tha:

"Këta tre persona që banuan tek unë, i pashë në ëndërr, në xhenet. Ai që vdiq në shtrat ishte më përpara se të tjerët. Ai që kishte vdekur i dyti vinte menjëherë pas tij, kurse ai që vdiq i pari ishte i treti. U habita dhe më erdhi keq që ai që vdiq në shtrat të ishte më i favorizuar sesa ata që ranë shehidë. Menjëherë u nisa te Pejgamberi dhe ia tregova ëndrrën. Resulullahu (a.s.), më tha:

"Këtu nuk ka ndonjë gjë për t'u habitur! Nuk ka njeri më të virtytshëm se besimtari që bën një jetë sipas Islamit dhe që nuk heq nga goja tesbihët, tekbiret dhe

tehlilet.” (Ahmed, I, 163.)

Pejgamberi (a.s.), për t’u treguar sahabëve vlerën e të jetuarit si mysliman, dha këtë shembull:

“Ai që vdiq në shtrat, a nuk bëri agjërim Ramazani për vëllain e tij që ra dëshmor? A nuk fali brenda një viti gjash-të mijë e kusur rekatë?” (Ndaj dhe mes tyre do të ketë dhe kaq dallim.) (Ahmed, II, 333.)

Ky transmetim tregon se namazi bën dallimin e madh jo vetëm mes besimtarit dhe jobesimtarit, por edhe mes besimtarit dhe besimtarit, për nga aspekti i nivelit shpirtëror.

ATA QË NUK FALIN NAMAZIN

Njerëzit që janë larg namazit e kalojnë jetën e kësaj bote pa begati. Në fytyrat e tyre nuk mbetet më bukuria e nurit hyjnor. Këta njerëz mbesin pa dashurinë e njerëzve të sinqertë. Sipas enigmës së hadithit “*Ju do të vdisni ashtu sikurse jetoni*”², ata e kalojnë me rrezik frymën e fundit dhe japin shpirt me shumë mundime. Varrin i ngushton ata dhe bëhet një nga gropat e xehneimit. U kalon me shumë vështirësi të ndryshme llogaridhënia dhe përfundojnë në xehnem.

2. Munavi, Fejzul-Kadir, V, 663



Njerëzit që janë larg namazit e kalojnë jetën e kësaj bote pa begati. Në fytyrat e tyre nuk mbetet më bukuria e nurit hyjnor. Këta njerëz mbesin pa dashurinë e njerëzve të sinqertë.

Ta'bir, 48, Xhenaiz, 93)

Një i ri besimtar duhet të ruhet nga kurthet e shejtanit në këtë rrugë dhe duhet të nxitojë të falë kaza namazet që ka lënë për arsye të ndryshme. Ndaj dhe në hadith thuhet:

“Kush harron ndonjë namaz, le ta falë atë kur t’i kuj-

Një mëngjes, Resulullahu (a.s.), u tha sahabëve:

“Këtë natë erdhën dy vetë (Xhebraili dhe Mikaili), më zgjuan dhe më thanë: Eja, na duhet të ikim. Dhe unë shko-va bashkë me ta. Shkuam tek një njeri që po flinte në një krah. Pranë tij po qëndronte një tjetër me një shkëmb të madh në duar e po ia shtyp-te kokën me shkëmb atij që po flinte. Sa binte shkëmbi në një krah, shkonte menjëherë ta merrte. Sa bënte ai ta merrte shkëmbin, atij që flinte i rregullohej sërish koka si më parë. Kurse tjetri përsëriste goditjen me shkëmb në kokë të atij që po flinte dhe shkonte sërish të merrte shkëmbin...”

Pyeta engjëjt:

- Subhanallah, ç’po ndodh këtu?

- Ta shpjegojmë ne, – më thanë. Ky njeri është një person që e ka ditur Kuranin përmendsh dhe e ka braktisur atë, si dhe është një njeri që lë namazin e obliguar (veçanërisht namazin e sabahut) dhe flet...” (Buhari,

tohet; nuk ka mënyrë tjetër shlyerjeje përveç kësaj.” (Muslimi, Mesaxhid, 314.)

Kur nuk zbatohet kjo këshillë e Pejgamberit tonë, borxhet e namazit që janë mbledhur si një mal, në botën tjetër e shpjen njeriun drejt falimentit.

PESË KOHËT E NAMAZIT

Secila nga pesë kohët e namazit ka vlerën dhe rëndësinë e vet. Ndarja e tyre në kohë të caktuara të ditës, si shpirtërisht ashtu edhe fizikisht për njeriun, ka një mijë dobi dhe urtësi. Ndaj dhe secila prej kohëve duhet kryer me kujdes dhe përkushtim.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i ka thënë ymetit, lidhur me pesë kohët e namazit:

“Allahu i Madhëruar më tha:

I kam bërë obligim për ymetin tënd pesë kohët e namazit. Kam dhënë një fjalë: kushdo që fal namazet në kohë, atë medoemos do e vendos në xhenet. Cilido që nuk i mbron ato namaze, për të nuk kam asgjë të premtuar.” (Ibn Maxhe, Ikametus-Salah, 194.)

“Nëse një mysliman, kur vjen koha e namazeve të obliguara, merr mirë abdest, fal namazin si duhet, duke bërë kujdes rukutë dhe sexhdet dhe është i përkushtuar, nëse nuk ka bërë ndonjë gjynah të madh, ai namaz i shlyen atij të gjithë gjynahet e mëparshme. Kjo është formulë e përhershme.” (Muslimi, Taharet, 7)

NAMAZI I XHUMASË

Namazi i Xhumasë është farz për meshkujt. Zoti i Madhëruar thotë:

“O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!” (Xhuma, 9.)

Sipas asaj që kuptohet nga ky ajet, gjatë kohës së faljes së Xhumasë është i ndaluar angazhimi me punë të tjera jashtë namazit të Xhumasë, sikurse është tregtia.

Resulullahu (a.s.), lidhur me namazin e Xhumasë ka thënë:

“Nëse një njeri merr abdest, vjen në namazin e Xhumasë dhe dëgjon hytben me qetësi, i falen të gjitha gjynahet që ka bërë që nga Xhumaja e kaluar dhe kësaj i shtohen edhe tri ditë. Kush luan me gurë, ndërkohë që dëgjon hytben, është zënë me punë të kota dhe ka humbur mirësinë e Xhumasë.” (Muslimi, Xhuma, 27.)

“Nëse disa njerëz heqin dorë nga namazi i Xhumasë, edhe Allahu i Madhëruar do t’i vulosë zemrat e tyre dhe do të bëhen gafilë.” (Muslimi, Xhuma, 40.)



*“O besimtarë,
kur të thirreni për (të falur)
namazin (e xhumasë)
në ditën e premte, nxitoni
për ta përmendur Allahun
dhe pezulloni tregtinë!
Kjo, që ta dini, është
më mirë për ju!”*

PËRKUSHTIMI NË NAMAZ

Të gjithë ibadetet duhen kryer brenda një entuziazmi të lartë shpirtëror. Veçanërisht namazi duhet falur me përkushtim. Në ajet thuhet kështu:

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet.” (Maun, 4 – 5.)

Edhe Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Nëse njeriu e kryen namazin në mënyrë të saktë, duke bërë siç duhet rukunë dhe sexhden, namazi atij njeriu i thotë:

“Ashtu sikurse më ke mbrojtur mua edhe Allahu të mbrojtë ty!” Namazi ngrihet lart (dhe pranohet). Nëse njeriu nuk e kryen saktësisht namazin, duke mos bërë sexhde dhe ruku siç duhet, namazi i thotë: Ashtu sikurse më ke humbur mua, edhe Allahu të humbtë ty!”

Namazi që fal, i mblidhet si paçavër dhe i përplaset për fytyrë.” (Bejhakui, Shuab, III, 143; Sujuti, Xhami, I, 58/364)

Përkushtimi në namaz është aq i rëndësishëm, sa rruga për të arritur në shpëtim kalon përmes kësaj dere. Në ajet thuhet:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të



"Nëse disa njerëz heqin dorë nga namazi i Xhumasë, edhe Allahu i Madhëruar do t'i vulosë zemrat e tyre dhe do të bëhen gafilë!"

cilët janë të përlulur në namazin e tyre." (Mu'minin, 1-2)

Edhe Pejgamberi (a.s.), tregon në këtë mënyrë se pranohet namazi, nëse falet me përkushtim:

"Nëse një njeri kryen namazin, atij i shkruhet vetëm një e dhjeta, një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta, një e treta ose gjysma." (Ebu Davud, Salat, 123 - 124/796; Ahmed, IV, 321)

"Nga namazi, njeriut i shkruhet vetëm pjesa e zemrës." (Suhejli, Ravdul-Unf, II, 208)

Pra, njeriu merr shpërblim nga namazi vetëm kur fal namaz me përkushtim dhe qetësi.

Gjatë namazit duhet bërë kujdes ndaj të gjitha rregullave të faljes. Një herë, Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Hajduti më i keq është ai që vjedh nga namazi i tij."

Sahabët e pyetën:

"O Resulullah, si mund të vjedhë njeriu nga namazi i tij?"

I Dërguari i Allahut ktheu këtë përgjigje:

"Atëherë kur nuk bën si duhet rukunë dhe sexhden.

Kur ngrihet nga rukuja dhe sexhdeja dhe nuk e drejton mesin si duhet." (Ahmed, V, 310; Darimi, Salat, 78.)

Në një tjetër hadith, Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Allahu nuk e sheh (pranon) namazin e atij që nuk e drejton si duhet mesin mes rukuve dhe sexhdeve." (Ahmedi, II, 525)

Sadoqë mund të përpiqemi të kryejmë me kujdes namazet, mund të mos i kryejmë si duhet. Ngaqë jemi njerëz, kemi të meta dhe gabime. Ndaj dhe duhet të bëjmë kujdes t'i plotësojmë përmes drejtimit nga Zoti me istigfar dhe me namaze vullnetare. I Dërguari i Allahut (a.s.), pati thënë kështu:

"Vepra e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kiametit është namazi. Nëse e ka kryer me rregull namazin, punët e tjera i shkojnë mbarë dhe del i fituar. Nëse nuk e ka të rregullt namazin, atëherë do të humbasë dhe do të dalë i dëmtuar. Nëse do të ketë ndonjë gjë të mangët nga farzet, atëherë Zoti që është Aziz dhe Xhelal, do të thotë:

"Pa shikoni, a ka namaze vullnetare?" Mungesën e farzeve e plotëson me namazet vullnetare. Pastaj edhe në veprat e tjera, i bëhet llogaria në këtë mënyrë." (Tirmidhiu, Salat, 188/413)

FALJA E NAMAZIT NË KOHËN E PARË

Falja e namazeve në kohën e parë është një prej çështjeve që kërkon kujdes. Përndryshe, të lësh namazin në kohën e fundit, duke e marrë me ngadalë dhe të falësh namazin me nxitim sikur po e heq qafe dhe pa dëshirë, Allahu na ruajtë, kjo gjë e çon njeriun në dyfytirësi.³

Lidhur me vonesën që bëhet për të falur namazin, Resulullahu (a.s.), tërheq vëmendjen në këtë mënyrë:

"Në faljen e namazit në kohën e parë është pëlqimi i Allahut, ndërsa në kohën e fundit është mëshira e Allahut." (Tirmidhiu, Salat, 13/172)

Pra, falja e namazit në kohën e parë, për arsye se është tregues i kujdesit dhe vullnetit të qëndrimit rigoroz ndaj urdhëresave hyjnore, bëhet shkak për kënaqësinë e Allahut. Krahas kësaj, të tregohesh i shkujdesur ndaj namazit dhe ta falësh atë në kohën e fundit, për arsye se është tregues i mungesës së kujdesit të bindjes ndaj urdhëresave hyjnore, nuk i jep njeriut ndonjë shpërblim, vetëm i jep mundësinë e shlyerjes së borxhit që ka ndaj farzit.

Hazreti Ala bin Abdurrahman rrëfen këtë ngjarje:

Një ditë pasdite patëm shkuar pranë Enes bin Malikut. Sapo shkuam ne, Enesi (r.a.), fali namazin e ikindi-

³. Shih. en - Nisa, 142.



së. I thamë se po e falte herët. Ai, për të na e shpjeguar se përse bënte ashtu, na tha:

Pasi Pejgamberi (a.s.), tha tri herë; 'Ai është namazi i dyfytyrësisë!' vazhdoi kështu:

"Njëri prej tyre ulet, ulet, sapo të fillojë të perëndojë dielli, ngrihet sapo të hyjë në mesin e dy brinjëve të shejtanit, ashtu sikurse një zog që mbledh ushqim, me shpejtësi shtrihet e ngrihet katër herë, edhe në namaz e kujton shumë pak Allahun." (Muvatta, Kurani Kerim, 46; Muslimi, Mesaxhid, 195.)

Ebu Dheri (r.a.), na tregon:

"Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Si do të jetë gjendja jote kur të jesh në krye të një-
rëzve që vonojnë namazin apo që e kanë bërë atë si
një kufomë, së cilës i ka dalë shpirti?"

Unë i ktheva përgjigje, duke pyetur:

"Ç'më urdhëroni në këtë gjendje?"

I Dërguari i Allahut (a.s.), më tha:

"Fale namazin në kohën e vet! Nëse mbërrin nama-
zin kur janë duke u falur ata, sërish fale! Ky do të jetë
për ty namaz nafle." (Muslimi, Mesaxhid, 238 - 240;
Darimi, Salat, 25.)

Qe pyetur Pejgamberi ynë i dashur (a.s.):

"Cila prej punëve është më e virtytshme?"

"Namazi që falet në kohën e parë." - pati kthyer përgjigje ai. (Ebu Davud, Salat, 9/426)

I Dërguari i Allahut (a.s.), këtë virtyt që ia këshillonte ymetit, pikësëpari e jetonte vetë. Ai pëlqente shumë

të falte namazin sapo të hynte koha, në çfarëdo gjendjeje dhe kudo që të ishte.⁴ Ndaj dhe Hazreti Aishja (r.a.), ka thënë:

"Allahu i Madhëruar e mori Resulullahun (a.s.), pranë Vetes, pa e vonuar as dy herë namazin për në kohët e fundit." (Tirmidhiu, Salat, 13/174; Ahmedi, VI, 92.)

FALJA E NAMAZEVE ME XHEMAT

Një nga pikat më me rëndësi lidhur me namazin, është falja me xhemat e namazeve farz. Falja e namazit me xhemat është sunet *muekked*, i formës së vaxhibit. Pejgamberi (a.s.), përveç ditëve të fundit, nuk e ka lënë asnjëherë xhematin.

Urdhërimi me këmbëngulje që namazet të falen me xhemat, tregon rëndësinë që i kushton feja jonë edukimit shoqëror. Vepra e mirë me më rëndësi, që forcon ndjenjën e të qenit bashkë dhe në unitet, është falja e namazeve me xhemat. Aty ku falen namazet me xhemat, ka nisur të kuptohet përbërja shpirtërore dhe shoqërore e Islamit.

Në ajetin: "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.**" (Fatiha, 5.), që themi në çdo rekat të namazit, Zoti na këshillon të jemi me xhemat, të paktën dyzet herë në ditë.

Disa nga hadithet lidhur me këtë temë, janë këto:

"Namazi që falet me xhemat është 27 gradë më lart se namazi që falet vetëm." (Buhari, Ezan, 30.)

"...Dua që të jeni së bashku si xhemat dhe t'i shman-
geni ndarjes ndërmjet jush. Shejtani është me ata që
jetojnë vetëm. Edhe dy njerëz janë larg, ndaj atyre
që jetojnë bashkë. Kush dëshiron të jetë në mes të
xhenetit, le të vazhdojë pjesëmarrjen në xhemat..."
(Tirmidhiu, Fiten, 7/2165.)

Një ditë, Resulullahu (a.s.), kishte parë njërin që po falte namaz i vetëm dhe kishte thënë:

"A nuk ka njeri që do të bëjë mirë, duke falur namaz
së bashku me atë njeri?" (Ebu Davud, 55/574; Tirmidhiu, Salat, 164; Darimi, Salat, 98.)

Sipas asaj çfarë kuptohet nga transmetimet e tjera, personi në fjalë po falte namazin e drekës. Resulullahu (a.s.), dëshiroi që një njeri ta shoqëronte si xhemat në namaz, që të fitonte sevape.

I Dërguari i Allahut (a.s.), lidhur me çështjen e xhematit, nuk ka toleruar fare. Një ditë, sahabi i verbër, Abdullah Ibn Ummi Mektum (r.a.), pati thënë:

"O Resulullah! Medina ka plot insekte helmuese dhe kafshë grabitqare. (Unë kam frikë se mos më dëmtojnë këto krijesa. A mund të mos dal ta fal me xhemat

4. Shih. Buhari, Salat, 48

e ta fal në shtëpi?)”

Resulullahu (a.s.), i pati thënë:

“A e dëgjon ftesën: Hajje alessalah dhe hajja alel-felah? (Eja në namaz, eja në shpëtim). Atëherë mos ndalo, eja në xhami.” (Ebu Davud, Salat, 46/553.)

Jezid bin Amiri (r.a.), rrëfen:

“I shkova pranë Resulullahut, kur ai po falte namaz. U ula dhe nuk mora pjesë në xhemat. Kur i Dërguari i Allahut u kthye nga ne, pas namazit, më pa që po qëndroja në qoshe dhe më tha:

- O Jezid, a nuk je bërë mysliman ti?

- Jam bërë, o Resulullah! – i thashë.

- Atëherë, çfarë të pengoi ty të merrje pjesë në xhemat?

- Duke menduar se ju mund ta kishit falur namazin, e fala në shtëpi. – i thashë.

Atëherë, Resulullahu më tha:

- Nëse vjen në namaz dhe, nëse i gjen njerëzit në namaz, fale namazin bashkë me ta. Nëse e ke falur namazin më parë, kjo do të jetë nafile për ty. Ajo që ke falur në shtëpi është farz. (Ebu Davud, Salat, 56/577.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), u ka bërë qortime të ndryshme atyre që nuk falen me xhemat. Ubej bin Ka'b (r.a.), rrëfen:

“Një ditë Resulullahu (a.s.), drejtoi faljen e namazit të sabahut dhe pyeti:

- A erdhi në namaz filan person?

- Nuk ka ardhur, - i thanë.

- A ka ardhur filani? – pyeti.

- Jo, nuk ka ardhur. – i thanë.

Atëherë, ai (a.s.), tha:

- Ja, këta dy namaze (jacia dhe sabahu), janë namazet që u vijnë më rëndë hipokritëve. Sikur ta dinit se sa sevape kanë këto, edhe këmbadorazi do të vinit. Rreshti i parë është si rreshti i engjëjve. Sikur t'ia dinit vlerën, do të vinit duke garuar me njëri-tjetrin... (Ebu Davud, Salat, 47/554; Nesai, Imamet, 45)

Për arsye të rëndësisë që feja jonë i kushton namazit me xhemat, një nga dijetarët osmanë, Molla Fenari, nuk ka pranuar dëshminë e Jëlldërëm Bejazidit, sulltanit të kohës, për arsye se nuk po vazhdonte të falte namazin me xhemat. Kur sulltani pyeti i habitur për arsyen, ai i tha:

“Madhëri! Nuk po ju shoh të falni namaz me xhemat. Në fakt, ju duhej të ishit në rreshtin e parë, duke pasur parasysh se jeni udhëheqësi i këtij populli. Pra, ju duhet të jeni njeri që bëni *ameli salih*... Nëse nuk merrni pjesë në namazet me xhemat, bëheni shembull



i keq për popullin, gjë që bëhet pengesë për të qenë dëshmitar...”

Pas kësaj ngjarjeje, sipas një transmetimi tjetër, në shenjë mirënjohjeje ndaj fitores së betejës së Nigbolu-s, Jëlldërëm Bejazidi ndërtoi Ullu Xhaminë e famshme të Bursës dhe filloi të falej me xhemat pesë kohët e namazit.

NAMAZ DERI NË FRYMËN E FUNDIT

Lënia e namazit dhe neglizhenca ndaj tij nuk ka asnjëlloj justifikimi real. Edhe në kohë lufte madje, myslimanët falnin namazin me radhë.⁵

Ndaj dhe deri sa të japim edhe frymën e fundit, zemrën tonë duhet ta mbajmë gjithnjë vigjilente lidhur me namazin. Hazreti Enesi (r.a.), i cili na rrëfen çastet e fundit të të Dërguarit të Allahut, ka thënë:

“Ishim pranë Resulullahut (a.s.), gjatë çasteve të ndërrimit të jetës. Ai na tha tri herë:

“Kini frikë Allahun lidhur me namazet!” Dhe pastaj vazhdoi:

“Kini frikë Allahun lidhur me njerëzit që varen prej jush. Kini frikë Allahun lidhur me dy të pafuqishëm: njëra është gruaja e ve dhe tjetri fëmija jetim. Kini frikë Allahun lidhur me namazin!”

Pastaj Resulullahu (a.s.), nisi të përsëriste: “Namaz, namaz...”, derisa e dorëzoi shpirtin e tij të begatë. (Bejhakiu, Shuab, VII, 477.)

⁵ En-Nisa, 102.

Bajramet

e dashurisë dhe respektit

Xhafer Durmush

Dy dhuratat më të bukura të islamit janë festa e Fitër Bajramit dhe ajo e Kurban Bajramit. Në të parën, shpresojmë arritjen e mëshirës së Allahut Teala, ngaqë përgjatë një muaji jemi përpjekur ta kalojmë Ramazanin me ibadet, bindje dhe mirësi. Ndërsa në festën e Kurban Bajramit, përpiqemi të gjallërojmë kujtimin e faljes hyjnore, e cila u realizua prej nënshtrimit të Hz. Ibrahimit dhe Hz. Ismailit duke përfituar nga nënshtrimi i tyre. Në ajetet 3 dhe 4 të sures el-Enfal, përkufizohen cilësitë dalluese të besimtarëve dhe thuhet:

“Ata japin (për hir të Allahut) prej asaj që u kemi dhënë.” Edhe ne përpiqemi të hyjmë në grupin e këtyre fatlumëve.

Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, përgatitej për këto ditë të bekuara, këshillonte që të mos nënvlerësohej ana shpirtërore e tyre dhe thoshte se “gjallërimi i netëve të bajrameve me ibadet ka një virtut të veçantë.” (Shik. Ibn Maxhe, Sijam, 68.) Në lidhje me këtë, mund të themi:

Për ta kryer çdo gjë me atmosferën e adhurimit, duke filluar nga vizitat e deri te nderimet dhe dhuratat që bëhen, duhet ta përgatisim zemrën një natë më parë. Duhet të pendohemi dhe t'i kërkojmë falje Allahut të Madhëruar. Së pari, duhet ta qortojmë veten në mënyrë që të shtrijmë dorën e pajtimit. Duhet ta përgatisim veten për dhuratën më të mirë që do të bëjmë.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, për të treguar se si duhet t'i fillojmë këto ditë të veçanta që trokasin në derën tonë dy herë në vit, ka thënë:

“Gjëja e parë që do të bëjmë sot është falja e namazit.” (Buhari, Idejn, 3.) Hazreti Pejgamberi (a.s.), atmosferën e lumtur në ditët e bajrameve, dëshiron t'i fillojmë duke u bashkuar me njerëzit që tubohen plot hare nëpër xhami. Pa u larguar shumë nga atmosfera e namazit të sabahut, i cili falet me shoqërimin e tekbirove dhe të salavateve, Hazreti Pejgamberi dëshiron që në namazin e bajramit të gjithë duart të ngrihen drejt qiellit. Kështu duhet të fillojnë besimtarët ta perceptojnë bajramin. Të gjitha aktivitetet e tjera duhet të fillojnë pasi të përjetohet kjo atmosferë.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thotë: “Këto ditë, janë ditë ngrënieje dhe pirjeje.” (Ebu Davud, Saum, 50.) Hazreti Pejgamberi (a.s.), dëshiron ta dimë se sofrat më të bukura që mund të shtrohen ditëve të bajrameve janë ato që shtrohen me vetëdijen e zbatimit të urdhrit profetik.

Veçanërisht duhet të mendojmë për faljen e namazit të bajramit në sheshe të mëdha që bënte i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, për të siguruar sa më shumë pjesëmarrje. Duhet të mendojmë për gjetjen e jetimit të brengosur dhe ngushëllimin e tij.

Erzurumllu Ibrahim Hakkë shprehet në Marifetnamen e tij:

Ju i jepni vetëm atij që ju jep, i shkoni atij që ju vjen, i flisni atij që ju flet, i jepni për të ngrënë atij që ju jep për të ngrënë dhe nderoni atë që ju nderon. Këtu nuk keni ndonjë epërsi ndaj njëri-tjetrit. Por virtyti është t'i bësh mirësi atij që të bën keq, të shkosh te ai që nuk të vjen, të flasësh me atë që të qëndron larg, t'i

japësh për të ngrënë atij që nuk të jep dhe të nderosh atë që të tradhton. Atëherë, ju jini falës dhe modestë! Mbuloni gabimet e njerëzve dhe silluni me dhembshuri ndaj tyre, në mënyrë që të mëshiroheni!..

Pastaj i jep vend transmetimit të hadithit kudsij të mëposhtëm:

“Besimtarët duhet ta këshillojnë njëri-tjetrin për mirësi. Duhet ta mëshirojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Duhet t’ua lehtësojnë hallat vëllezërve të tyre duke i diskutuar dhe duke i ndarë ato me njëri-tjetrin. Kur ndonjëri prej organeve të trupit dhemb, edhe organet e tjera e ndjejnë atë dhimbje, dhe ndihmojnë derisa ai shërohet. Kur ndjen dhimbje një organ, i gjithë trupi shqetësohet.” (203. Muslim, Birr, 65.)

“Kushdo që e lumturon vëllain e tij mysliman në këtë botë, Allahu Teala e gëzon atë në këtë botë dhe në botën tjetër. Kushdo që e shpëton vëllain e tij mysliman nga njëra prej vështirësive të kësaj bote, edhe Allahu Teala do ta shpëtojë atë nga vështirësitë e Ditës së Kiametit.” (209. Buhari, Mezalim, 3.)

Elhamdulillah, sot kemi më shumë mundësi për të vizituar njëri tjetrin se sa në të kaluarën. Kemi shumë mjete, me anë të të cilave mund të komunikojmë dhe t’u shprehim të tjerëve dashurinë e respektin, kemi institucione bamirësie, me anë të të cilave mund ta ndajmë kafshatën tonë me myslimanin, që mund të ndodhet në anën tjetër të botës.

Atëherë, të gjithë duhet t’i kërkojnë llogari vetes: “Sa i vetëdijshëm jam unë për përcjelljen e traditave në të ardhmen, tradita të cilat janë mbrytur me shumë finesë e modesti, derisa kanë ardhur te ne?” Ne duhet të përpiqemi të japim kontributin tonë për zhdukjen e zemërimeve në shoqëri, në sajë të festave të bajrameve dhe ta respektojmë e ta duam në mënyrë reciproke njëri-tjetrin.

Atëherë, të gjithë duhet t’i kërkojnë llogari vetes: “Sa i vetëdijshëm jam unë për përcjelljen e traditave në të ardhmen, tradita të cilat janë mbrytur me shumë finesë e modesti, derisa kanë ardhur te ne?” Ne duhet të përpiqemi të japim kontributin tonë për zhdukjen e zemërimeve në shoqëri, në sajë të festave të bajrameve dhe ta respektojmë e ta duam në mënyrë reciproke njëri-tjetrin.

Lexo, Mendo

Pastërtia shpirtërore dhe fizike

Në suren el-Bekare, thuhet: **“Me të vërtetë, Allahu i do ata që pëndohen dhe ata që pastrohen.”**

Islami i ndërlihd bashkë, pastërtinë fizike e shpirtërore me pastërtinë e mjedisit, shëndetin e individit me shëndetin e shoqërisë. Prandaj ka nxjerrë në pah një shoqëri që do të jetë shembull gjithmonë për të gjithë njerëzimin. Sepse në Islam nuk mund të ndahet pastërtia fizike nga ajo shpirtërore. Ato konsiderohen plotësuese të njëra-tjetrës. Çdo fjalë apo sjellje që i dëmton njerëzit, është rixhs (ligësi).

Ka shumë ajete fisnike që e thërrasin myslimanin për t’u pastruar shpirtërisht dhe fizikisht. Në suren el-Ahzab, thuhet:

“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtarët, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin

për shpifje dhe një gjynah të qartë.”

Imam Neveviu e përmend ajetin e mësipërm para haditheve që bëjnë fjalë për pastërtinë dhe pastaj bën këtë shpjegim: “Ata që ndotin rrugët, sokaqet, vendet me hije, vendet me ujë dhe fusha të tjera që janë vende publike, kanë lënduar të gjithë njerëzit.” Sepse, ata që i bëjnë këto gjëra të shëmtuara kanë dhunuar të drejtat e të gjithë njerëzve. Nisur nga kjo, ata kanë bërë një mëkat të hapur.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Pastërtia është gjysma e besimit.” Hz. Pejgamberi ka njoftuar:

“Ndotja e rrugëve ku kalojnë njerëzit dhe e vendeve me hije”, janë dy sjellje që tërheqin mallkimin. Nisur nga kjo, në çdo vend dhe kohë jemi të obliguar ta mbajmë pastërtinë në të gjitha aspektet.

Reflektimi

Idris Arpat

Disa njerëz punojnë gjithmonë. Ata janë mëshirë për njerëzit dhe xhindet, për kafshët dhe për shpendët. Ata pothuajse janë një çezmë që rrjedh në mes të shoqërisë. E lartësojnë vazhdimisht cilësinë e jetës, si njerëz të punës që janë. Ata vazhdojnë ta harxhojnë energjinë e

trurit, të trupit dhe të zemrës deri në fundin e ditëve të tyre të caktuara nga Allahu, xhelle she'nuhu.

Disa njerëz lindin si hëna pesëmbëdhjetëshe dhe vijnë nga horizontet e lindjes. Ata lartësohen duke e ndriçuar botën e njerëzimit. Jetojnë për të mirën e njerëzimit dhe vdesin për të mirën e njerëzimit. Kur të shpërngulen nga kjo dynja provizore, u lënë bijve të Ademit të ardhme të ndritshme.

Disa njerëz janë të thellë dhe të gjerë. Shumë mirësi hyjnore vijnë për shkak të zemrave dhe mendjeve të tyre. Ata janë një mundësi për të gjitha gjallesat.



Disa njerëz janë të lehtë dhe të rrallë si një petal trëndafili. Vendin në të cilin gjenden, e zbukurojnë, i japin begati e vlerë, por nuk i bëhen barrë as sa një grimcë. Njerëzve nuk u thonë fjalë më të rëndë se trëndafili.

Kur disa njerëzve u shtohet dija, u shtohet edhe etja për dije. Halli i kërkimit që ata kanë, nuk ka derman. Janë si kuajt arabë, që sa më shumë të vrapojnë, aq më shumë u shtohet dëshira për të vrapuar. "Vrapojnë edhe pasi të mbarojë vrapit." Ata mbrojnë kauzat e humbura. U ngajnë reve të ngarkuara, që kërkojnë tokë për të lëshuar shiun.

Disa njerëz janë shumë përtej kësaj bote dhe të huaj për të. Ata na peshojnë shumë lehtë, por ne jemi shumë larg për t'i kuptuar. Askush nuk i dëgjon dot fatet që shpërthejnë në mendjet e tyre dhe vajtimet që lartësohen në zemrat e tyre.

Disa mendje janë të gatshme për të mësuar dhe disa zemra janë të gatshme për të dashur. Ata kërkojnë një fjalë të një poezi që e tejkalon fjalën, siç mund të kërkojnë grimcat e floririt në rërat e shkretëtirave.

Nganjëherë shfaqin sjellje dhe stile shumë magjepsëse. Është pak nëse themi dëlirësi, mirësjellje apo fisnikëri. Veprat e tyre nuk mund të përshkruhen me fjalë. Disa njerëz është e qartë se janë dielli i botës sonë shpirtërore.

Disa njerëz sjellin shërim për të tjerët. I shuajnë zjarret e zemrës dhe i ndalojnë luftërat që kanë filluar. "Në fillim kishte fjalë. Ne jemi fëmijët e civilizimit të fjalës. Fjalët zgjidhen prej fjalëve, të tjerat harrohen." Ka disa fjalë që ngrihen te Allahu Teala si lutje të pranuar.

Disa fjalë janë ndikuese si magjia.

Disa poezi ndikojnë te zemrat. Ndikojnë te njeriu si një fytyrë e bukur. Nëna jonë, Hazreti Aishja, radijallahu anha, nuk ka thënë kot: "Mësojuni fëmijëve tuaj poezinë, në mënyrë që t'u ëmbëlsohet gjuha."

Disa libra i lexoni shpesh. Në çdo faqe gjeni mendime të reja, informacione të rëndësishme dhe të dhëna të pavdekshme. Ju mund të thoni: "Këtë s'e kishim menduar."

Disa këngë popullore ju marrin dhe ju shpien në një botë tjetër. Digjet dhe përvëlohet kënga dhe ai që e këndon këngën.

Disa dashuri janë shumë të pastra. Ato u ngajnë buzëqeshjeve ndriçuese të fëmijëve të pafajshëm, degës së trëndafilit dhe shirave që zgjojnë malet e gurët.

Disa fjalë e gjejnë vendin e tyre, edhe nëse janë të vrazhda. Bashkëbiseduesi e meriton këtë. Çfarë ka thënë Bediuzzamani: "Rroftë xhehemi për tiranët."

"Xheneti është i shtrenjtë kurse xhehemi është i dobishëm."

Disa fjalë nuk kanë ndonjë dobi përveç se shtojnë mëkatet. Ato janë thënë si guri që rrokulliset nga mali. Ka fjalë që janë më të rënda se guri dhe hekuri.

Disa shpresa i japin gjallëri njeriut. Ato ju ngrenë dhe ju bëjnë t'i përvisheni sërish punës dhe të vazhdoni rrugën.

Disa harresa shndërrohen në mëshirë. Çfarë do të bënim sikur disa dhimbje të paharrueshme të vazhdonin përgjithmonë? Gjithëdija i takon vetëm Allahut Teala.

Disa fëmijë përfaqësojnë engjëjt përmbi tokë. Engjëjt nuk dinë të bëjnë mëkate. Meqë botën e kemi amanet, duhet të jemi shumë të kujdesshëm që amanetin ta dorëzojmë në mënyrë më të bukur. "Xhebraili (a.s.), ishte besnik. Edhe Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, ishte besnik." Edhe ne, si umet i Muhamedit, alejhi's-selam, duhet të jemi besnikë. Ah mjerë për ne, ah!

Errësira? Errësira qan në heshtje miku im. Hallet e vogla flasin, por hallet më të mëdha nuk ua hap gojën dot as me thikë. Disa lot gjithmonë rrjedhin brenda dhe jo jashtë.

Ka disa buzëqeshje që nuk mund të dihet nëse janë lajmëtare të të qarit apo të të qeshurit. Sa buzëqeshje janë buzëqeshje dhe sa vajtime janë vajtime nganjëherë!

Njeriu nuk duhet të bëjë rol, por duhet të jetë vetvetja. Falsiteti dhe syfaqësia nuk janë në përputhje me natyrshmërinë e pastër njerëzore.

Disa reve u ka hije vendi ku ndodhen. I admironi kur i shikoni.

Disa male shfaqin madhështi. Muajt kthehen në një kurorë të madhe kur arrijnë tetorin dhe nëntorin.

Disa kodra duken shumë sublime.

Disa përrenj u ngajnë fëmijëve të mbrapshtë. Rrjedhin duke u hedhur, bërtitur dhe klithur. Pa parë sa janë, e kthejnë vendin në një rrëmujë.

Disa pemë u ngajnë formave me kuptim.

Nganjëherë lulet buzëqeshin edhe nëpër shkëmbinj. Tani në mendje mund t'ju vijë kjo pyetje: "O Zot! Çfarë dëshiron të tregosh duke krijuar këto bukuri marramendëse në krye të maleve të shkreta dhe nëpër shkëmbinj?"

Disa varre mbajnë të vdekur shumë të vlefshëm. Njeriut i vjen turp t'u thotë "të vdekur" atyre, sepse ata akoma vazhdojnë të respektohen. Kur ata mbyllën sytë, këngët e tyre ngelën përgjysmë dhe baladat e tyre pa mbaruar. Ata po përpiqeshin të thonin fjalët më të bukura dhe për të bërë lutjet më të sinqerta.



Ka një transmetim (të cilin do ta rrëfej më poshtë) që më prek shumë, sepse më bën të mendoj dhe më djeg shpirtin. Më djeg shpirtin, sepse nganjëherë njeriut i jepen disa mundësi që, nëse përfiton prej tyre siç duhet, bëhet mbret, përndryshe humb çdo gjë. Këto mundësi mund të jenë një mirësi e madhe për të, për familjen, për të afërmit, për të dashurit, moshatarët, madje edhe për popullin dhe vendin e tij.


Por nëse njeriu nuk mendon dhe nuk e di vlerën e tij, nganjëherë e ndërron salltanetin me një dëshirë të zakonshme dy-tre grosh, me një pasion haram dhe një epsh të ulët. Ose e flijon për mendime të çuditshme, për shqetësime të pavend, për frikë të panevojshme dhe për fantazi të errëta. Njerëzit që nuk janë të dobishëm për veten e tyre, janë të dhënë shumë pas halleve të veta dhe në këtë mënyrë, mbyten në dallgët e mjedisit të keq që i rrethon. Ata janë në burgun e zi të presionit të mëhallës. I shkatërrojnë mundësitë në pusët qorre të shpresave imagjinare, që ndoshta nuk do të realizohen kurrë. Sa bukur kanë thënë gjyshërit tanë: "Mundësia vjen një herë në dorë, kështu që mos e lërë të të ikë!"

Ja pra, një mundësi e tillë i ishte ofruar me tepsi floriri Ufejfu'l-Kindit (r.a.). Njeriu nuk shikon pemën e tij që i ka zënë sytë, por shikon flizin e tjetrit që sapo ka filluar të shpërthejë. Gabimet tona nuk ka hambar që t'i zërë, ndërsa ne flasim për mangësitë e të tjerëve. Të flasësh për të tjerët është e lehtë, por burrëria është të mos e hamë bistakun edhe vetë, nëse është haram. Ajo që nuk u ka hije të tjerëve, nuk duhet të na ketë hije as ne, apo jo?

Sa shumë gjëra humbasin ndonjëherë për shkak se shohim të këqijat e të tjerëve. Unë po i shkruaj këto dhe po i tregoj, me shpresë që të marrim mësim nga pendimi që përjetoj ky sahab.

Ufejfu'l-Kindi (r.a.), thotë: "Unë isha tregtar. Edhe Abbas bin Abdulmuttalibi ishte tregtar. Abbasi vinte në Jemen, blinte erëra të mira (parfume) dhe i shiste në periudhën e haxhit. Ai ishte miku im. Në kohën e xhahilijetit shkova në Mekë. Shkova te shtëpia e Abbas b. Abdulmuttalibit. Familjes sime desha t'i blija ca rroba nga Meka dhe disa erëra të mira nga të Abbasit.. Në kohën e drekës po qëndroja pranë tij dhe po shihja Qaben.

Në ato momente, një mesoburrë iu afrua Qabes. E ngriti kokën drejt qiellit dhe pa. Pastaj, në këmbë, u drejtua nga Qabja. Më pas erdhi një fëmijë dhe qëndroi në këmbë në të djathtën e tij. Pa kaluar shumë, erdhi një grua dhe qëndroi pas tyre. Kur burri u përkul (ra në ruku), edhe fëmija me gruan ranë në ruku.



Xhemal Nar

VLER I MUNI

Burri u ngrit nga rukuja dhe u drejtua. Edhe fëmija me gruan u ngritën nga rukuja dhe u drejtuan. Burri ra në sexhde. Edhe fëmija me gruan ranë në sexhde. I thashë Abbasit:

- O Abbas! Kam parë diçka të madhe dhe të mahnitshme!

- Po! Ajo është diçka e madhe! A e di ti se kush është ky burrë?



ËSIMI DËSIVE!

- Jo! Nuk e di - i thashë.

Abbasi më tha:

- Ky është Muhamed b. Abdullah b. Abdulmuttalib.

Është djali i vëllait tim.

Pastaj më pyeti:

- A e di se kush është ai fëmija pranë tij?

- Jo! Nuk e di!

- Ai është Ali b. Ebu Talib b. Abdulmuttalib. Është djali i vëllait tim.

- A e di kush është kjo grua?

- Jo! Nuk e di!

- Ajo është Hatixhe bint Huvejlid. Gruaja e djalit të vëllait tim. Djali i vëllait tim thotë se kjo fe që pe dhe të cilën po e ndjekin ata, është urdhër i Zotit të qiejve dhe të tokës. Për Zotin, në të gjithë tokën, unë nuk di të ketë njerëz të tjerë në këtë fe, përveç këtyre të treve!

Ah sikur të kisha besuar atëherë dhe të bëhesha burri i dytë besimtar. Sa do dëshiroja të isha i katërti i tyre!"- thoshte i penduar Ufejfu'l-Kindi.¹

Allahu Teala qoftë i kënaqur prej Aliut, Hatixhe bint Huvejlidit, Ufejfu'l-Kindit dhe Abbasit! Po ashtu, qoftë i kënaqur edhe prej dijetarëve që na e kanë transmetuar këtë ngjarje!

A mund ta imagjinoni dot sa mirësi të madhe humbi ky burrë?

Të qenët burri i dytë në Islam! Të qenët mysliman më parë se Ebu Bekri (r.a.)!

Aman o Zot, sa mirësi e madhe është kjo! Sa humbje e madhe është nënvlerësimi i kësaj mundësie!

Ja pra, o vetja ime! Është e lehtë të shohësh fatkeqësinë dhe të thuash "obobo". Po, mundësia që nuk vlerësoi ishte e madhe. Por edhe ti, nëse do të dëshiroje, mund të bëheshe një veli i madh, një mik i Allahut Teala, një mysliman shembull dhe një burrë që kur të vdisje, të qanin për ty toka dhe qiejt. Madje ti, akoma mund të bëheshe.

Përse nuk je bërë?

Mbrëmë nuk të ka lënë të ngrihesh për namazin e natës një shije e përkohshme e gjumit. Mos vallë kjo ishte diçka që nuk e ke shijuar më parë? Fjete, por çfarë fitove? A nuk mund të ngriheshe natën, pastaj të flije deri vonë? A nuk do ishte më mirë sikur të bëje dhikër në kohën e agimit dhe ta falje namazin e sabahut me xhemat? Ja pra, ikën gjithë ato mundësi...

Mos vallë ndodh ndonjë gjë, nëse nuk u jep rëndësi mashtrimeve të djallit që nxit epshet, nëse nuk dëgjon thashethemet që i vijnë të ëmbla veshit dhe nëse nuk e fiton riskun në haram?

Vete, mos më bëj të t'i numëroj të këqijat! Të gjitha gjërat e humbura për ty, janë kënaqësi e çastit. Por pendimi për to vazhdon përgjatë gjithë jetës. Ndërsa kënaqësia e vërtetë që besimi lë në zemër, nuk mbaron dhe nuk konsumohet asnjëherë.

Përderisa nuk ka dalë shpirti, ka një shpresë. Akoma nuk ke vdekur, o vetja ime. Të thënë "ah, sikur" nuk ka dobi. Pendimi në fund është i vlefshëm vetëm nëse bën dobi.



KURANI DHE SUNETI i Pejgamberit (a.s.)

Serkan Këjly

5- URDHRI QË TREGON OBLIGIMIN SE GJYKIMI I KUNDËRSHTIMEVE I PËRKET ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ (A.S.)

Allahu i madhëruar, thotë:

“Nuk i takon asnjë besimtar i apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e tij, ai me siguri ka humbur.”

Komentuesi i Kuranit, Ibn Kethiri, thotë: “Ky ajet fisnik, përfshin të gjitha çështjet. Kështu që, kur Allahu dhe i Dërguari i tij të gjykojnë në një çështje, asnjë nuk mund të kundërshtojë dhe nuk mund të japë ndonjë mendim që t’i paraprijë gjykimin të tyre.” Allahu i madhëruar, thotë:

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e mira dhe

1. (el-Ahzab 36.) Shikoni shkakun e zbritjes së këtij ajeti në tefsirin e Ibn Kethirit.

shpjegimi më i bukur për ju.”²

Ibn Kethiri (r.h.), në komentimin e këtij ajeti, thotë:

“Bindjuni Allahut, do të thotë, ndiqni librin e Allahut. Bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të thotë, ndiqni sunetin e të Dërguarit të Allahut. Bindjuni udhëheqësve tuaj, do të thotë, bindjuni atyre, përderisa nuk kanë bërë ndonjë gjë kundër Allahut dhe përderisa t’u binden Allahut dhe të Dërguarit të tij (a.s.)”

Siç është transmetuar në një hadith të saktë, “Bindja është vetëm në mirësi”³, sepse e vërteta “nuk ka bindje ndaj krijesës në mëkat ndaj Allahut”, e shpjegon këtë në formën më të qartë.

Muxhahidët dhe të tjerët, në lidhje me ajetin “**Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit**”, kanë thënë: “Allahu i Lartësuar, me këtë urdhër kërkon që, kur robërit të bien në kundërshtime, përsa u përket çështjeve bazë dhe të

2. (en-Nisa 59.)

3. Buhari, Ahkam: 4, Muslim, Imarat: 39-40. Nxjerrur nga Imam A - medi. Shik. Xhami'u's-Sahih të Muhaddithit Shejh Muhamed Nasuriddin el-Albani.

detajuara të fesë, t'i zgjidhin ato me Librin që është urdhër i Zotit dhe me sunetin e Pejgamberit. Siç thotë edhe Allahu: **“Thuaj: Për çdo gjë që ju të diskutoni, fjala e fundit i përket vetëm Allahut.”**⁴

Kush gjykon drejt në një çështje, duke sjellë argumente nga Kurani dhe suneti, kjo është e vërtetë. Pas të vërtetës ka vetëm devijim. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar, thotë:

“Nëse me të vërtetë i besoni Allahut dhe ahiretit”, domethënë, gjykoni me librin e Allahut dhe me sunetin e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, në çdo çështje që keni rënë në kundërshtime duke e lënë mënjanë injorancën dhe armiqësinë.

“Nëse me të vërtetë i besoni Allahut dhe ahiretit”. Fakti që ky ajet fisnik është argument për këtë, do të thotë se kush nuk gjykon me Kuran dhe sunet për gjatë kundërshtimeve, ose kush nuk i drejtohet Kuranit dhe sunetit në kundërshtime, nuk i beson Allahut dhe të Dërguarit të tij.

“Kjo është më e mira për ju”, do të thotë se, gjykimi me librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit apo drejtimi te këto të dyja për çështjet që nuk pajtoheni, është më e mira për ju.

“Kjo është më e mira dhe shpjegimi më i bukur për ju.” do të thotë se, si përfundim, kjo është gjëja më e drejtë që mund të bëni.

Imam Shafiu (r.h.), në librin e tij me titull “er-Risale”, thotë: “Pas vdekjes së Hz. Pejgamberit, çështjet në të cilat ka kundërshtim, i drejtohen gjykimit të Allahut⁵ dhe gjykimit të të Dërguarit të Allahut.

Nëse të dy palët nuk kanë argument nga Kurani për çështjen që nuk pajtohen, atëherë duhet t’u drejtohen kijasave (krahasimeve) të sakta nga Kurani dhe suneti. Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kijas do të thotë marrje e argumenteve nga një lajm që vjen nga Kurani e suneti dhe për të cilin kanë rënë në konsensus dijetarët. Këto dy dije janë farz për t’u mësuar.”

Në vazhdim, Imam Shafiu thotë: “Kur dikush të dëgjojë një fjalë që e ka thënë i Dërguari i Allahut, duhet të punojë me të në përgjithësi, derisa të gjejë një

argument të qartë.” Shkurtimisht, myslimani duhet të punojë me kuptimin e përgjithshëm të hadithit. Kjo gjendje shikohej edhe te sahabët, derisa gjenin një argument të qartë që vërtetonte të kundërtën. Allahu Teala qoftë i kënaqur me ta.

Kur sahabët dëgjonin një hadith nga i Dërguari i Allahut (a.s.), i linin mendimet dhe gjykimet e tyre. Madje, edhe nëse ishte hafle, e anulonte gjykimin që kishte dhënë dhe vepronte sipas gjykimit të hadithit.

Kur Hz. Umer (r.a.), gjykoi në lidhje me dëmshpërblimin e çdo gishti dhe kur sahabët e dëgjuan që në letrën e Amr b. Hazmit ka një hadith që e kundërshton këtë, e lanë gjykimin e Hz. Umerit dhe vepruan sipas gjykimit të hadithit. Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thotë: **“Duke filluar nga ky çast, dëmshpërblimi për çdo gisht është dhjetë deve.”**⁶

Shejh Abdulaziz bin Abdullah bin Bazi, në librin e tij me titull “Zbatimi i sunetit është vaxhib, mohimi i tij është kufër”, thotë:

Sipas atyre që mendojnë, se suneti nuk është argument apo se nuk është ruajtur i tëri, Allahu i ka lënë robërit e tij në dorë të diçkaje që nuk ekziston. Ky është një mendim dhe besim i humbur.

Në të njëjtën kohë, është kufri më i madh që bëhet kundërshtim Allahut dhe paragjykimi më i keq ndaj tij. (Transmeton el-Hakimi në el-Mustedrek.)

6- IMITIMI VJEN NË KRYE TË DEBATEVE MË TË RREZIKSHME

Allahu (xh.xh.), thotë: **“Bindujni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.”**⁷

Allahu (xh.xh.), na njofton se debati është shkak për humbje. Kur të gjykojmë me librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), atëherë nuk do të ketë debate dhe grindje ndërmjet nesh, sepse grindjet e debatet lindin për shkak se njerëzit janë fanatikë për mendimet e tyre ose për shkak se im-

4. (esh-Shura 10.)

5. Kjo është baza. Nëse biem në kundërshtime, duhet t’i kthehemi Kur - nit dhe sunetit. Këtë e vërteton kjo fjalë e Allahut: **“Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojeni Allahut dhe të Dërguarit...”** (en-Nisa 59.)

6. Transmeton el-Hakimi në Mustedrek. Er-Risale....

7. (el-Enfal 46.)



itajnë të tjerët pa parë argumentet.

Ja, sahabët e nderuar (Allahu qoftë i kënaqur me ta), nuk imitonin askënd. Edhe katër imamët e të tjerë nuk ishin fanatikë në mendimet e tyre, por u jepnin përparësi haditheve të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Po ashtu i ndalonin edhe të tjerët që t'i imitonin pa pasur njohuri për argumentet. Diçka është e vërtetë se, sahabët ishin njerëzit më të mirë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Njerëzit më të mirë janë ata që jetojnë në kohën time (sahabët), pastaj brezi pas tyre (tabiinët), pastaj brezi që vijnë pas tyre (tebei tabiin).”⁸

Kur Allahu dhe i Dërguari gjykonin në një çështje, ata nuk thoshin asnjë fjalë dhe nuk kundërshtonin. Ata kapeshin shumë fort pas sunetit të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka këshilluar:

“...Atëherë, mos u ndani nga suneti i halifeve udhërrëfyes, që janë udhëzuar me sunetin tim. Kapuni fort pas sunetit tim dhe largohuni nga risitë në fe, sepse çdo risi në fe, është bidat. Çdo bidat, është devijim.”⁹

Me të vërtetë, çdo gjë që nuk është në sunet, është bidat. Veprimi i një pune të tillë, nuk është i lejuar, edhe nëse është thënë nga ndonjë imam i madh. Në lidhje me këtë çështje, Shejhu'l-Islam Ibn Tejmije, thotë:

“Nëse dijetari bie në gabim duke kërkuar të vërtetën kur bën ixhtihad, nuk merret në llogari për gabimin që ka bërë dhe nuk ndëshkohet. Përkundrazi, ai merr sevap. Ky sevap i jepet për shkak të ixhtihadit dhe gabimi i tij falet.”

Shumica e dijetarëve selefë dhe ata halefë kanë bërë ixhtihad, kur nuk kanë pasur ndonjë argument. Ata kishin frikë nga Allahu, për këtë arsye, luteshin:

“O Zot! Mos na bëj përgjegjës, nëse harrojmë apo gabojmë!”¹⁰ Allahu Teala, duke e pranuar këtë lutje, u thotë: “Unë nuk ju bëj përgjegjës për këtë.” Ky hadith është i saktë.¹¹ Sahabët e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk ishin kurrë fanatikë.

8. Buhari, Muslim, Fadaili's-Sahabe; 7/211, Buhari, Shehadet 5/190, Tirmidhi, Fiten: 2222.

9. Ebu Davud, Sunnet; 5, 2/611, Hadithi nr: 4607, Tirmidhi, Ilm: 16, ibn Maxhe, Mukaddime; 6,

1/15-17. Shejh el-Bani, në Dhilalu'l-Xhenneti fi Tahrixhi's-Sunne 1/17-19, hadithi është i saktë. Ahmed b. Hanbel, Musned, 4/126-127. Bejhaki, Med'hal: 135, Hakim, Mustedrek, 1/95-96.

10. (el-Bakara 286.)

11. Mearixhu'l-Vusul.

Allahu i madhëruar, thotë: **“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit! Allahu, me siguri, i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë provë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.”¹²**

Ai njeri që vazhdon në fanatizëm, duke mbrojtur medh'hebin e tij kur gjendet një hadith që e kundërshton atë, do të thotë se ia drejton thirrjen e tij të Dërguarit të Allahut, siç ua drejton të tjerëve. Në këtë mënyrë, i Dërguari është në të njëjtën pozitë me të tjerët dhe fjalën e medh'hebit e ka vlerësuar më shumë se fjalën e Allahut dhe të të Dërguarit (a.s.).

Në lidhje me këtë, Allahu Teala, thotë:

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kjeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm.”¹³ Ndërsa në një ajet tjetër, thotë:

“Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: ‘Dëgjojmë dhe bindemi’. Pikërisht këta janë të shpëtuarit. Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë.”¹⁴

Për këtë arsye, selefët e devotshëm, janë kapur fort pas sunetit të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dhe i kanë refuzuar të gjitha fjalët që bien në kundërshtim me të.

FJALË TË IMAMËVE

Me të vërtetë, katër imamët dhe imamë të tjerë (Allahu qoftë i kënaqur me ta), kanë thënë se, kur hadithi të jetë i saktë, duhet të punohet me të. Ata nuk e kanë kundërshtuar kurrë hadithin. Në të njëjtën kohë, nuk kanë imituar. Ja mendimet e imamëve muxhtehidë, në lidhje me temën tonë:

Imam Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë), thotë: “Nëse hadithi është i saktë, ai është medh'hebi im.”¹⁵

12. (en-Nur 63.)

13. (el-Huxhurat 1.)

14. (en-Nur 51-52.)

15. el-Hashije e Imam ibn Abidinit vëll. I, fq. 63 dhe Resmu'l-Mufti, Mexhmuati Resaili ibn Abidin, vëll. I, fq. 4. Sipas transmetimit të Shejh Salih el-Fullanit në “ikazu'l-Himem” fq. 63 dhe ibn Abidin ibnu'sh-Shahne në “Sherhu'l-Hidaye”, thuhet:

“Nëse hadithi është i saktë, mund të punohet me të edhe nëse bie në kundërshtim me mendimin e medh'hebit dhe medh'hebi i njeriut, është gjykimi i hadithit. Puna me hadithin e saktë, nuk e nxjerr njeriun imitues nga medh'hebi Shafi apo Hanefi.

“Askujt nuk i lejohet të punojë me mendimin tonë, pa e ditur nga e kemi marrë.”¹⁶

Në një transmetim tjetër, ka thënë: “Është haram që të jepet feta me mendimin tim, pa e ditur argumentin se ku mbështetem.” Në një transmetim tjetër, ndodhet edhe kjo shtesë: “Ne jemi njerëz. Sot themi një fjalë, ndërsa nesër heqim dorë prej saj.”

Ndërsa, në një fjalë tjetër të bukur, thotë: “Njerëzit kanë për të shpëtuar, përderisa ndërmjet tyre të ketë prej atyre që merren me hadithin. Kur ta kërkojnë dijen jashtë hadithit, atëherë prishen. Largohuni nga gjykimi sipas mendimit tuaj personal, në lidhje me një çështje në fenë e Allahut. Pasoni sunetin. Kush largohet nga suneti, devijon.”

Imam ebu Hanife ka edhe shumë fjalë të tjera të ngjashme me këto. Nga ana tjetër, imam Maliku, i ka ndaluar njerëzit që të mbartin librin e tij me titull el-Muvatta.¹⁷

Imam Maliku, në një fjalë të tij, ka thënë: “Unë jam njeri. Siç gjej të vërtetën, edhe gaboj. Ju shikoni mendimet e mia. Ata që përputhen me librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Allahut, merrini, ndërsa të tjerët, lërimi!”¹⁸

Ndërsa Imam Shafi, thotë: “Unë nganjëherë them një fjalë dhe vendos një parim. Nëse gjendet ndonjë hadith i Hz. Pejgamberit, që e kundërshton mendimin tim, atëherë gjykimi i të Dërguarit të Allahut, është mendimi im.”¹⁹

“Nëse më arrin një hadith i saktë nga i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe nuk punoj me të, atëherë dëshmoni se kam luajtur mendsh.” Ndërsa në një fjalë tjetër, thotë: “Nëse unë them një fjalë, e cila bie në kundërshtim me një hadith të ardhur nga i Dërguari i Allahut, fjalën time përplaseni për mur.”²⁰

“Nëse kam thënë ndonjë fjalë në lidhje me një çështje dhe nga Hz. Pejgamber vjen një hadith i saktë që e kundërshton atë, hadithi i të Dërguarit të Allahut është më i drejtë. Mos më imitoni mua.”²¹

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, në lidhje me këtë temë, thotë: “Mos më imito mua! Po ashtu, mos imito as Malikun, as Shafiun, as Evzain dhe as Theurin. Edhe ti merre dijen nga burimet që e kanë marrë ata.”²²

“Kush refuzon hadithin e të Dërguarit të Allahut, është në prag të shkatërrimit.”²³

Ja, këto janë disa fjalë të imamëve që urdhërojnë pasimin e sunetit dhe ndalojnë imitimin e të tjerëve pa bërë ndonjë studim. Fanatizmi medhhebor nuk është përhapur në dy shekujt e parë, por të gjithë e dinë se në fillim të shekullit të tretë, umeti Islam ka bërë shumë çlirime. Për këtë arsye, imam Maliku, thotë:

“Ky umet rregullohet vetëm me besimin që kanë pasur ata në fillim.” Paraardhësit e këtij umeti, nuk janë rregulluar duke ndjekur imitimet, bidatet dhe dëshirat vetjake. Sigurisht se janë rregulluar duke ndjekur argumentin. Allahu i madhëruar, thotë:

Thuaj: “Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I lavdëruar qoftë Allahu; unë nuk jam prej idhujtarëve!”²⁴

Për shkak të imitimit, umeti është ndarë në grupe dhe fraksione. Po ashtu, si rezultat i imitimit, janë përhapur bidatet dhe janë fshehur gjurmët e sunetit. U vra lëvizja e mentalitetit dhe u ndalua rryma e mendimit. Pavarësia e dijes u humb aq shumë, sa që e dobësoi personalitetin e umetit. Në këtë mënyrë, umetit ia humbën jetën shpëtuese dhe e ndaluan të zhvillohej e të përparonte. Të huajt e përdorën këtë dhe filluan të ndikojnë në thelbin e Islamit.

16. I- Ibn Abdi'l-Berr el-Intika fi Fedaili Selaseti'l-Eimmeti'l-Fukaha fq. 145.

2- Ibru'l-Kajjim, llamu'l-Muvakkîn, vëll. 11, fq. 309. Ibru'l-Kajjimi ka thënë se ky transmetim, që vjen nga Ebu Jusufi kategorikisht është i fortë, vëll. 2, fq. 544.

3- Ibru Abidin, el-Hashiye alel-Bahrir-Raile 6/293.

4- Resmu'l-Muftu, sh. 29-32.

5- Sherani, el-Mizan, vëll. I, fq. 55. Kjo fjalë kalon edhe në vepra të ngjashme me këto. Mizanu'l-Kubra esh-Sherani 1/51.

17. Mizanu'l-Kubra, esh-Sherani 1/51.

18. Kjo fjalë është e njohur ndërmjet dietarëve pas tij.

19. Ibru Asakir, Tarihu Dimashk (15/1/3). el-Ikazz fq. 100. I'larnu'l-Muvakiin: 2/363-364.

20. Harevi, Zemmu'l-Kelam 3/41/1. Hatib Bagdadi, (el-Ihtixhaxh Bi'sh-

Shafii (812). Ibru Asakir 15/9/10. Nevevi; el-Mexhmû 1/163.

21. Ibru Ebi Hatim, Ebu Nuajm ibn Asakir; 15/9/2.

22. el-Fullani; 113, I'larnu'l-Muvakkîn, vëll. 2, fq. 302.

23. Ibru'l-Xhevzi, fq. 182.

24. (Jusuf 108).





PENGESAT ndaj devotshmërisë

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Karakteristikat që nxisin dhe frenojnë përsipirtshmërinë e njeriut janë të fshehura te ai vetë. Devocioni është i lidhur ngushtë me arritjen e pjekurisë intelektuale, përmirësimin e zemrës dhe pastrimin e egos nga dëshirat e tepruara mondane, sepse devocioni është çështje ndjesie, ndjenje dhe zemre. Nga ana tjetër, ndjenjat e njeriut janë shumë komplekse, të ndërlikuara dhe nën ndikimin e vazhdueshëm të një sërë faktorësh, prej të cilëve marrin formë dhe drejtim.

Mbi të gjitha, devocioni kërkon sinqeritet dhe çil-

tërsi. Sinqeriteti është distilimi dhe rafinimi i qëllimit për çdo vepër dhe adhurim, nga pjesët e huaja dhe përzierjet e tjera. Sinqeriteti i ngjason qumështit të pastër dhe të kulluar të nënës, që del nga infiltrimi i ushqimit në stomak. Ashtu siç turbullojnë qumështin gjaku dhe lëmishtet, edhe hipokrizia në fe turbullon sinqeritetin. Dy janë cilësitë kryesore që ushqejnë dhe nxisin devocionin. E drejta dhe sinqeriteti. E drejta shpreh përputhjen e veprimit me rrugën dhe modelin e Pejgamberit (a.s.), kurse sinqeriteti shpreh kryerjen e aktit vetëm për hir të Allahut. Ajetet shprehin pikërisht këtë fakt **“...kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!”** (Kehf, 110) **“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?”** (Nisa, 125)

Për subjektin ekziston qëllimi dhe akti. Sinqeriteti shpreh qëllimin e pastër, kurse saktësia shpreh kryerjen e aktit në mënyrë të efektshme. Saktësia është thelbësore, kurse sinqeriteti ndodh pas aktit, sepse sinqeriteti ndjek saktësinë. Gjëja më e rëndësishme për devotshmërinë e besimtarit është sinqeriteti. Përmes sinqeritetit personi bëhet i vetëdijshëm për gjendjet që dëmtojnë veprat, sepse njeriu është përgjegjës për veprën dhe qëllimin e saj. **“Prandaj, Kurani urdhëron: ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë,**

duke qenë në fenë e pastër” (Bejine, 5.)

Pengesat më të mëdha të devotshmërisë janë intrigat dhe dredhitë e egos. Prandaj duhet njohur mirë sinqeriteti dhe faktorët që e dëmtojnë atë. Ndonjëherë, duke e shtrembëruar ndjenjën e adhurimit, njeriu e orienton atë drejt pozicioneve negative. Këto shfaqje negative të adhurimit, me kalimin e kohës e largojnë njeriun nga devotshmëria e pastër. Fenomenet negative të adhurimit, të cilat e largojnë njeriun nga devotshmëria, janë kurthet e egos.

Devotshmëria kërkon sinqeritet. Devotshmëria nuk dëshiron rezistencë në ibadet dhe bindje. Shtatë shkaqet dhe pengesat e egos, që ndotin shpirtin, sëmurin zemrën dhe dëmtojnë devotshmërinë, janë: 1- Mendjemadhësia, 2. Vetëpëlqimi, 3. Hipokrizia, 4. Zemërimi, 5. Zilia, 6. Lakmia për pasuri, 7. Ambicia për pushtet.

1. Mendjemadhësia është shprehje e madhështisë për veten, veti të cilën Allahu ia ka atribuar vetëm Qenies së Tij, duke përjashtuar çdo krijesë nga vetia e madhështisë. Mendjemadhësia është një cilësi e shfaqur për herë të parë nga shejtani. Mendjemadhësia është një problem i madh i njeriut, i catur nga shejtani, i cili duke e parë veten më lart se Ademi (a.s.), refuzoi përluljen në shenjë respekti ndaj tij. Mjekimi i kësaj sëmundjeje është i mundur përmes modestisë së personit dhe njohjes së vetvetes dhe pozitës së tij.

2. Vetëpëlqimi është një veti egoiste dhe diabolike e të mbajturit më të madh, duke e mbivlerësuar veten dhe duke mos përfillur të tjerët. Vetëpëlqimi është një sëmundje e vështirë për t'u mposhtur, e cila dëmton shumë jetën fetare të besimtarit. Ashtu si tek mendjemadhësia edhe mjekimi i kësaj sëmundjeje është modestia.

3. Hipokrizia është shtirje, pra individi paraqitet si i mirë, i virytshtëm e i dashur, me qëllim që të gënjejë të tjerët. Hipokrizia është antonim i sinqeritetit. Pikërisht ky është vendi, ku njerëzit gabojnë më shumë. Në shumë hadithe hipokrizia vlerësohet si shirk i fshehtë. Një nga hilet që përdor egoja për të dëmtuar jetën fetare të besimtarit, është kënaqësia e njeriut për lëvdata. Një person, i cili për vite e kishte falur namazin në radhë të parë, kur një ditë erdhi me vonesë u detyrua të falej në radhën e dytë. Pas kësaj ndodhie, personi në fjalë mungoi në xhami për një periudhë kohe. Kur e pyetën për shkakun, tha: “Kujtoja se isha falur me sinqeritet gjithë këto vite. Falja e namazit në radhë të dytë, qoftë edhe një herë të vetme, më shqetësoi aq shumë, sa arrita në përfundimin se tërë kohën kisha bërë hipokrizi. Gjatë gjithë kësaj kohe jam

marrë me përsëritjen e namazeve të kaluara.” Shërimi i hipokrizisë bëhet i mundur përmes përpjekjeve të vazhdueshme për të arritur sinqeritetin dhe përmes vetëndërgjegjësimit se Allahu shikon në zemrat e njerëzve dhe jo në formën e veprimeve të tyre.

4. Zemërimi është një ndjenjë e keqe, e cila ka një ndikim shumë negativ në jetën e njeriut në përgjithësi dhe devotshmërinë e besimtarit në veçanti. Shërimi i kësaj sëmundjeje është i mundur përmes dorëzimit të caktimi i Allahut.

5. Zilia është ndjenja e lakmisë a keqdashjes, që ngjallet kur shohim dikë tjetër më mirë se veten. Njeriu gjithmonë shikon të tjerët duke harruar veten. Në këtë mënyrë, ai ose merret me mangësitë e të tjerëve, duke harruar mangësitë e veta, ose harron mirësitë e veta duke shikuar vazhdimisht mirësitë e të tjerëve. Shkaku i zilisë është mospranimi i caktimit të Allahut. Në momentin që njeriu beson sinqerisht dhe kënaqet me atë që Allahu i ka caktur, shpëton përfundimisht nga ndjenja vrastare e zilisë.

6. Lakmia për pasuri është dëshirë e madhe dhe e pangopur për të pasur pasuri të pafundme materiale. Shkaktari kryesor i kësaj sëmundjeje është harrimi i vdekjes dhe ilaçi i vetëm është kujtimi i vazhdueshëm i vdekjes dhe vetëdijësimi për përkohshmërinë e kësaj bote.

7. Ambicia për pushtet është dëshira dhe këmbëngulja për të qenë në krye të të tjerëve. Shërimi i kësaj sëmundjeje është modestia dhe falënderimi i Allahut për mirësitë e dhëna. Dëshira për të qenë në krye e bën njeriun të harrojë veten, duke u bërë në këtë mënyrë pre e lehtë e tundimeve të ndryshme. Çdo ditë, besimtari duhet t'i bëjë vetes këto pyetje: “Çfarë bëra sot për Allahun? Nga ato që kam bërë, sa janë për hir të Allahut dhe sa për egon? Sa hipokrizi ka në mendimet, sjelljet dhe veprimet e mia? Si është zemra ime? A rreh ajo për pasurinë e kësaj bote apo rreh për Krijuesin e gjithësisë?” Përmes këtyre pyetjeve njeriu fiton aftësinë për të kuptuar dhe ndrequr gabimet e veta.

Të gjitha këto dëmtojnë devotshmërinë e besimtarit. Rruga më e shkurtër për t'u pastruar nga këto është vetëkritika dhe vetëkontrolli i vazhdueshëm. Përmes vetëkontrollit arrihet zbulimi, pranimit i vetëdijshëm dhe dënimit i gabimeve të veta për t'i ndrequr ato. Si përfundim, devotshmëria nuk është diçka që arrihet lehtë. Devotshmëria nuk është privilegj dhe pozitë kundrejt të tjerëve, por heqja dorë nga një sërë dëshirash egoiste. Feja është e Allahut. Ajo vjen prej Tij dhe bëhet vetëm për hir të Allahut.



Sulbe të zgjedhura

Ferid Piku

Ëmbëlsia E BESIMIT

Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë në një hadith: “Ai që ka tri gjëra, do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: Të dojë Allahun dhe Profetin (a.s.), më shumë se çdo gjë tjetër, ta dojë tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë kthimin në mosbesim, siç urren të hidhet në zjarr.”¹

Pse sakrifikojmë kaq shumë për fëmijët tanë? Pse bëjmë çdo gjë për ta? Sepse ne i duam fëmijët, pasi fëmija është nga krijesat më të dashura në këtë botë dhe bëjmë çdo gjë në emër të kësaj dashurie. Ne lodhemi shumë për të fituar pasuri. Për hir të saj bashkohemi dhe ndahemi me të tjerët. Për të lodhemi gjithë ditën, sepse shpirti i njeriut e do pasurinë dhe ëmbëlsinë e saj.

Kur një punë bëhet monotone, pa dashuri e kënaqësi, ajo nuk zgjat shumë. Nëse njeriu nuk e do një punë, ai nuk e bën atë kurrë me qejf, ndërsa punën që do e bën me qejf të madh. Çdo gjë që bëjmë, e bëjmë sepse kemi dashuri për të dhe nuk ka rëndësi nëse e themi këtë apo vetëm e ndjejmë.

Po besimi në Allah, a është dashuri? Shumë muslimanë mundohen ta trajtojnë besimin në Zot si një tërësi rregullash, që duhen zbatuar dhe disa adhureme që duhen kryer. “Duhet ta bësh këtë gjë, duhet t’i besosh Zotit etj.” Kur dikush pyet përse duhet t’i bëjë këto gjëra, ne përgjigjemi: “Sepse kështu duhet.”

Besimi në Allah nuk qëndron vetëm në rregulla dhe fjalë, por është më shumë se kaq. Ai në radhë të parë është ndjenjë, dashuri dhe ëmbëlsi. Nëse nuk e ndjen dashurinë për Zotin, për Profetin e Tij dhe për fenë e Tij, ti nuk do ta vazhdosh dot gjatë këtë rrugë. Nëse nuk e ndjen ëmbëlsinë e kësaj rruge, të duket njëlljo si me fe si pa fe.

Besimi në Zot është dashuria dhe ëmbëlsia më e madhe. Ëmbëlsia e besimit në Zot nuk krahasohet me asnjë ëmbëlsi tjetër, që ekziston mbi shpinën e kësaj toke. Ta ndjesh ëmbëlsinë e besimit, do të thotë të ndjesh rehati në mendjen tënde, ta kesh mendjen të qetë. Ta ndjesh ëmbëlsinë e besimit, do të thotë të ndjesh qetësi në zemrën tënde. Ndryshe nga shumë zemra të tjera, që lëvizin për çdo moment, zemra jote është e qetë, me fjalë të tjera, me besim të zgjerohet kraharori. A të ka ndodhur të të shtypet kraharori dhe të mos marrësh dot frymë lirisht? Ndërsa besimi në Zot ta hap kraharorin dhe ti merr frymë natyrshëm, edhe pse të tjerët kanë ankth shumë të madh.

Ta ndjesh ëmbëlsinë e besimit do të thotë që Allahu (xh.sh.), të të ruajë dhe të të japë dritë, edhe pse njerëzit e tjerë nuk e kanë këtë dritë. Ëmbëlsia e besimit është e butë. Ajo futet në trupin tënd pa u ndier, si uji në kërcellin e bimëve, por, nëse nuk ka ujë, bima vdes. Ashtu vdes edhe zemra e njeriut, nëse brenda saj nuk ekziston besimi në Zot. Ajo futet te njeriu, ashtu siç futet gjaku nëpër damarë. Nëse për një moment gjaku ndalon, njeriu ka probleme të mëdha, edhe pse nga pamja e jashtme të duket se është për mrekulli.

Profeti Muhamed (a.s.), i donte shumë besimtarët dhe e dinte se të arrish ëmbëlsinë e besimit, është kulmi i kësaj bote dhe botës tjetër, prandaj i këshillonte dhe i nxiste me dy-tre fjalë të shkurtra shokët e tij, që ta arrinin lehtësisht ëmbëlsinë e besimit.

Subhanallah! Profeti (a.s.), fliste gjithmonë shkurt dhe kuptohej nga njerëzit, kurse ne na duhet të flasim gjatë, që t’i mbushim mendjen njëri-tjetrit. Profeti (a.s.), thoshte: “A doni t’ju tregoj për tri gjëra, të cilat, nëse i bëni me sinqeritet, do ta shijoni ëmbëlsinë e besimit?”² Kur njeriu e shijon ëmbëlsinë e besimit,

1. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (16) dhe Muslimi (43).

2. Shiko referencën paraprake.

thotë ashtu siç kanë thënë të parët tanë: "Vallahi, në disa momente kalon diçka aq e ëmbël dhe aq e bukur në zemrën time dhe, nëse banorët e xhenetit përjetojnë atë që përjetoj unë tani, ata qenkan për mrekuilli!" Ndërsa dikush tjetër thoshte: "Sikur ta dinin pasanikët se çfarë ëmbëlsie kemi në zemrat tona, do të luftonin për të na e marrë, qoftë edhe me shpatat e tyre."

Le ta pyesim veten tonë sinqerisht nëse kemi ndjerë ndonjëherë ëmbëlsi në zemrat tona. A të ka ndodhur ndonjëherë të falësh dy rekate e të duash që këta dy rekate të mos mbarojnë kurrë? A ke bërë ndonjëherë ndonjë punë dhe të është dukur se, edhe nëse Zoti të jep gjithë dynjanë nuk e krahason me ëmbëlsinë e asaj pune? Nuk është kusht që ëmbëlsia e besimit të zgjasë shumë. Ajo zgjat pak, por nuk krahasohet me gjithë kënaqësitë e kësaj dynjaje.

Profeti (a.s.), ka thënë: "Rruga e parë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është ta duash Allahun (xh.sh.) dhe të Dashurin e Tij, më shumë se çdo gjë tjetër që ekziston në gjithësi!" Ne i duam fëmijët tanë, gratë tona, familjet tona, farefisn tonë dhe për ta rropatemi dhe bëjmë çdo gjë. Këtë e bëjmë nga dashuria që kemi për ta. Kur dashuria për Allahun (xh.sh.), të jetë më e madhe se çdo gjë tjetër, atëherë do ta ndjejmë ëmbëlsinë e besimit në Zot.

Ta ndjesh ëmbëlsinë e besimit, do të thotë ta duash fenë e Zotit, ta duash ligjin e Zotit, sepse ka ardhur prej Tij. Është e thjeshtë të thuash se e do Zotin dhe Muhamedin (a.s.), por dashuria ka tregues. Ti s'mund të pretendosh se e do dikë, kur nuk bën asgjë për të. Nëse nuk bën asgjë, atëherë ti nuk e do atë njeri, prandaj mos gënje veten tënde e as të tjerët me fjalë të bukura.

Ta ndjesh ëmbëlsinë e besimit, do të thotë ta duash fenë e Zotit dhe jo thjesht ta zbatosh atë. Mos të të duket feja e Zotit barrë, sepse ajo nuk ka ardhur si barrë për të na rënduar. Allahu (xh.sh.), nuk ka nevojë ta çojë fenë e Tij barrë përmbi njerëzit. Vallahi, feja e Zotit është privilegj. Allahu (xh.sh.), do që të ta lehtësojë rrugën me këtë fe dhe nuk do që të t'i vështirësojë punët.

Ta duash Allahun (xh.sh.) dhe Muhamedin (a.s.), do të thotë t'i duash besimtarët, ata që venë ballin në sexhde për Zotin, ata që marrin abdest për Zotin, ata që kanë frikë haramin, ata që vrapojnë pas urdhrit të Zotit. Duaji këta njerëz, edhe sikur të jenë të zinj nga lëkura, edhe sikur të jenë nga ato zona, që ti nuk i ke qejf, edhe sikur të mos jenë prej fisit tënd apo bashkëkombësit e tu. Duaji këta njerëz, se ata janë të dashurit e Zotit, duke filluar nga profetët e Zotit, pastaj te dijetarët, te evlijatë e Zotit, te hafizët dhe te ata që përmendin Zotin. Pra, duaji këta njerëz vetëm për



hatër të Zotit.

Ta duash Zotin do të thotë të ndjekësh rrugën e Tij me kënaqësi e me ëmbëlsi. Thuhet se njëri nga sahabët, sa herë që falte namaz lexonte suren *Ihlas* në rekatin e dytë. Njerëzit u mërzitën nga kjo gjë dhe thoshin me vete: "A nuk di sure tjetër ky njeri?" Ata shkuan dhe i thanë Profetit (a.s.): "O Profet i Zotit, imami jonë na ka mërzitur pak, sepse gjithmonë në rekatin e dytë të namazit lexon suren *Ihlas*". Profeti (a.s.), u tha: "Shkoni dhe pyeteni imamin tuaj se përse e bën diçka të tillë." Kur e pyetën imamin, ai u përgjigj: "Vallahi, e dua shumë këtë sure, sepse ajo ka cilësitë e Zotit. Kur lexoj këtë sure, më kujtohet Zoti. Unë e dua Zotin dhe prandaj e dua edhe këtë sure". Atëherë Profeti (a.s.), e përgëzoi atë imam, duke thënë: "I thoni atij njeriu se edhe Allahu (xh.sh.), e do atë, sepse ai do suren *Ihlas*, që është surja e Zotit."³

Kush i do besimtarët, kush e do Kuranin, ai e do edhe Allahun (xh.sh.). Dikush e pyeti Muhamedin (a.s.): "O profet i Zotit, kur do të bëhet Kiameti?" Profeti (a.s.), ia ktheu: "Çfarë ke përgatitur ti për Kiamet?" Sahabi iu përgjigj: "Vallahi, nuk kam bërë shumë punë, por unë e dua Allahun (xh.sh.) dhe të dua edhe ty". Pas kësaj Profeti (a.s.), i tha: "Ti do të jesh me ata që t'i do zemra." Kur sahabët e dëgjuan këtë thënie, filluan të qanin nga gëzimi, sepse të gjithë e donin shumë Zotin dhe Muhamedin (a.s.).

Atij që ndjen ëmbëlsinë e besimit në Zot, nuk do t'i hyjë në sy asnjë ëmbëlsi dhe asnjë pasuri tjetër. E lus Allahun (xh.sh.), të fusë në zemrat tona dashurinë për Të, të fusë në zemrat tona ëmbëlsinë e besimit në Zot.

Hadithi vazhdon: "Ta duash tjetrin vetëm për hir të Allahut." Të mos e duash tjetrin për interes, sepse

3. Hadithi i vërtetë. Buhariu (774) dhe Muslimi (813).

sado i madh qoftë interesi, ai do të mbetet i vogël, ngaqë është prej dheu, ndërsa ta duash tjetrin për hatër të Zotit kjo vjen prej qiellit. Ta duash tjetrin, jo sepse e ke të afërm apo se pi kafe apo se luan futboll me të, por vetëm për hatër të Atij që i do besimtarët. Prandaj, ne i duam të gjithë profetët e Zotit, edhe pse nuk i kemi parë ata kurrë me sy. I duam shokët e Profetit (a.s.), edhe pse nuk kemi ndenjur me ta. I duam njerëzit e mirë, edhe pse ndoshta nuk i kemi parë kurrë. Ne i duam të gjithë besimtarët dhe nuk kemi urrejtje ndaj tyre.

Tregohet se Ahmed Ibn Hambel, një dijetar shumë i madh, shkoi nga Bagdadi në një vend tjetër. Nata e zuri në xhami, por pasi u fal namazi i jacisë, pastruesi i saj, i cili nuk e njihnte, i tha: "Dil se do të mbyll xhaminë dhe nuk lejohet askush të rrijë këtu." Imam Hambeli doli në shi dhe nuk dinte ku të strehohej. Dikush e pa dhe i tha: "O njeri, pse rri në mes të shiut?" Imam Hambeli u përgjigj: "Vallahi, nuk kam ku të rri sonte." "Hajde tek unë" - ia ktheu tjetri. Ky person e mori Imam Hambelin në shtëpinë e tij, ia ndërroi rrobat dhe u ulën të dy. Imam Hambeli shikoi se ky njeri e përmendte shumë Zotin. U habit nga kjo gjë dhe e pyeti: "O njeri, po e shoh se ti po e përmend shumë Zotin. Ç'është kjo punë?" Burri ia ktheu: "Vallahi, nuk më ka dalë keq nga kjo punë. Me këtë përmendje që bëj, Allahu (xh.sh.), më ka dhënë një sekret. Për çdo dua që bëj, më vjen përgjigja. Vetëm një dua nuk më është plotësuar dhe inshallah ma pranon Zoti, para se të ndërroj jetë. E kam lutur Zotin të mos ma marrë shpirtin pa u takuar me dijetarin e madh Ahmed Ibn Hambel dhe shpresoj se Zoti do të ma pranojë këtë dua." Atëherë Imam Ahmedi i tha: "Allahu (xh.sh.), ta ka pranuar lutjen, sepse unë jam Ahmed Ibn Hambel." Atëherë ky person filloi të qante dhe ta përqafonte Imam Hambelin. Imam Hambeli u habit dhe pyeti: "Po ti kush je?" Ai tha: "Unë jam Is'hak Ibn Rahauej", (një tjetër dijetar i madh).

Ata nuk kishin telefona, s'ishin takuar më parë në ndonjë konferencë, por ishin takuar me gjuhën e shpirtit dhe me gjuhën e zemrës. Kjo është dashuria për hatër të Zotit.

Ta duash vëllain tënd për hatër të Zotit, do të thotë t'ia qash hallin, kur ai ka hall e të mos bësh sikur nuk dëgjon. Nëse ke mundësi ta ndihmosh, ndihmoje ose të paktën lehtësoja hallin. Tekefundit, bëji të ditur se të vjen keq për të. Kjo është dashuria. Përndryshe, dashuria është fjalë që e merr era.

Ta duash vëllain tënd për hatër të Zotit, do të thotë ta vizitosh atë. Dikush mori një rrugë të largët për të vizituar vëllain e tij mysliman. Rrugës ai takoi një melek në formë njeriu, i cili e pyeti: "Për ku je nisur o njeri?" Ai iu përgjigj: "Po shkoj të vizitoj vëllain tim për hatër të Allahut (xh.sh.). Meleku e pyeti: "Mos ke

ndonjë hall, që ai mund të ta zgjidhë apo ke tregti apo miqësi me të?" Burri u përgjigj: "Jo vallahi, nuk kam as hall as tregti e as miqësi, por e dua për hir të Allahut (xh.sh.) dhe po shkoj ta vizitoj vetëm për hir të Tij." Atëherë meleku i tha: "Unë jam meleku i Zotit. Më ka dërguar Allahu (xh.sh.), të të them, se edhe Allahu (xh.sh.), të do ty ashtu siç do ti vëllain tënd." Në lidhje me këtë, Muhamedi (a.s.), ka thënë: "Ditën e Gjykimit do të ketë disa njerëz, që i kanë fytyrat plot dritë. Ata janë në podium drite. Nuk janë as profetë e as dëshmorë, por profetët dhe dëshmorët i kanë zili. Ata janë njerëzit, që u deshën vetëm për hir të Allahut (xh.sh.). Atë ditë kur njerëzit kanë frikë, ata nuk do të kenë frikë".⁴

Ta duash vëllain tënd për hatër të Zotit, do të thotë t'ia falësh gabimin. Të gjithë jemi njerëz dhe bëjmë gabime. Ndonjëherë bëjmë gabime shumë të mëdha ndaj njëri-tjetrit. Por, kur ta duash vëllain tënd për hir të Allahut (xh.sh.), duhet ta kesh zemrën e madhe. Fale o njeri, se Zoti e ka faljen më të madhe. Nëse Allahu (xh.sh.), do të na gjykonte ne për veprat tona e të thoshte, se filanin nuk e fal për këtë gabim, këtë tjetrin nuk e fal për një gabim tjetër, atëherë ne do të ishim të mbaruar.

Mëso prej cilësisë së Allahut (xh.sh.). Ai është Falës i madh dhe sidomos besimtarin e fal shumë, sepse besimtari thotë: "O Zot, më fal!" Jo vetëm e thotë, por e përjeton dhe e ndjen thellë kur bën gabim dhe pendohet e kërkon falje. Allahu (xh.sh.), e fal këtë njeri.

Pjesa e fundit e hadithit është: "Të urrejë njeriu që të kthehet në mosbesim, ashtu siç urren të kthehet në zjarr." Nëse të thuhet ta lësh besimin ose përndryshe do të futesh në zjarr, ti duhet të zgjedhësh zjarrin. Të gjithë e kemi përjetuar rrugën e keqe në një formë apo në një tjetër, madje mund të kemi qenë pjesë e rrugës së keqe, por Allahu (xh.sh.), na ka marrë si me dorë dhe na ka nxjerrë në rrugën e Tij.

A e falënderon Allahun (xh.sh.), për këtë gjë apo të duket se besimi është një mënyrë jetese dhe thua: "Ne falemi ata nuk falen, ne adhurojmë Zotin ata nuk e bëjnë diçka të tillë e kështu me radhë." Jo! Dije se ty të ka dhënë Allahu (xh.sh.), pasurinë më të madhe, dhuratën më të çmuar, besimin në Zot. Këtë dhuratë nuk ua jep shumë njerëzve të tjerë, edhe pse ata mund të kenë pasuri e pushtet më shumë se ti dhe mund të jenë njerëz edhe më të zgjuar. Falënderoje Zotin për të gjitha këto.

Ta urresh kufirin e ta duash besimin, do të thotë të thuash gjithmonë: "O Zot! Ty të falënderoj që më shpëtove me mëshirën tënde, se, nëse nuk do të më udhëzoje, unë do të isha prej të humburve." Mos e kra-

4. Hadith i vërtetë. Hakimi (4/471). Hakimi e vlerëson vargun e hadithit të vërtetë dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu.

haso këtë besim me para. Mos e ki zili dikë që ka para, por që nuk ka besim, pasi ai nuk ka harmoni në shtëpi dhe zemrën e ka sterrë të zezë. Besimi nuk matet me para.

Të ndjesh ëmbëlsinë e rrugës së besimit, do të thotë ta falënderosh Zotin ditë e natë dhe falënderimi bëhet duke përhapur fjalën e Tij. Ashtu siç të udhëzoi Allahu (xh.sh.), në rrugën e drejtë, mundohu të bëhesh shkak që edhe dikush tjetër të udhëzohet, se rruga e Zotit ka vend për të gjithë.

Ta duash besimin, do të thotë të sakrifkosh për këtë gjë. Nëse të merret gjithë pasuria, të vdesin fëmijët, të merret pushteti që ke, nëse të merr Zoti sytë, duart dhe këmbët, dhe pas gjithë këtyre Allahu (xh.sh.) të le vetëm ëmbëlsinë e besimit në zemër, a s'më thua se çfarë do të zgjidhje? Këtu është provimi. Vijnë momente të caktuara në jetën tonë, ku me të vërtetë jemi në luhatje dhe shtrohet pyetja: "Të mbaj rrugën e Zotit apo pasurinë e kësaj dynjaje?" Besimtari pranon që, jo vetëm t'i merret gjithçka, por edhe sikur ta hedhin në zjarr, ai mban besimin e tij.

Pse u hodh në zjarr Ibrahim (a.s.)? Sepse e dinte se zjarri i dynjasë nuk krahasohet me zjarrin e Ahiretit dhe pranoi me kënaqësinë më të madhe të mbante besimin dhe të hidhej në zjarrin e kësaj dynjaje. Nuk iu lut askujt për ndihmë e as nuk u bë servil. Nuk kërkoi as ndihmën e Xhebrilit (a.s.), por tha: "Vetëm për Allahun (xh.sh.), kam nevojë"

Ka shumë njerëz që jetojnë në këtë botë dhe nuk kanë dëgjuar për pejgamberë, nuk dinë asgjë rreth fesë. Nuk dinë as për Kuranin, as për namazin, as për agjërimin, as për Zotin e as për Profetin (a.s.). Ç'do të bëhet me këta njerëz, kur të vdesin? Allahu (xh.sh.), është i Urtë dhe i Drejtë. Kur i ringjall këta njerëz, i pyet: "A njihni ndonjë libër të Zotit? A ju ka ardhur ndonjë profet?" Ata përgjigjen: "Jo". Pastaj Allahu (xh.sh.), i pyet: "A besoni në Zot?" Të gjithë përgjigjen njëzëri: "Po, besojmë në Zot." Atëherë, Allahu (xh.sh.), u thotë: "Përpara jush ka dy vende: njëri është zjarr, tjetri është parajsë. Kush beson tek Unë, të futet me shpejtësi te zjarri dhe jo te parajsa".

Ata që janë besimtarë thonë: "Si të thuash Ti, o Zoti ynë" – dhe shkojnë drejt asaj që duket si zjarr, por në fakt ajo vetëm pamjen e jashtme e ka si zjarri, por brendësia është xheneti i Allahut (xh.sh.). Ndërsa ata që e kanë besimin vetëm me fjalë, nisen drejt zjarrit, por e ndërrojnë rrugën dhe më pas nisen drejt asaj, që pamjen e jashtme e ka si xhenet, por brendësia është zjarr.

Ky është besimi në Zot dhe këtë besim nuk duhet ta krahasojmë me asgjë tjetër. Duhet t'i lutemi Zotit ditë e natë, duke thënë: "O Zot! Ti që më shpëtove nga rruga e gabuar dhe më fute në rrugën e drejtë, m'i forco



këmbët në këtë rrugë, dhe më bëj që shpirtin ta jap si besimtar". Mirësia më e madhe që Zoti mund t'i japë njeriut, është që ai ta mbyllë jetën e tij me besim.

Në fund mbetet shpresa jonë e madhe te Zoti, se Ai do t'i falë gabimet tona. Ai që me mëshirën e Tij na nxori nga errësira në dritë, inshallah me mëshirën e Tij, do të na bëjë të mundur që jetën tonë ta vazhdojmë në rrugën e kësaj drite, shpirtin ta japim me këtë dritë dhe të ringjallemi bashkë me këtë dritë.

Besimi në Zot nuk është as fjalë, as rregulla, as hytbe e as shkrime që lexohen. Të gjitha këto janë mjete. Besimin duhet ta ndjesh në zemër, se vetëm atëherë e kupton vërtetësinë e kësaj fjale. Sikur të jesh në vendin më të humbur, nëse ke Zotin me vete, ai do të jetë vendi më i ëmbël. Sikur të t'i marrë Zoti të gjitha, por të ta lërë zemrën, e cila pulson me besim, thuaj: "O Zot, Ti më ke dhënë shumë e unë nuk di si të të falënderoj për këto të mira".

Ky është besimi në Zot. Muhamedi (a.s.), ka thënë: "Nuk është devotshmëria me fjalë të bukura, as se çfarë bën ti përpara njerëzve, por ajo është këtu (duke treguar zemrën)"⁵ Prandaj, vetëm Allahu (xh.sh.), e di se kush është më i devotshmi.

Allahu (xh.sh.), na bëftë besimtarë të devotshëm. E lus Zotin e gjithësisë të na bëjë nga ata njerëz, që ndjejnë në shpirt e në zemër dashurinë për Zotin dhe dashurinë për Muhamedin (a.s.). O Zot! Bëje besimin gjënë më të ëmbël që ke krijuar mbi shpinën e kësaj toke, na bëj ta jetojmë jetën si besimtarë, shpirtin ta japim në rrugën e Muhamedit (a.s.) dhe të lutemi të na ringjallësh nën flamurin e tij.

Amin!..

5. Hadithi i vërtetë. Muslimi (2564).

TEFSIRI I SURE-I DUHASË

Kjo sure ka zbritun në Meqqe edhe permban njimbdhet Ajete.

Shkaku i zbritjes së kësaj Suresë, pendehet a thuhet është vonimi i Vahjit pak ditë. Pra zbritja e kësaj Suresë, H. Muhammed Mustafajt po i jep një ngushllim të math edhe po e shkujdes se Zoti me madhësin e vetë ka me i a plotësuar mirësitë më të mëdha njerën pas tjetrës. Ky vonimi i zbritjes së Vahjit ka qenë në fillimin e Profetësisë së Tij.

“Ve’d-duha”

Betohem për Duhanë q’ëthtë koha mâ e re e ditës.

“Ve’l-lejli idha sexha”

Betohem edhe për natën kur pushon e qëndron që atëhere gjithë sendet që kanë shpirt pushojnë e çlodhen.

“Ma veddaake rabbuke ve ma kala”

Yt-Zot nuk të la edhe s’t’u zemrua.

Resulull-llahu (A.S.) me qenë se ishte njeri, në fillimin e ardhjes së vahjit me doemos nga randësija ndryshej pak, edhe ndërsinte, nga ky shkak vahji duhesh të vonohej qi zemra t’i tulitej dhe ta merrte për malli ëngjillin e vahjit edhe ta priste vahjin me një mallëngjim. Prandej Zoti me madhësin e vetë Urdhnon e i thotë:

“Ve’d-duha” “Ve’l-lejli idha sexha” “Ma veddaake rabbuke ve ma kala”

I dashuri im Muhammed! Mos u mërzit se t’u vonue pak dit vahji (e ftekmja e lajmevet perendiore), betohem për kohen Duha që me anën e rezevet të djellit të saj forcon ngjallimin e sendeve që mbijnë dhe rriten, betohem edhe për natën që qëndron dhe gjithë gjât e ajalla ndër të çlodhen dhe përmbledhin e i përsëritin prapë fuqit që kanë për-

dorur ditën, pra çlodhen për me u përgadit fuqinë për ditën e nesërme.

Zoti ty s’të la, dhe prej teje nuk u merzit edhe fare mëni s’të ka zënë. Porse fillimi i vahjit i shembëllen kohës së parë të ditës, pernjihresh drita e madhe e vahjit lindi në zemrët tënde, per të paren herë trupi tënd si u mbyt në det të nurit të Zotit, u lodhe e u trondite nder ato vallët të jashtë-zakonshme të drites prëndijore, pra duhesh qi trupi i yt i bekuar të çlodhej pak por si nata që pushon, që kështu ta përmblihdje gjithë forcën për me i sjellë fuqi dhe për me i bâ ballë atyre valve mâ të mëdha të nurit të Zotit që do të përpiqëshin në trupthit tënt me një vazhdim të rregullët njëzet e ca vjet.

Ky ishte shkaku i vonimit të vahjit e jo tjetër send o i dashuri im!

“Ve le’l-ahiretu hajrun leke mine’l-ula”

Puna tënde e pastajme për ty është mâ e mirë (mâ e dobishme edhe mâ e mbrothshme) se e para d.m.th: vahjet që do të kallzohen pas këtaj janë mâ të dobishme edhe mâ frytëdhëse se vahjet që të janë dhënë mâ të mëdhatë mrekuilli i ke pas kësaj, pra mos u merzit!

“Ve lesevfe ju’tike rabbuke feterda”

Yt-Zot mâ vonë ka me të dhënë aqë shumë mirësi sa do të këndaqesh edhe vetë, d.m.th. me anën e vahjit që të ka zbrit shumë vjet pa pra, ti edhe kombi i yt nga pikë-pamja e ndriçimit kini me kapë shkallën mâ të naltë, feja tënde do të naltësohet, fjala e jote e njitimit Perëndijor do të mbretërojë; me anën e këti kanuni qiellor që po i u tregon Ym-metit tënt kanë me jetu në një lumtëri të madhe përmbi gjithë Ym-metet.¹

1. Vertet, sa paten punuar pas kanunit te tij Perëndijor, kanë jetuar me një lumtri te jashtë-zakonshme afer shtat shekulla. Kur e lanë u lanë.

H. Muhammed Mustafajt ç'i dishronte shpirti edhe Zoti i math qysh i a plotësoj dëshirat e tija; edhe nga ajo kupëtohet se Muhammed Mustafaj është mbreti i gjith Pejgamberëve?

Hazreti Muhammedi dëshronte me e pa atdhen e dashun të tij Meqqen dhe krejt Arebinë të dëlir-të prej puteve, dhe kombin e vetë e gjithë njerzin donte me e pa të pajosur me besime të sakta edhe me morale ëngjëllore, edhe me të vertetë brënda në njizet vjet krejt sinisija Arabi dyk e qenë një shkretëtirë errësire dhe egersire me anen e ligjit Perandior, me anën e ati Kuranit të madhnushim e t'urushim u bë një lulishtë njerzimi e qytetrimi, e kështu u bë një shembëll lulzimi per gjith botët q'asi kohe ishin egersuar.

Ajy H. Muhammed që në fillimin e profetsisë u ndoq e u perpoq aq fort, në një kohë aqë të shkurtë arriu të shohë dhjetë mijonë shokë mysliman të saktë e besnikë therorë ndenë flamurin e tij qytetrim-prurës edhe bashkim-sjellës.

Të bëjmë një krahsim pra në ketë botë si dihet kanë ardhur qindra mijë Pejgamberë, por (ulu'l-azmi) të zotët e idesë të caktueme janë vetëm gjashtë: Ademi, Nuhi, Ibrahim, Musaj, Isaj, edhe Muhammedi (A.S.).

H. Ademi, u mundua shum vjet për me e përhap fenë të saktë midis bijvet të vetë, por nuk ishte e mundur me e plotësum dëshirën e vetë se edhe i biri i tij Kabili s'i vuri vesh dhe vrau të vllanë dhe me gjith fisin vetë i bëri krye-ngritje t'et dhe filluan t'i u falen shtatave.

H. Nuhi, u mundua me qindra vjet, me zi tetëdhjetë veta e besuan, por edhe i biri i vetë Jami a (Qen-ani) s'e besoj.

H. Ibrahim, shumë vjet u mundua le që nuk e besuan veç se një pakice porse edhe i ati i Tij Azeri s'e besoj.

H. Musaj, u mundua shumë vjet, më një mijë halle të bijt e Jakubit (Israilinjtë) i shpetoj nga thonjt e jevgevet të Firaunit. Mirë po H. Musaj tek u qell pak dit në Turi-Sina për me marrë disa pllaka prej Tevratit, Samiriu u tall me çifutët dhe për viçin e artë që pati derdhun vetë i u tha: "Musaj shkoj me e kerkue Zotin por e humbi e nuk e gjen dot,

Perendija e juej jah kû është". Faqe-zinjetë pa pikë turpi me të parë viçin e artë i u falën. Musaj me të këthyer i sheh se me faqe të zezë po i falen viçit, i u çkanos të vëllajt Harunit, por ajy i tha: i ndalova por s'më vunë vesh dhe pata frikë dhe pata frikë se mos pelsiste do një luftë midis tyre. Musaj u tha: o faqe-zinj! Si nuk pattë trup, kur e haruat Zotin që ju shpëtoj nga zgjedha e firaunëvet, hala s'ju janë tharë kambët që dualt prej ujit, me faqe të zezë si njohtë për All-llah viçin e artë të Samiriu? Por zati ju gjithmonë arit i jini falur, arit kini me ju falë. Sa karakter-lopë jeni!

H. Isaj, kur u këthye prej Hindit pas si ndenji gjashtëmbëdhjetë vjet, u mundua disa vjet edhe me zi e besuan dymbëdhjetë veta. Por njeri prej syresh Jehudhaj e shiti te çifutët për një zollotë.

Tani të vimë ne H. Muhammedi, në pak vjet dhjetë mijon vëllazër e motra u futën ndënë Flamurin e Tij, edhe le që asdonji nga shokët s'i bëri tradhti por kuer e donte puna njiqind për njëheresh bëheshin therorët e tij.

Meret vesh bukur se H. Muhammedi është mbreti i gjith profetvet. Kjo fe u përhap me një vullnet vetjak, pa pikë shtërngimi, aqë sa pa u mbushë një shekull, myslimanizma bashkë me qytetrimin e saj u shtri Pu-atje në Francë, e gjer në Gjine nga Afrika e në Çinë.

Vallë cila fe u përhapë e u shtri kaqë më shpejtë dhe vet-vetiu si feja myslimane?

Edhe sikuer le të thonë prej inadit si të duan për H. Muhammedin, fundi i fundit sikushi ka me e nji-tue Zotin e Muhammedit edhe sikushi Zoti ka me e besue si e ka besu po H. Muhammedi.

Të vimë prapë te tefsiri i Ajetit të sipërme që thoshte: Zoti të ka për të dhënë aqë shumë te mira per me ta plotësue fenë tënde permbi ç'do pik-pamje, sa do të kënaqesh, do të gëzohet shpirti edhe do të thuash të qofsha falë Zot se ma mbushë qëllimin e zemrës edhe m'i plotësove gjith mirësit ashtu si deshronja.

N'ajetet që vijojnë, Zoti po i a numron Pejgamberit mirësitë si i aka filluar që prej voglije dhe i thotë:

"E lem jexhidke jetimen fe eue"

Yt-Zot a nuk të gjeti jetim dhe të vendosi e të tuliti? D.m.th. që kur ke qenë çilimi Yt-Zot të mori nën mbrojtjen e tij Perendior edhe u perkujdes për ty. Të vdiq yt-atë Abdullahu të la në bark të mëmës së tate, kuer të vdiq jot-ëmë ndodheshe katër vjetç, të mori yt-qysh Abdul-Mutal-libi në gjit të vetë; por kurse vdiq edhe plaku ishe tetë vjeç. Ajy me gojen e vetë porositi të yt-ungjël Ebu-Talibin q' ishte mëshirë-math dhe t'u kujdesua, të mprojtj edhe si u bëre profet.

Vërtet u rrite pa mëmë e pa atë, por ti nuk vuajtje as pak, ti u rrite si në gjit shenj të Zotit, edukationin ëngjellor e more drejt për së drejti nga Zot' i vërtetë. Ti vërtet, si çiliminjt e tjerë s'thirre kurrë o atë por o Zot!

"Ve vexhedeke dallen feheda"

A nuk quhet nga plotësimet e mirësivet edhe kjo që yt-Zot të gjeti të habitur edhe të terhoqi në rrugën e drejtë e në fenë e saktë e cila ishte çkatëruar, d.m.th. H. Muhammed Mustafaj që kur ishte foshnjë i mitur putet s'i donte dhe i shante, ajy që çilimi mentonte edhe besonte një Zot të vertetë. Një ditë i unguli deshi ta shpjerë në falishtet plot pute, porse ëngjelli i Perendisë pa u fut brenda i ardhi, një dridhje e tmerçme në trupthin ëngjellor dhe i ungjelli u shtrengua me e largu edhe pastaj kurrë mâ s'e ngau por e la në lirinë e vetë. H. Muhammed Mustafaj, në të rit të tij le qi do një punë të pa pelqyeme nuk punoj por nuk luajti as s'i luajnë çiliminjt e tjerë. Kur i thoshin çiliminjt hajde të luajmë i u thoshte: Zoti s'na ka krijuar të luajmë e ta shkojmë kohën kot, por jemi krijuar të mentohemi perse kemi ardhur dhe të mentojmë bukurin e Zotit. Që në të rit të tij fitoj titullin "Muhammed Emin" Muhammedi i besushim.

Asij kohej ne tokët t'Arebisë vazhdonin kater llojë besime. 1) Myshriqët veç Zotit besonin dhe një vark perendishë që edhe këta ndaheshin nder disa degë. 2) Disa Hanife që besonin vetëm një Zot të cilët nuk ishin as njizet e pesë veta. Ma i ndigjushmi i Hane-five është Zejdi bir i Amrit Kureshi. Këto vjersha janë të tijat:

"E rabben vahid em elf rabb, e din idha kasemte'l-umur

Azelte'l-late ve'l-Uzze xhemian, kedhalike jef'alu'r-

rraxhulu'l-basir"

A vetëm një Zot duhet të besoj a një mijë? Kurse punët e krijimit t'i ndahen zotëve, a fe quhet ajo? Unë Latin, Uzzanë edhe gjith shokët e tyre i çpora zati buri me sy e me ment kështu punon. 3) Jahudinjt, që besonin një Zot porse fenë e kishin çkatrruar, Tevratin e kishin ndëruar e ndryshuar edhe Uzejrin e njihnin si bir Zoti nga shkaku se e këndonte Tevratin krejt në gojë.² 4) Kristijanët të cilët asi kohej pas mbëledhjevet t'Ezeknemidit kishin pranuar tritimin, dhe nga an'e romakve ishin futur nepër kishat edhe statytë të cilët si Isaj e Musaj ashtu edhe gjithë profetët i kishin çporur nga faltoret.

H. Muhammedi si ishte një i vetmi mentar i botës, që në djaleri mentohej dhe e vriste mëndjen se qysh do ta shpetonte botën nga errësira q'e kishte mbuluar.

H. Muhammed Mustafaj kur e shihte se kombi i tij në ç'do pikë-pamje ishte i çkatrrum, si nga besimi ashtu edhe nga morali, kur i shihte se ishin aqë t'egërsum sa mbytnin bijtë e bijat e veta, jetonin si shtëzat e pyllit. Pra djelli i bukur i Perendisë mentohej si t'i shpetonte nga egërsimi, si do t'i u themelonte njëtimin (tevhid) edhe qysh do t'i bashkonte që të mundnin me e shpetu vehten nga zgjedha e huej q'i kishte pushtuar në një anë Habeshija e në tjetër anë Persija e në tjetër po i pushtonin romakët.

Punë e H. Muhammedit nuk ishte tjetër vetëm se mentonte si t'i shpetojë prej besimeve të kota, prej moraleve të ndyta, prej zakoneve të këqija edhe nga zgjedha e huanj që po i afrohej edhe Hixhazit. Nga ky shkak drita e gjithsisë po jetonte ndënjë habitje të madhe edhe nuk dinte se çë rrugë të kapte e qysh ta levdonte e ta tregonte Zotin. Se me të vertetë njeriu vetë-vetiu si mundet ta çfarwsojw Zotin e në ç'mënyrë duhet t'i falet, pa me i tregu Zoti me një tregim Perendior. Zati gjith profetët kësisoj të habitshim kanë qenë pastaj Zoti me anën e vahjit i a u ka njohtuar vehten edhe i ka shpetuar nga habitja. Kwshtu edhe i madhi i gjith profetëve H. Muhammedi para se i vjen profetsija ka qenë i habitur në mënyrët të njëtimimit të vertetë edhe gjer sa e pshtolli drita e madhe e vahjit donte të rinte i qetë dhe pshehurazi t'i falej Zotit.

2. At-here duhesh edhe gjith Hafezet e Kur-anit te quhesh bijt e Zotit!...

Prandej i urdhnon Zoti:

“Ve vexhedeke dallen feheda”

Zoti prej teje s’u mërzit, edhe s’tu zemrua por mirsitë t’i plotësoj, se ti ishe i habitshim në mënyren e shpetimit të popullit, edhe yt-Zot të tërhoqi në rrugët të vertetë edhe me anën e H. Kuranit popullin tënt si nga errësira ashtu edhe nga zgjedha e të huajve e shpetove. Popullin e Arebisë e ndriçove me anën e fesë të vertetë edhe i u dhe një liri të plotë, i u fale një kulturë njerëzimi e qytetrimi që ma vonë ay ndriçim pushtoj gjith dynjanë.

“Ve vexhedeke ailen feagna”

Yt-Zot, të gjeti të varfër edhe të bëri të pasur. I ati me qënë se kur vdiq e la në barkut të s’amës, nuk i la donjë tashëgim të math vetëm një deve dhe një shërbëtoje. Gjëja ishte në dorët të gjyshit që hala po rronte.

Muhammed Mustafaj pasurinë e shtoj nga tregëtija që bënte vetë dhe nga ato q’i fali z. Hadixhe. Kjo zonj’ e nderçme, i u lut H. Muhammedit që të shkojë vetëm një here me karvanin e saj për udhtim në Sham për me e rregullue tregtinë e kështu H. Muhammedi i dha një fitim të math.

“Fe emma’l-jetime fela tekher”

Sa për jetimin, mos e poshtëro! Ti edhe vetë u rrite jetim. Hidhërimi i ngushticës se ç’është ti e di vetë. Ti u rrite në prehit të gjyshit e t’yt-ungjëli pors i një lule, keqësi s’pe fare, pra dija shqyryn kësaj mirësisje dhe për krahi jetimët, për ata ç’lel shkolla, jepu moral e mirësjellje që të bëhen një gjymtyrë e dobishme për ymmetin tënt, se po të rriten me poshtësi e pa kujdesësi, po të rriten me vetija të ndyta do të bëhen një plëndes i rezikshim për shqërimin vëllazënor.

Si ç’do mëm e atë po të mentohet se vdekjen e ka prapa veshit, dhe gjënë e mallin e tyre kanë me e ngrënë kujdestarët dhe bijt e bijat e tyre që do të ngein jetim kanë me heq gjith keqësitë, atëhere duhet të për kujdesohen tepër për jetimët e t’i shohin më bukur se fëmijën e vet.

“Ve emma’s-saile fela tenher”

Të vimë ne ajy që prej teje pyet a kërkon donjë çeshtje, mos i çfry edhe mos e çpor! Por mbaroja nevojën. Habitjen tënde, Zoti si ta zgjidhi me anën

e profetësisë, duhet t’i a u zgjihtë edhe ti atyre që të sillen përpara.

“Ve emma biniameti rabbike fehaddith”

Edhe sa për plotësimin e mirësisvet të t’yt-Zot bëj shqyryr, se atdhenë ta pastroj si nga zgjedha ashtu edhe nga pafesija. Mos u kurse kurrë por bëji mirësi jetimve, kujdesoju për nevojat edhe përpiqu t’i bësh mirë si kujt që të siellet dhe kërkon ndihmen e përkrajen tënde.

Me të marë këtë urdhër H. Muhammedi për jetimët aq shumë kujdesohej sa si për veshjen e ushqimin e tyre emenonte kujdestarë ashtu edhe për mësimin e tyre vendoste mësonjësi, dhe kështu si në kohët të Pejgamberit ashtu edhe në kohët të Halifëve të tij nga populli mysliman nuk dukej do një jetim a grua e ve që të lipte.

Ma të mbidhenjtë e vakfeve të botës për këto lloj mirësi ishin themeluar.

Zoti me anën e kësaj Sures, po i kallzon H. Pejgamberit se qysh e shpetoj prej habitjes që pati edhe si e mësoj të punoj për me e shpetu popullin e tij edhe gjith popujt e botës nga errësira e pafesisë, dhe si t’i shpetojë nga zgjedha e robërisë, si të formojë vëllazrimin e përgjithshim edhe si të përhapje qytetrimin e vertet.

Edhe nga këto u muar vesh se si ç’do Ajeti i H. Kur-anit është nga një mburim për kulturën e lulëzimit e cila kulturë ka pjellë kulturën Europjane të soçme.

Të fala të qofshim o Zot i vertetë!
Fjala tënde është muxhize për jetë
Sa turp i madh është për na e sa mare!
Hazreti Kur-anin e harruam fare.
Po të kujdesohej edhe sot ymmeti
Ashtu si kujdesej vetë Muhammedi
Bota myslimane kështu nuk ngelte
Do të përparonte mbi kulmin do delte.
Kulturë e vertetë vet është Kur-ani
Nuk përparon kurrë pa të myslimani
Pra Atdhen e fenë s’duhet ta harrojmë
Se pa fe, pa atdhe nuk mundim të rrojmë.

H. Ali

Marrë nga revista Zani i Nalte,
nr: 8, fq. 227, Marcë 1927

PIJET ENERGJIKE RREZIKOJNË SHËNDETIN E ADOLESHENTËVE

Një studim i ri ka zbuluar se pijet energjike mund të shkaktojnë dëme të mëdha për adoleshentët, sidomos kur kombinohen me alkool. Ato reklamohen si pije që rrisin kënaqësinë në tru, forcojnë sistemin imunitar e për më tepër "të bëjnë me krahe".

Shumica e pijeve më të njohura energjike, kanë në brendësi sasi të jashtëzakonshme kafeine dhe simulantësh të tjerë që e rrisin më tepër rrezikun. Kafeina njihet si një nga shkaktarët më të mëdhenj të dehidratimit, obezitetit, ankthit, takikardisë dhe problemet në aparatit të tretjes tek adoleshentët.

Kur pijet energjike përzihen me alkool, potenciali i rrezikut për adoleshentët rritet edhe më tepër. Kur ne e miksojmë pijen energjike me alkoolin, efekti i tyre është i barabartë me konsumin e një shisheje vere apo me pirjen e disa kafeve. Sasia e zakonshme e kafesë që konsumojmë ka rreth 100 miligramë kafeinë, ndërsa pijet energjike rreth 160 miligramë, pra 60 për qind më shumë.

Sipas statistikave, rreth 66 për qind e konsumatorëve të pijeve energjike janë nga mosha 13-35 vjeç. Doktorët shpjegojnë se këto lloj pijesh nuk janë shumë të sigurta për shëndetin dhe krijojnë varësi. Ata shtojnë se nëse dikush kërkon të marrë energji, duhet të ushqehet shëndetshëm, të bëjë ushtrime dhe të flejë mjaftueshëm.

Sipas raportit të vitit 2013 për shëndetin në Amerikë, në krahasim me vitin 2007, gjatë vi-


tit 2012 shtrimet në spital për probleme të lidhura me konsumimin e pijeve energjike, janë shtuar dyfish. Dhe midis tyre, rastet më shqetësuese ishin ato kur pijet energjike ishin miksuar me substanca mjekësore si "Ritalin" dhe "Adderall".

Një studim i Universitetit të Kentakit, zbuloi se kombinimi i pijeve energjike me alkoolin, largon aftësinë e trupit tonë për të kundërshtuar dëshirën për t'u dehur, duke rritur kështu mundësinë e abuzimit.

Në fund të studimit, shkencëtarët theksuan se ata dëshironin që njerëzit të ishin në dijeni për tregun e gjerë të pijeve energjike, sasinë e madhe të fitimeve që sjellin këto pije dhe mënyrat që përdoren për t'i rritur sa më shumë ato.

Duhet të kemi parasysh që konsumuesit më të mëdhenj të pijeve energjike janë adoleshentët, trupi i të cilëve është në ndryshim e sipër dhe që ndikohet shumë lehtë nga rreziqet që i kanosen nëpërmjet ushqimit dhe pijeve. Përbajtja e këtyre pijeve energjike nuk është shumë e qartë për njerëzit dhe nuk dihet me siguri se çfarë përbërësish përdoren për të rritur kënaqësinë në tru.


Sipas këtij studimi, duket se çmimi i krahëve që këto pije të japin, është i papërbalueshëm nga trupi i adoleshentëve. Të rinjtë nuk kanë përse të rrezikojnë kaq shumë, për të ndjerë emocione të forta që i përshkojnë trupin, pasi mosha e tyre ia bën të mundur këtë pa asnjë përbërës të jashtëm.



NERVOZIZMI DËMTON SHËNDETIN MENDOR

Psikologët në Universitetin e Kalifornisë kanë paralajmëruar se stresi i përsëritur në mënyrë të përditshme paraqet ndikime të dëmshme. Kudo që mund të ndodheni, në autobus, në punë apo në shumë gjendje të ngjashme që ju nervozojnë dhe ju rrisin nivelin e stresit dhe frustrimit, ju duhet të qetësoheni, sepse këto irritime të vogla mund të ndikojnë më vonë në ekuilibrin tuaj psikologjik.

Në kundërshtim me atë që është menduar më parë çrregullimet mendore mund të shkaktohen si nga



përmbledhja e episodeve të vogla të ankthit, por edhe nga traumat e mëdha, theksojnë psikologët.

Ju do të donit që këtë mëngjes të mos shkonit në punë dhe keni ngecur në trafik për orë të tëra. Përfundimi i kësaj: ju arrini vonë në punë, nervozoheni dhe për pasojë rrisni rrezikun e shqetësimeve psikologjike më vonë, shkruan Civitas. Prandaj shkencëtarët kanë bërë thirrje që duhet të jeni të qetë, duhet të kontrolloni gjendjet stresuese, se kjo ju shkakton shqetësime në shëndetin tuaj mendor.

KONSUMIMI I PESHKUT NË FËMIJËRI LUFTON ALERGIJË

Sipas një studim, fëmijët që konsumojnë peshk që në vitet e para të jetës kanë mundësi të preken shumë më pak nga alergjitë gjatë jetës së tyre.

Një grup shkencëtarësh suedezë kryen një studim 12-vjeçar, duke marrë parasysh dietën e disa mijëra fëmijësh në moshën nga 1-5 vjeç. Në përfundim të studimit, ata zbuluan se ata që ishin rritur duke konsumuar shumë peshk, kishin një tolerancë më të lartë të trupit ndaj alergjisë.

Ekzema, një iritrim lëkure që është njëkohësisht një prej formave më të përhapura të alergjisë, bie me 26% mundësi prej tek ata që janë rritur në këtë mënyrë. Një tjetër faktor rreziku që zvogëlohet nga kjo dietë

është elementi që shkakton astmën apo alergji të disa llojeve, si alergjia që shkakton bari ose poleni i luleve.

Ndërkohë, rreziku për t'u prekur nga disa alergji reduktohet deri me 80%.

Megjithatë, studimi i Institutit Karolinska të Stokholmiti përqendruar në 3285 fëmijë, nuk arriti të identifikonte se cili është ai element konkret, që ndodhet tek peshku, në gjendje për të rritur në mënyrë kaq ndjeshme imunitetin e trupit ndaj alergjive.

Gjithashtu, sipas studimi, mjafton që fëmijët e moshës 1-5 vjeç të konsumojnë një herë në dy javë peshk, për të përfituar këto rezultate të shkëlqyera.



KONSORCIUMI SHAH DENIZ II PËRZGJEDH TAP-IN

Projekti për gazsjellësin "Nabucco-West" është refuzuar zyrtarisht nga operatorët e konsorciumit të gazit "Shah Deniz II", në Azerbajxhan. Këtë e bëri të ditur gjigandi austriak i energjetikës OMV, një prej investitorëve të projektit të gazsjellësit që do të mundësonte diversifikimin e burimeve të gazit për Evropën.

"Konsorciumi Shah Deniz II ka informuar OMV-n mbi vendimin lidhur me mënyrën e kërkuar dhe ka preferuar prej tyre për kalimin e gazit drejt Evropës. Projekti 'Nabucco-West' nuk është përzgjedhur nga konsorciumi që menaxhon furnizimet me gaz, Shah Deniz II", theksohej në një komunikatë të publikuar vetëm pak minuta më parë nga OMV-ja.

Konsorciumi, që përfshin "Socar", britanikun "BP", norvegjezin "Statoil" dhe francezin "Total", njoftoi se përzgjedhi projektin e gazsjellësit TAP (Trans Adriatic Pipeline), që do të kalojë nga kufiri greko-turk në Itali, duke kaluar nga Greqia dhe Shqipëria.

Një delegacion i konsorciumit të gazit në Azerbajxhan, "Shah Deniz II", që operon në rajonin Kaspik, informoi zyrtarisht kryeministrin grek, Adonis Samaras se kishte përzgjedhur për zbatim projektin e gazsjellësit TAP (Trans Adriatic Pipeline), deklaroi një burim shumë i afërt me delegacionin dhe dosjen në fjalë.

TAP-i, përveç se konsiderohet një nga burimet më të mëdha të investimeve të huaja direkte në Greqi me afër 1.5 miliardë Euro, parashikon të krijojë vende të reja pune për industrinë prodhuese, shërbimet, transport, komunikim, financiare dhe shërbimet e biznesit. Llogaritet që të krijohet punësim direkt për 2 000 vetë dhe indirekt 10.000 të tjerë.

Projekti TAP do të rrisë sigurinë e energjisë së Evropës dhe diversitetin, duke siguruar një burim të ri të gazit, ku tubacioni do të transportojë gazin natyror nga Shah Deniz II në Azerbajxhan, përmes Greqisë dhe Shqipërisë për në Itali, nga ku mund të transportohen më tej në Evropën Perëndimore dhe Evropën Qendrore. Seksioni i tubacionit me gjatësi rreth 550 km të TAP në Greqi do të nisë në Kipoi në kufirin turko-grek, për të hyrë më tej në territorin shqiptar.

Gazsjellësi TAP ndjek një gjurmë të mirëplanifikuar tokësore dhe detare, minimizon rrezikun, ndikimin mbi mjedis dhe komunitetet vendore. Si avantazh ka faktin, që kapaciteti mund të zgjerohet në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë nga një pikë fillestare prej 10 mmk/vit në 20 mmk/vit dhe më shumë, me kosto minimale, ku garanci jep siguria financiare e aksionerëve.

Në dokument nënvizohen aspektet më të rëndësishme teknike: përfundimi i projektimit inxhinierik fillim-mbarim (mars 2013); janë analizuar 10.000 kilometra; është marrë leja mjedisore në Shqipëri (prill 2013), kanë përfunduar marrëveshjet në rang politik etj.

Pikë e fortë e TAP është fakti se gazsjellësi me gjatësi 867 kilometra ofron rrugën më të shkurtër për në tregjet

europiane dhe të zbatueshme nga ana tregtare. Duke u lidhur direkt me gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP) dhe duke vazhduar më tej nga kufirit turk, TAP-i ndjek rrugën më të shkurtër të mundshme deri në tregun e dytë më të madh në Europë, në Itali.

Volumi i gazit i transportuar përmes TAP-it në Itali mund të transportohet më tej përmes rrjedhjes në drejtim të kundërt fizik përmes sistemit Trans Austria Gas (TAG) dhe "Transitgas" drejt tregjeve të Europës Veriperëndimore. Gjithashtu, rrugës për në Itali, TAP-i ofron mundësi të shumta për shitësit e gazit, që mund të sjellin energji në tregjet e zhvilluara të gazit, përfshirë Greqinë dhe Bullgarinë.

Duke u lidhur me TANAP-in ky gazsjellës mund të ndihmojë furnizimin me gaz të vendeve të Europës Juglindore, përfshirë Bullgarinë, Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Kroacinë, etj. Faktor plus për aksionerët e TAP-it janë edhe studimet e tyre të fizibilitetit për eksplorim dhe mundësitë e krijimit të rezervave të gazit në Shqipëri. Me gjurmën e tij gazsjellësi TAP ofron shanse për furnizim me burime të reja gazi në tregjet e mëdha të gazit në pjesën tjetër të Europës.

Mbështetja politike e vendeve rajonale është po ashtu pikë e fortë, pasi ministrat e Jashtëm të Malit të Zi, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Greqisë dhe Italisë në një takim së fundi në Dubrovnik ranë dakord që të mbështesin fort politikisht gazsjellësin TAP, si mundësi e mirë për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me gaz për rajonin.

Ata ranë dakord që projektet TAP dhe IAP (Ionian-Adriatic Pipeline) janë në përputhje me interesat e Komunitetit të Energjisë dhe objektivat e Bashkimit Europian për diversifikimin e rrugëve të transportit dhe shtimin e burimeve natyrore të gazit. Kalimi i gazit përmes tubacioneve të TAP nga Azerbajxhani e më pas për në Greqi, Itali dhe Shqipëri, si pjesë e Korridorit të Jugut është opsion tërheqës jo vetëm nga pikëpamja strategjike, por edhe tregtare.

Ministrat ranë dakord të mbështesin dy gazsjellësit TAP dhe IAP, si mundësi që siguron furnizim të mjaftueshëm veçanërisht për Evropën Juglindore, diskutuan mbi detyrimet që lindin nga zhvillimi, financimi dhe ndërtimi i dy gazsjellësve si dhe përgatitjet që priten nga tregu të gazit që do të vijë nga deti Kaspik.

Projekti i gazsjellësit IAP synon të lidhë rrjetin e furnizimit të vendeve të Ballkanit, ku tubacionet do të kenë si pikë takimi me TAP, qytetin e Fierit, për të vijuar me një degëzim që do të vazhdojë në Split (Kroaci), do të kalojë në territorin e Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë.

TAP-i ka një gjatësi prej 867 km, ku 547 km kalojnë përmes Greqisë, 211 km përmes Shqipërisë, 104 km në detin Adriatik dhe 5 km në Itali. Pika më e lartë e tubacionit të TAP-it në 1.800 metra mbi nivelin e detit kalon në malet shqiptare, ndërsa është 810 metra niveli më i thellë në det.

KIROBO: ROBOTI ASTRONAUT

Një robot i vogël që flet, i ndërtuar në Japoni është gati për misionin e parë në hapësirë. Kirobo – një "robot astronaut", që mund të bisedojë me njerëzit në hapësirë dhe në tokë – është planifikuar për të shkuar në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës më 4 gusht.

Pasi të arrijë në bordin e laboratorit orbital, Kirobo do të marrë pjesë në bisedën e parë me njerëzit në hapësirë.

"Rusia ishte e para që shkoi në hapësirë, ndërsa SHBA-ja ishte e para që shkoi në Hënë. Ne duam që Japonia të jetë e para që do të dërgojë një robot në hapësirë, i cili mund të

komunikojnë me njerëzit", tha Yorichika Nishijima, menaxheri i projektit Kirobo. Emri Kirobo vjen nga një kombinim i fjalës japoneze për shpresë, "kibo" dhe fjala "robot".

Roboti vjen e pajisur me teknologjinë e njohjes së zërit, gjuhës, njohjes së fytyrës, një kamera, njohjes së emocioneve dhe aftësinë për të folur gjuhën japoneze. Roboti është zhvilluar nga Qendra Kërkimore e Teknologjisë së Përparuar në Universitetin e Tokios, Toyota Motor Corp, RoboGarage dhe Dentsulinc.



SONY EDHE ME SMARTWATCH

Gjigani i teknologjisë, Sony ka prezantuar në Shanghai's Mobile AsiaExpo, një teknologji të re, një orë inteligjente, të cilën e ka quajtur SonySmartWatch 2.

Ora është projektuar për t'u përdorur me telefonat Android. Ajo është rezistente ndaj ujit dhe ka lidhje NFC (near-field communication). Gjithashtu mund të personalizohet me aplikacione të ndryshme, bazuar në dëshirën e mënyrës së përdorimit të konsumatorit.

"Konkurrentët tanë po hedhin në treg pajisje të gjeneratës së parë, ndërkohë që ne, që tani po hedhim pajisje të gjeneratës së tretë falë gjithë përshtypjeve që kemi marrë nga rreth gjysmë milionë konsumatorësh së bashku me ekspertët më të mirë të Sony-t. Në këtë mënyrë do të sjellim



përvojën më të mirë të një ore inteligjente", u shpreh Stefan K Persson, drejtor i produkteve në Sony Mobile Communications.

"Kemi mbi 200 aplikacione të veçanta të dedikuara për SonySmartWatch, të cilat janë shkarkuar mbi një milion

herë. Po punojmë gjithashtu me zhvilluesit tanë për të sjellë një përvojë edhe më të mirë dhe njëkohësisht më konkurruese për orën."

Ato përfshijnë mundësinë për t'u përgjigjur telefonatave duke prekur kyçin e dorës, mundësinë për të bërë foto përmes orës apo për të kontrolluar prezantimet nga distanca përmes Sony "PresentationPal".

Për ata që pëlqejnë fitnesin, ora mund t'i ndihmojë me hartat gjatë ekskursioneve, ndërkohë që aplikacione të tjera u japin informacione rreth arritjes së qëllimeve. Ora shfaq gjithashtu të dhëna në lidhje me identitetin e telefonuesit, kalendarin, si dhe njoftime nga Twitter dhe Facebook. Ajo do të hidhet në treg në të gjithë botën prej muajit shtator.

CORNING SJELL XHAMIN E LAKUESHËM

Një prej teknologjive më të mahnitshme, e cila vjen së shpejti nga Corning është një lloj xhami i lakueshëm. Ai quhet WillowGlass dhe është projektuar për t'u përdorur si një ekran me prekje. Dr. Waguih Ishak i Corning, zëvendës president për Qendrën Corning të Teknologjisë Perëndimore, tha të hënën se ky do të jetë lajmi i bujshëm gjatë samitit të Bloomberg.

Me një ekran të lakueshëm, një kompjuter orë mund të përshtatet sipas kyçit të dorës të çdokujt, pavarësisht është i madh apo i vogël. Ishak tha se xhami do të jetë i disponueshëm për pajisjet nga fundi i 2013. Apple do të përdorë xham të lakueshëm në orën inteligjente, ka raportuar Nick Bilton i The New York Times në shkurt.

